



REPUBLIKA E SHQIPÉRISË

KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT



N/KRYETARI I K.K.T-së

Znj. EGLANTINA GJERMENI

Kryetari i Këshillit të Bashkisë

Znj. ILHIZIME DANI

Miratuar me Vendim të Këshillit të Bashkisë

Nr. 33 Datë 20.03.2017



Kryetari i Bashkisë

Z. MUHAREM RAMA

## PLANI I PËRGJITHSHËM VENDORI BASHKISË DIBËR

(STRATEGJIA TERRITORIALE)

Miratuar me Vendim të Këshillit Kombëtar të Territorit Nr.2, Datë 14.04.2017

DPKZHT: Z. ERVIN SHINI  
STUDIO KONSULENTE "P.A.N.G.E.A & A&I design"  
DREJTUES PROJEKTI : URB. DANIELE RALLO Nr.Lic.3133

P. A. N. G. E. A.  
Società Cooperativa Consortile  
Via Enrico Bindì, 14  
51100 PISTOIA - ITALIA  
C. Fisc. / P. IVA 01491840474



PANGEA



## PPV 2016. BASHKIA DIBER

MINISTRIA E ZHVILLIMIT URBAN  
Hartimi i Planeve të Pergjithshme Vendore per 26 Bashki ne Shqiperi

FAZA 3 - PLANI I PERGJITHSHEM VENDOR - Bashkia Dibër

RELACIONII STRATEGJIA TERRITORIALE



# **“Hartimi i Planit të Përgjithshëm Vendor i Bashkisë DIBËR”**

## **STRATEGJIA TERRITORIALE BASHKIA DIBËR**

### **RELACIONI I STRATEGJISË SË TERRITORIT**



**Ministria e Zhvillimit Urban**  
**Ministri**  
**Eglantina Gjermenë**

**Agjencia Kombetare**  
**e Planifikimit te Territorit (AKPT)**  
**Drejtori**  
**Adelina Greca**

**Bashkia Diber**  
**Kryetari i bashkise**  
**Muharem Rama**  
**DPKZHT**  
**Ervin Shini**

**Drejtuesi i projektit**  
Prof. Urb. Daniele Rallo

**Koordinatori i projektit**  
Ark. Urb. Indrit Hamiti

**Stafi kryesor**  
Urb. Raffaele Gerometta  
Prof. Ark. Francesca Calace  
Prof. Ark. Anna Bruna Menghini  
Prof. Ark. Michele Montemurro  
Dott. Paolo Trevisani  
Ing. Franco Di Biase  
Ing. prof.as Hektor Cullufi  
Ing. Elettra Lowenthal  
Urb. Lisa De Gasper  
Ing. Edmond Leka

**Ekspertet**  
Av. Shpetim Beqiraj  
Prof. as. Enver Isufi  
Ing. Alush Mehmeti  
Ing. Lino Pollastri  
Agr. Giovanni Trentanovi

**Konsulentet**  
Prof. Roberta Belli Pasqua  
Prof. Geol. Arjan Beqiraj  
Geol. Roberto Giannini  
Prof. Adem Hyseni  
Soc. Sergio Maset  
Geol. Leonardo Moretti  
Prof. Ark. Frida Pashako  
Prof. Giovanni Schiuma  
Econ. Altin Sulejman

**Stafi mbeshtetes**  
Ark. Carlo Angelastro  
Ing. Michele Brombal  
Ark. Alessandro Cariello  
Ark. Suela Dragovoja  
Ing. Silvana Gashi  
Urb. Valeria Polizzi  
Ark. Adriano Spada  
Urb. Fabio Vanin  
Urb. Anila Voj  
Ark. Chiara Durante  
Ark. Gianluca Iaia  
Ark. Sonia Paciolla  
Ark. Francesca Papa  
Ark. Maura Pinto  
Ark. Pervito Pirulli  
Ark. Giuseppe Resta  
Urb. Fabio Roman





## Tabela e Permbajtjes

<b>1 HYRJE .....</b>	<b>9</b>
1.1 Lista e perpunimeve te Fazes 2 .....	10
<b>2 REZULTATET E ANALIZES DHE VLERESIMIT TE TERRITORIT .....</b>	<b>11</b>
2.1 Parashikimet e planit kombetar .....	11
2.1.1 Objektivat, politikat dhe vizioni i Planit.....	11
2.1.2 Parashikimet ne lidhje me Dibrën .....	16
2.2 Analiza metabolike dhe vleresimi i territorit.....	25
2.2.1 Treguesit demografik kryesorë.....	25
2.2.1.1 Karakteristika të popullsise .....	25
2.2.2 Të tjera informacionë socio – ekonomike .....	30
2.2.2.1 Perbërja etnike .....	30
2.2.2.2 Përkatesia Fetare .....	31
2.2.2.3 Gjuha.....	31
2.2.2.4 Prezenca e aftësive të kufizuara .....	32
2.2.2.5 Statusi civil dhe Madhësia mesatre e familjes ( 5.1 përrsona/ familje ) Statusi civil .....	34
2.2.3 STATISTIKAT JURIDIKE.....	36
2.2.3.1 Veprat Penale .....	36
2.2.3.2 Të burgosurit .....	37
2.2.4 SHËNDETËSIA.....	38
2.2.4.1 Shërbimi shendetsole.....	39
2.2.5 ARSIMI .....	40
2.2.5.1 Indikatore të tjere arsimore .....	42
2.2.6 Turizmi .....	43
2.2.7 Sinteza e relacionit te trashegimise kulturore.....	46



2.2.8	Sinteza e relacionit gjeologjik .....	48
<b>3</b>	<b>PROJEKSIONE DEMOGRAFIKE 2030 .....</b>	<b>52</b>
3.1	Të dhëna socio -demografike .....	52
3.2	Tendenca demografike – Projekzion 2031 .....	57
<b>4</b>	<b>PERCAKTIMI I TERRITORIT NE TE 5 SISTEMET DHE ANALIZA SWOT .....</b>	<b>59</b>
4.1	Sistemi Urban (UB) .....	61
4.2	Sistemi Infrastrukturor (IN) .....	65
4.3	Sistemi Natyror (N) .....	70
4.4	Sistemi Ujor (U).....	76
4.5	Sistemi Bujqesor (B).....	79
4.6	Tema emergjente dhe ceshtje te evidentuara .....	83
<b>5</b>	<b>VIZIONI DHE STRATEGJIA TERRITORIALE .....</b>	<b>86</b>
5.1	Parashikimet e detyrueshme te planit kombetar te integruara ne strategji territorial .....	86
5.2	Vizioni i te ardhmes per Dibren .....	88
5.2.1	Objektivi Strategik 1 - Një cilësi e mirë e jetesës në territorin e Dibër .....	90
5.2.2	Objektivi Strategik 2 – Një akses më i mirë në brendësi të territorit të dibrës dhe vlerësimi i lidhjeve ndër-rajionale dhe ndërkufitare .....	94
5.2.3	Objektivi Strategik 3 - Vlerësimi i qëndrueshëm i burimeve ambientale si ne terma turistike dhe energjitike e minerare.....	97
5.2.4	Objektivi Strategik 4 - Vleresimi i zinxhirit te prodhimit bujqesor .....	102
5.3	Strategja insediativë territoriale.....	105
5.3.1	Sistemi territorial.....	108
5.3.2	Sistemi urban.....	123
5.4	Zgjedhja e indikatoreve të monitorimit.....	127
5.5	Përcaktimet kryesore për Termat e Referencës për Planet Sektoriale qe detajojne me tej PPV .	131
5.6	Përcaktimet kryesore për Termat e Referencës për Planet e Detajuara Vendore.....	132
<b>6</b>	<b>PLANI I VEPRIMEVE.....</b>	<b>163</b>



6.1	Matrica e prioriteteve dhe e investimeve te nevojshme .....	163
<b>7</b>	<b>SKEDAT E PROJEKTEVE.....</b>	<b>181</b>



## 1 HYRJE

Ky raport zhvillon Strategjinë hapësinore të bashkise së Dibres duke nisur nga vlerësimi i analizës territoriale zhvilluar në Fazën 1 në temat naturaliste, kulturore, gjeologjike, hidraulike, socio-demografike, socio-ekonomike, infrastrukturore, te trashëgimisë kulturore dhe zhvillimit të vendbanimeve. Analiza gjithashtu përfshin identifikimin e parashikimeve dhe strategjive të Planit Kombëtar për zonën e Dibres, që do të implementohen në PPV të qytetit. Riperpunimi kritik i të dhënavë te dala i ka dhene rruge përpunimit te analizës SWOT mbi te pesë sistemet e caktuara territoriale të percaktuara ne normativat urbanistike si strukturuese te parashikimeve te planit: sistemin urban (UB), sistemin e infrastrukturës (IN), sistemin natyral (N), sistemi i ujit (U) dhe sistemin bujqësor (B).

Relacioni paraqet si me poshte :

- Një kapitull i parë në të cilën jane përmbledhur rezultatet e kerkimeve të kryera në fazën e parë;
- Një kapitull i dytë që identifikon, në sajë të analizës SWOT, potencialin, pjeset kritike, kufizimet dhe nevojat për pesë sistemet territoriale e përmendura më sipër;
- Kapitulli i tretë në të cilën përshkruhet strategjia territoriale. Në veçanti, strategjia insediativë territoriale integrohet me strategjinë për 5 sistemet duke percaktuar objektiva strategjike, veprimet dhe projektet për zhvillimin e territorit në përputhje me identifikimin e nevojave dhe mundësive;
- Nje kapitull ne lidhje me projekzionet dhe vleresimet demografike per 2030
- Një plan veprimi që paraqet pamjen e përgjithshme te projekteve të identifikuara dhe ne të cilat janë paraqitur:
  - o Akse strategjike te Planit
  - o Objektiva
  - o Veprime
  - o Projekte
  - o Prioritetet dhe korniza kohore (afatshkurtër, afatmesëm dhe afatgjatë)
  - o Tipologjia e investimit (Publik, Privat, Mix)
  - o Vleresim i perafert i kostove
- Per cdo projekt jane redaktuar disa skeda implementimi qe percaktojne (Bashkengjitur.01) :
  - o objektivi i projektit
  - o pembajtja e projektit
  - o kritika ose nderlidhje me projekte te tjera eventuale



- aktoret ne terma te perfituesve dhe zbatuesve
- koha
- kostot

Për projektet strategjike të shkallës urbane qe marin një rëndësi të veçantë, janë hartuar projektet e duhura pilote në të cilën është bere i mundur dhe grafikisht zhvillimi i mundshem në terma fizike dhe hapësinore (Bashkengjitur.02)

### **1.1 Lista e perpunimeve te Fazes 2**

Me poshte gjendet lista e pote e perpunimeve:

#### **A.PERPUNIMET HARTOGRAFIKE**

Perp.01 – Tab 1.1 Analiza dhe vlerësimi i territorit. Sinteze Plani Kombëtar	shkalla 1: 50,000
Perp.02 – Tab 1.2 Analiza dhe vlerësimi i territorit. Gjendja e mjedisit	shkalla 1: 50,000
Perp.03 – Tab 1.3 Analiza dhe vlerësimi i territorit. Sistemi urban	shkalla 1: 50,000
Perp.04 – Tab 1.4 Analiza dhe vlerësimi i territorit. Sistemi Infrastrukturor	shkalla 1: 50,000
Perp.05 – Tab 1.5 Analiza dhe vlerësimi i territorit. Sistemi Natyror	shkalla 1: 50,000
Perp.05 – Tab 1.6 Analiza dhe vlerësimi i territorit. Sistemi Ujor	shkalla 1: 50,000
Perp.07 – Tab 1.7 Analiza dhe vlerësimi i territorit. Sistemi Bujqesor	shkalla 1: 50,000
Perp.08 – Tab 2.1 Vizioni Strategjik. Sistemi Urban	shkalla 1: 50,000
Perp.08 – Tab 2.2 Vizioni Strategjik. Sistemi Infrastrukturor	shkalla 1: 50,000
Perp.08 – Tab 2.3 Vizioni Strategjik. Sistemi Natyror	shkalla 1: 50,000
Perp.08 – Tab 2.4 Vizioni Strategjik. Sistemi Ujor	shkalla 1: 50,000
Perp.08 – Tab 2.5 Vizioni Strategjik. Sistemi Bujqesor	shkalla 1: 50,000
Perp.09 – Tab 3.1 Strategjia e ndertimeve. Strategjia Territoriale	shkalla 1: 50,000
Perp.10 – Tab 3.2 Strategjia e ndertimeve. Strategjia urbane e kryeqendres	shkalla 1: 50,000
Perp.11 – Strategjia e ndertimeve. Albumi i Strategjisë se ndertimeve te vendbanimeve kryesore.	

#### **B. MATERIALI NARRATIV**

**Perp.15 - Relacioni i Strategjisë se Territorit**

**Bashkengjitur.01-Skedat e Projekteve Pilot**

**Bashkengjitur.02-Matrica e prioriteteve dhe e investimeve te nevojshme.**

**Perp.16 – Raporti i Takimeve**

## **2 REZULTATET E ANALIZES DHE VLERESIMIT TE TERRITORIT**

Në këtë seksion gjenden disa sinteza te rëndësishme të nxjerra nga analizat e kryera në fazën e parë dhe si disa informacione te thelluara ne vazhdim. Për analizë të hollësishme është ende i referohet materialeve të prodhuara në hapin 1.

### **2.1 Parashikimet e planit kombëtar**

Plani i Përgjithshëm Kombëtar përcakton kuadrin e referimit për të gjitha planet e hartuara në Shqipëri; në fakt, ai përcakton parimet dhe udhëzimet për zhvillimin e qëndrueshëm të territorit, duke vodosur supozimet për krijimin e kushteve territoriale për zhvillimin rajonal.

Përveç kësaj, Plani i Përgjithshëm Kombëtar përcakton kuadrin e përgjithshëm për zhvillimin e infrastrukturës publike kombëtare, dhe përcakton kushtet për ruajtjen e ekosistemave dhe burimeve territoriale, nga ato nëntokësore në ato natyrore e kulturore, në lidhje me ndikimet e sistemeve urbane dhe të aktiviteteve ekonomike.

Plani i Përgjithshëm Kombëtar drejton objektivat ndërsektoriale të planifikimit rajonal, dhe koordinon objektivat e zhvillimit të sektorial me efekt mbi territorin; së fundi, një funksion i rëndësishëm qendrore që zhvillohet nga Plani ka te bëjë me kontrollin logjik në lidhje me udhëzimet dhe orientimet e perspektives se zhvillimit te hapesirës Evropiane.

Lidhja me dimensionin evropian të qeverisjes së territorit është perceptuar si një çështje shumë e rëndësishme, duke supozuar për të ndërtuar në menyre sa me te mire marrëdhëniet strategjike me shtetet fqinje që lindin nga stabiliteti politik, por edhe bazat për krijimin e një platforme që lehtëson aksesin e fondeve të alokuara në kuadër të programit evropian.

Ndersa për sa i përket qeverisjes territoriale në dimensionin e saj të brendshëm, plani zhvillohet në brendesi te një procesi me të gjerë reforme administrative e cila ka prodhuar një ridefinim te hierarkive territoriale mes qendrave urbane dhe territoreve, se cilave i korrespondon një unifikim dhe riorganizim mjetesh planifikimi hapësinor në shkallë të gjërë.

#### **2.1.1 Objektivat, politikat dhe vizioni i Planit**

Në nivel strategjik, Plani Kombëtar shpalos objektivat e mëposhtme:

1. Integrimi hapësinor në kontekstin evropian,
2. Përforcimi i konkurrueshmërisë ekonomike të Shqipërisë në nivel rajonal,
3. Sigurimi i integritetit fizik e territorial të peizazhit historik, kulturor, natyror dhe urban në të gjithë territorin kombëtar.

4. Rritja dhe përmirësimi i cilësisë së jetës nëpërmjet promovimit të rritjes ekonomike, eliminimit të pabarazive hapësinore dhe heqjen e pengesave për qasje në infrastrukturë dhe njohuri.

Për arritjen e këtyre objektivave, plani evidenton direktivat e projektimit në nivel politik, të cilat kanë të bëjnë me:

1. Zhvillimi i infrastrukturave kombëtare të lidhjes me korridoret e transportit ndërkombëtar;
2. Zhvillimi i rolit të Shqipërisë si pikë lidhëse për infrastrukturat energjetike të rajonit të Ballkanit;
3. Zhvillimi i Sistemeve Urbane Inteligjente;
4. Mbrojtja dhe zhvillimi i burimeve natyrore dhe trashëgimisë kulturore, edhe në aspektin e identitetit, duke përmirësuar aksesin dhe përdorimin;
5. Zhvillimi i sistemit të transportit multimodal qe lidhet me qëndrueshmërinë dhe transportin e integruar, i cili mbështet zhvillimin territorial policentrik;
6. Zhvillimi i infrastrukturave energetike funksionale në perdomin e burimeve energjitike të ripërtëritshme;
7. Projektimi dhe zhvillimi i një hub-i per te integruar flukset që lidhen me komunikimet, transportin, energjinë dhe produktet ushqimore i cili do te mundesonte efektivitetin e korridoreve të përmendura në paragrafin 1.

Politika të tillë përshkruajnë "vizionin" e përgjithshëm te Planit, i cili shtrihet në nivele dhe fusha të ndryshme, duke mbajtur te forta dy referenca te kontekstit të cilit i asociohen dy shkallë diskutimi, njëra e lidhur me kontekstin e gjerë evropian, dhe të tjera me ate te hapesires ballkanike.

Në rastin e parë, skenari i propozuar nga plani merr ne konsiderate krijimin e lidhjeve të infrastrukturës kombëtare që lidhin Shqipërinë me rrjetin e transportit trans-evropian, duke synuar forcimin e lidhjeve strategjike te vendit me anë të disa korridoreve që do të zhvillohen sipas një arsyetimi multi-sektorial:

- Korridori gjelbër (Shkodër, Hani Hotit - Kakavijë ,Gjirokastër)
- Korridori Blu (përgjatë bregdetit)
- Korridori VII, i cili lidh Detin Mesdhe me Detin e Zi
- Boshti qendror Elbasan, Berat - Jug
- Ruga e Arbrit

Në kontekstin Ballkanik, Shqipëria ka qëllim për të zhvilluar centralitetin e saj në lidhje me tematika të ndryshme, ndër të cilat qendron tema e energjisë: Shqipëria është në fakt vend kalimi

për korridore te ndryshme ndërkombëtare, të tilla si: Gazsjellësi Trans Adriatik (TAP), Gazsjellësi Jonian Adriatik (IAP) dhe IAP i KOSOVES përfundimt në Kosovë përmes unazës së Ballkanit Perëndimor (WBR), te cilave i shtohen funksionet e shkembimit tregtar dhe logistik te kater portave kryesore shqiptare, ndër te cilat ai i Vlores paraqitet me i rendesishmi ne frontin energjistik.

Plani evidenton gjithashtu pesë sisteme rajonale:

- Sistemi Urban
- Sistemi Bujqësor
- Sistemi Ujor
- Sistemi Natyror
- Sistemi i Infrastrukturor

Moto e sistemeve urbane është zhvilluar sipas një logjike "smart", pra e lidhur me rritjen e sistemeve urbane intelligente, duke u zhvilluar ne baze te tre parimeve, zhvillimit policentrik, dendësimit të indeve urbane dhe gjithpërfshirjes.

Në fakt, plani evidenton një hierarki të qendrave urbane, sipas te cilave identifikohen profilet perkatese ekonomike me qellim per te zhvilluar potencialitetin ekzistues sipas perspektives rajonale.

Në fakt, këto strategji ballafaqohen me një fenomen që ka karakterizuar 25 vitet e fundit, pra migrimin progresiv drejt rajoneve të Tiranës dhe Durrësit , në kontekst më të përgjithshëm kemi spostimin e popullsisë nga zonat malore lindore drejt utesires perëndimore: ky është një proces që ka induktuar pabarazi të forta territoriale dhe ka dëmtuar cilësinë e jetës së zonave urbane të prekura nga fluksi i njerezve.

Per te zbutur pabarazine e krijuar, Sistemi Urban sipas Planit Kombetar propozon :

- 6 rajone ekonomike parësore
- 9 qendra kryesore primare
- 10 qendra të specializuara
- 42 qendra lokale

Zhvillimi urban policentrik, propozon një raport të ri mes zonave urbane dhe rurale, duke u fokusuar nga njëra anë në kontrollin e zgjerimit fizik të qytetit, përfundimt dendësimin e gjendjes ekzistuese, dhe nga ana tjetër në një qasje më të mirë, mbi aksesibilitetin, multifunksionalitetin dhe komplementaritetin e zonave bujqësore dhe natyrore dhe te trashegjmise historiko- kulturale; një pjesë e rëndësishme ka të bëjë me menaxhimin e

ekosistemave "urbane" dhe në mënyrë të veçantë me mbylljen e ciklevës të ujit, energjisë dhe mbeturinave.

Sektori bujqësor prodhon 20% të GDP-së kombëtare dhe siguron punësim për rreth 50% të popullsisë aktive: sistemi bujqësor i identifikuar nga plani mbulon 40% të sipërfaqes së përgjithshme të Shqipërisë, me 34% të tokës bujqësore të lokalizuar në luginat e lumenjve dhe 23% në zonat malore. Ky sistem territorial investohet në dy angazhime themelore të përcaktuara në Planin Kombëtar: atë të ndalimit të urbanizimit në zonat rurale dhe ai i promovimit të një modernizimi që kalon përmes krijimit të zinxhirit të furnizimit fitimprurës, të cilat ofrojnë produkte me një shkallë më të lartë përpunimi dhe rafinimi, por edhe përmes investimeve të cilat kanë për qëllim pëtë zvogëluar kostot e prodhimit dhe pëtë rritur cilësinë, përballet risive teknologjike, sidomos në aspektin e infrastrukturës dhe të teknikave të ujitjes. Pjesa e fundit, por jo pëtë nga rëndësia, është integrimi me sektorët e tjera (turizëm, transport, energji) dhe vlerësimi i tregut të produkteve tip, edhe nëpërmjet futjes dhe fuqizimit të markës "Made in Albania", në lidhje me prodhimet karakteristike (bimët mjekësore, arrat, ullishte dhe vreshta, perime tipike si dhe produktet përkatëse të tyre të përpunuara).

Sistemi natyror i Shqipërisë aktualisht karakterizohet nga prania e 15 parqeve kombëtare, 22 rezervave natyrore të cilave i shtohen peisazhe të tjera të mbrojtura, monumente natyrore, etj. Në këtë kontekst, plani angazhohet pëtë rritur përqindjen e zonave të mbrojtura natyrore (mbi 20% në rastin e zonave tokësore dhe mbi 15% në rastin e atyre detare), duke përmirësuar në të njëjtën kohë aksesibilitetin; në mënyrë të veçantë konsiderohet strategjik projekti i Rrjetit Kombëtar te çiklizmit, dhe i tre parqeve të Alpeve, Vjosës dhe Bunës.

Në mënyrë më të përgjithshme, drejtimi i përcaktuar nga plani është pëtë mbrojtur zonat natyrore të pakufizuara nga funksionet e tyre mjedisore, duke forcuar në mënyrë të veçante korridoret lidhës përgjatë bregdetit, me funksione të ngjashme pëtë ruajtjen e rezervave ujore. Çështjet që lidhen me furnizimin me ujë, dhe në veçanti me aksesibilitetin dhe rindarjen e balancuar të burimeve në nivel kombëtar, shfaqen thelbesoresh në raport te planit që lidhet me sistemin hidrik, të cilat fokusohen si mbi kerkesat e kontrollin e tërheqjeve në lidhje me bujqësinë dhe industrinë, ashtu dhe mbi çështjet e burimet perkatese, si në rastin e shkarkimeve të mbeturinave urbane dhe shfrytezimit intensiv të zhavorrit të lumit. Gjithashtu propozohen strategjite ndërsektoriale në lidhje me fusha të tjera, si në rastin e zgjedhjes se luginave lumore si korridore kryesore ekologjike lidhese, të riorganizimit te sistemit të furnizimit me ujë dhe të infrastrukturës higjeno-sanitare, në lidhje me sistemin e ri hierarkik të qendrave urbane dhe nevojave te menaxhimit të qytetit.

Sa i përket sistemit të infrastrukturës, çështjet kryesore kane te bejne me transportin dhe energjinë.

Në rastin e parë tema kryesore eshte ajo e krijimit te një sistemi të integruar multimodal, në fushen e transportit, ne kuader te se ciles parashikohet realizimi i:

- 2 aeroporte të reja (ne veri dhe jug),
- 3 stacione kombëtare intermodale (Fier, Elbasan, Berat),
- 10 stacione ndërkombëtare intermodale (Tiranë, Durrës, Leshë, Shkodër, Kukës, Pogradec, Korçë, Vlorë, Sarandë, Gjirokastër).

Ajo gjithashtu synon në zhvillimin e porteve të Durrësit, Vlorës, Sarandës dhe Shëngjinit, me funksione të ndryshme e të ndara ne brendi te secilit, duke filluar nga logistika, energjia, peshkimi, turizmi.

Në të dyja rastet kemi të bëjmë me strategjitet lidhëse dhe plotësuese përsa i përket realizimit të korridoreve të mëdha te lidhjes evropiane.

Energjia konsiderohet si fushë kryesore per sa i përket realizimit te gazsjellësve ndërkombëtar, tregtise detare të lëndëve të para, por edhe për sa i përket efikasitetit energjistik (kursimit të energjisë, përdorimit të energjisë së rinovueshme, eficencës energetike, reduktimit të emetimit të CO<sub>2</sub> në atmosferë), siç parashikohet nga Strategjia Kombëtare Energjetike 2013-2020.

Më në fund, plani synon të ndërtojë një strategji të zhvillimit rajonal në lidhje të ngushtë me programin evropian, duke u bazuar në identifikimin e:

- rajonet ndërkufitar;
- rajone ekonomike kombëtare;
- rajone të specializuara

Në veçanti rajonet ndërkufitar janë të prekur nga financimi IPA ndërkufitar, i cili për 2014-2020 do të sigurojë Shqipërisë 75 milionë euro ,për projektet në kufirin midis Shqipërisë dhe Greqisë (rreth 42 million euro), Shqipëria dhe Mali i Zi (rreth 12 milionë euro), Shqipëria dhe Maqedonia (rreth 12 milionë euro), Shqipëria dhe Kosova (rreth 8.5 milionë euro). Behet fjale per fonde të lidhura me projekte në fushën ekonomike, të lidhura me infrastrukturën rrugore, trashegimnine natyrore, historike e kulturore, shëndetësinë, arsimin dhe kulturën.

Siç i përket rajoneve kombëtare ekonomike, zona e vetme që aktualisht mund të cilësohet si një rajon i tillë i mirfillte është ai i Tiranë - Durrës, por Plani Kombëtar percakton projekte strategjike përfuqizimin edhe te 6 rajoneve të tjera të rëndësisë kombëtare.

Në veçanti jane formuluar strategjitetë në lidhje me projektet:

- Porta e Veriut (raioni Shkodër, Lezhës dhe raioni i Kukësit)
- Motori Qendror (raioni ekonomik i Tiranës dhe Durrësit)
- Rajoni ekonomik i Vlorë-Berat-Lushnje-Fier
- Porta e Jugut (raioni ekonomik i Gjirokastrës dhe Sarandës)



## 2.1.2 Parashikimet ne lidhje me Dibrën


Ne paragrafin e meposhtem do te pershkruajme permbajtjen e materialit hartografik me parashikimet per territorin e Kukosit dhe nje nje pershkrim i shkurter i parashikimeve te planifikuara ne planin kombetar.

Materiali grafik i analizuar me poshte vijon:

1. Energji Industri
2. Sistemi Urban
3. Sistemi Natyror
4. Sistemi Bujqesor
5. Infrastrukture Transport
6. Potenciali Turistik

Parashikimet strategjike të planit nxjerrin në pah aksin ndërkufitar me Maqedoninë, i identifikuar mes Dibrës dhe Gostivarit.

## ENERGJI\_INDUSTRI






Vihet re prania e dy stacione të mëdha hidroelektrike (nga të cilat një është në kufi me Kukësin) dhe katër nënstacioneve.

Gjithashtu e rëndësishme është dhe prania e depozitave të kromit dhe depozitave jo-metalike (mermer, allçi), të cilat përfaqësojnë një nga burimet kryesore natyrore me te cilat është i pajisur rajoni.

Zona përshkohet edhe nga një shumëlojshmëri e linjave të transmetimit të energjisë, ndërmjet të cilave plani TAP dhe një linjë e transmetimit (aktualisht në ndërtim e sipër) që lidh centralin hidroelektrik qendror me nënstacionin fqinj.

## SISTEMI NATYROR



### LEGJENDA


- Port kryesor
- Metropol
- Qendër primare
- Qendër sekondare
- Qendër terciare
- Qendër lokale e specializuar
- Monument natyre
- Rrjeti i Zonave të Mbrojtura (elazitues dhe i propozuar)
- Zonat me përparrësi zhvillimin e turizmit (elazituese)
- Korridore natyrore të propozuara
- Tokë pyjore
- Itinerar vozitës
- Itinerar bikëqetash
- Zona/ Pika turistike
- Site UNESCO elazituese
- Site UNESCO të propozuara
- Rrugë Bredhetare Pejzazhistikë
- Brezi i Gjelbër European
- Monument kulturore

Vërehet prania e zonave të mëdha të mbrojtura përgjatë kufirit, me të cilat lidhet identifikimi i planit të përgjithshëm të zonave me përparrësi për zhvillimin e turizmit; eshtë e rëndësishme gjithashtu dhe prania e një koridori lumor dhe e pyjeve e sistemeve komplekse të kultivimit në afersi të qendrave urbane dhe përgjatë rrjedhave ujore. Mes mundësive të zbuluara nga plani, zbulohet prania e një pike 'hotspot' në territorin e Dibrës.

Në hartën që vijon, mbivendosja e dy temave të mëparshme thekson problemet e mundshme që lidhen me praninë e depozitave minerale dhe sistemeve për prodhimin, transformimin dhe trasmetimin e energjisë hidroelektrike të vendosura brenda zonave të mbrojtura.




## SISTEMI BUJQESOR




- Metropol
- Qendër primare
- Qendër sekondare
- Qendër terciare
- Qendër lokale e specializuar
- Qendër e transferimit të teknologjisë bujqësore / Fushë-Krujë, Lushnje, Vlorë, Korçë, Shkodër
- Pol bujqësor / Shkodër, Dibër, Tiranë, Lushnje, Korçë, Sarandë
- Toka me kultivim kompleks / tokë bujqësore
- Vreshtarë
- Pemë frutore
- Ullishtë
- Pyje
- Kufi bashkiak
- Infrastrukturë rrugore
- Lumë
- Vijë uji
- Digë (Grupi A)
- Digë (Grupi B)
- Digë (Grupi C)
- Port detar
- Pikë kuftare / ekzistuese
- Pikë kuftare / e propozuar

## INFRASTRUKTURE TRANSPORT




Përgjatë kufirit lindor identifikohet Brezi i Gjelbër Evropian: bëhet fjalë për një lidhje shumë të rëndësishme ekologjike, një nga akset e rëndësishëm të rrjetit ekologjik mbarë-evropian, ndërtimi i të cilit mbeshtetet në praninë e zonave të mëdha natyrore që u zhvilluan në mungesë të aktivitetit të antropizimit që ka kundërshtuar gjatë "perden e hekurt", dmth kufirin fizik mes dy blloqeve të shteteve të kundërtta. Dibra është identifikuar si një qendër bashkiake, e vendosur në afërsi të shumë lokaliteteve të përshtatshme për kalimin e kufirit drejt Maqedonisë (kufiri jugor është qendra e Blate) dhe e turizmit që lidhet me zonat e mbrojtura (qendrat turistike të Lure dhe Luzni-Bulac), të lidhura me Dibrën me rrugë kryesore dhe dytësore interurbane, të cilave i shoqërohen "itinerare të veçanta lidhjeje", prej të cilave ajo drejt Krujës (dhe nga këtu drejt Tiranës) është parashikim i projektit të Planit të Përgjithshëm Kombëtar. Në analizimin e rrugëve lidhëse, Peshkopia përshkohet me autobus, bicikletë dhe rrugë automobilistike drejt Kuksit, ndërsa qasja nga Tirana sigurohet vetëm nga infrastruktura rrugore, me të cilën lidhen dhe linjat urbane. Ekzistojne gjithashtu edhe korsite e bicikletave me qendrat e Mirditës dhe Matit.

## POTENCIALI TURISTIK



- |                                    |  |
|------------------------------------|--|
| — Kufiri bashkiak                  | ■ Brezi bregdetar _zonë me rënësi kombëtare  |
| — Kufiri i Shqipërisë              | ■ Parku i Alpeve, Bunes, Vjosës              |
| — Lumenj                           | ■ ZM_Kategoria I                             |
| — Itinerari kulinar - agroturistik | ■ ZM_Kategoria II                            |
| — Itinerari alpino - ljenor        | ■ ZM_Kategoria III                           |
| — Itinerar vozitës                 | ■ ZM_Kategoria IV                            |
| ■■■ Alse rrugore panoramike        | ■ ZM_Kategoria V                             |
| ■■■ Zona buferike e lumenjve       | ■ ZM_Kategoria VI                            |
| ○ Ujërat termale                   | ■ Zona me përparsi për zhvillimin e turizmit |
| ▲ Qendra muzeale                   | ■ Rjeti Emerald                              |
| ○ Kanionet e Osumit/Vjosës         |  |
| ■■■ Site të UNESCO-s elzistuese    |  |
| ■■■ Site të UNESCO-s të propozuar  |  |
| ● Monumentë natyre                 |  |

## SISTEMI URBAN



## LEGJENDA

	Metropol
	Qendër primare
	Qendër sekondare
	Qendër terciare
	Qendër lokale e specializuar
	Aeroport ekzistues
	Aeroporti i jugut - i mundshëm
	Port kryesor
	Port energetik
	Marinë
	Zonë ekonomike
	Hub logistik
	Qendër e karkimit shkencor
	Pol i zhvillimit rajonal
	Zonë me specifikë zhvillimi
	Kufiri i njësise vendore
	Korridor kryesor kombëtar
	Korridor kryesor kombëtar i përforuar
	Ndërlidhje e fortë rajonale primare
	Ndërlidhje e përforuar rajonale primare
	Ndërlidhje e fortë rajonale sekondare
	Ndërlidhje e përforuar rajonale sekondare
	Zonë monumentale e mbrojtur UNESCO
	Zonë e propozuar përtu marrë në mbrojtje nga UNESCO
	Termocentrale
	Qendër e zhvillimit të industrije përpunuese



Në lidhje me ndarjen e zonave kryesore dhe zonave të specializuara të zhvilluara nga plani, Dibra së bashku me Bulqizën paraqesin fokusin e një zone bipolare që përfshin edhe qendrat lokale të Matit dhe Klosit.

Bashkia e Dibrës në fakt është renditur nga Plani i Përgjithshëm Kombëtar (PPK) në mesin e zonave ekonomike të specializuara.

Zona "Dibër-Mat-Bulqizë" karakterizohet nga prania e turizmit malor, natyror dhe balnear, por specializimi i vërtetë ekonomik i zonës ka të bëjë me nxjerrjen dhe përpunimin e mineraleve, si dhe zhvillimin industrial e teknologjik që lidhet me këto aktivitete.

Në objektivat strategjike kombëtare të Bashkisë së Dibrës kryesore është lokalizimi në arterien e "Korridorit 8", i përbërë nga projekti i "rrugës së Arbërit", i cili përcakton lidhjen me Shkupin, Sofjen dhe Stambollin; sipas një logjike të përgjithshme të integrimit funksional, ku theksohen gjithashtu dhe mundesitë e shkëmbimit, nga pikëpamja energetike dhe e korridoreve natyrore etj, që lidhen me realizimin e kësaj infrastrukturë.

## 2.2 Analiza metabolike dhe vleresimi i territorit

### 2.2.1 Treguesit demografik kryesorë

#### 2.2.1.1 Karakteristika të popullsisë

1. **Numri i Popullesise ne renjë – Gjate përiudhes 1989- 2011, si rezultat i levizjeve të brendëshme të popullsisë (*migrimi i brendëshem*), kemi pasur njërenjëprej gati 40% të popullsisë edhe pse rritja natyrore ka qenë positive dhe prej me të lartave në vend.**

- **Ritmi i renjes së popullsisë gjatë dekadave 1989-2001 dhe 2001-2011 ka qenë në rritje : shpopullimi ka filluar në përiudhen e pare(89-01) por ka vijuar me ritme akoma me të lartë në përiudhen në vijim(01-11). Gjatë viteve 2001-2011 të gjitha NJQV-të kanë pësuar ulje të numrit të popullsisë, përfshire edhe bashkinë e Peshkopisë dhe komunen Fushë Cidhen, të cilat kishin regjistruar rritje gjatë përiudhes paraardhese 1989-2001.**
- **Trendi i ndyshem i ndyshimit të popullsisë midis zonave urbane dhe atyre rurale: Si rezultat i migrimit të brendëshem, popullesia rurale ka pasur renjen ndërsa ajo urbane është rritur. Migrimi ka pasur natyre të dyfishte: nga njera ane, banorët e zonave përiferike migrojnë drejt qytetit të peshkopisë dhe nga ana tjeter, kemi njëmigrim nga qyteti i Peshkopisë drej qëndrave urbane kombëtare (Tirana dhe Durrësi) apo edhe jashtë vendit. Si rezultat , popullsia rurale ka pësuar renjëtë ndjeshme , në disa rastë edhe mbi 80%, ndërsa popullsia urbane ka pësuar rritje ( qytreti i peshkopise +7.6%)**

2. **Dendësia mesatarisht e ulet , sidomos në zonat rurale malore**

3. **Popullsia urbane/rurale:** Popullsia e zonës së dibrës ka qenë dhe është kryesisht rurale. Duke filluar qe nga fillimi i viteve '90 kemi njëtendence evidentë të reduktimit në numer të popullsisë si dhe levizje të popullsisë nga fshati në drejtim te qytetit, duke shkaktuar luhatje të ndjeshme të raportit popullsi urbane-popullsi rurale.

4. **Përbërja gjinore:** Dominace e meshkujve me raporte gjinor mesatar > 105. Disa zona rurale kanë raporte >110

5. **Përbërja sipas grupmoshave :** Popullsia e Dibrës, është njëpopullsi relativisht e re, me grupmoshen 15-64 vjec qe ze peshën kryesore me rreth 66 % të totalit të popullsisë banuese, e ndjekur më pas nga grupmosha 0-14 vjec me 26% si dhe të moshuarit me rreth 8%. Ky fenomen karakterizon të gjitha komunat.



6. **Raportet e varësisë:** Zona e Dibrës ka njëkoeficient të varesisë së përgjitheshme prej 52.1, ku koeficineti i varesisë së të rinxje ze peshën me të madhe me 40.1, ndërsa koeficienti i varesisë së të moshuarve është reth 12.
7. **Lindshmeria:** ka koeficientin bruto të lindjeve me të lartë në shkallë vendi prej 14 lindje për 1000 banorë. Kjo zonë vijon të ketë norma të larta të lindjeve por sidoqoftë në renjënë krahasim me përiudhat e meparshmë. Situata paraqitet e ngashme në të gjitha komunat.
8. **Vdekshemria:** Për shkak të përmirësimeve të mëdha në sistemin shëndetësor dhe në shëndetin publik, vdekshmëria ka pasuar rënje të qëndrueshme për të gjitha moshat vdekshmeria luhatet në intervalin 6-7 vdekja për 1000 banorë. Situata paraqitet e ngashme në të gjitha komunat.
9. **Emigrimi dhe migrimi i brendëshem:** Qarku i Dibrës, së bashku me atë të kukësit, jaanë dy zona ku migrimi i brendëshem drejt zonave urbane është po aq i rëndësishem sa migrimi ndërkombëtar. Këto zona kanë pasur dhe vazhdojnë të kenë njëshpopullim të fshatrave të zonave malore drejt qytetit të peshkopisë dhe në të njejtën kohe njëspostim të brendëshme nga qyteti i Peshkopisë drej qëndrave kombëtare si Tirana dhe Durrësi. Sic e theksuan edhe me lart, flukset dalesë të popullsise tejkalojnë ndjeshem flukset hyresë qe do të coj në njëreduktim të popullsise në të ardhmene. Kjo ka sjelle në njërenjëtë numrit të popullsise, pamvarsisht rritjes natyrore qe rezulton positive.
10. **Trendi i popullsise - Tranzicion denografik me njëpopullesi drejt plakjes :** Renjëe numrit të lindjeve me ritme të larta, rritje e jetëgjatesisë si pasoje e përmirësimit të nivelit të jetës
11. **Të tjera karakteristika socio-demografike**
  - **Kombesia dhe pakica kombëtare:** Sipas të dhënave të censusit të vitit 2011, zona e Dibrës përbehet kryesisht nga shtetas me kombesi Shqiptare, ndërsa kemi njëpresence minimale të etnive të tjera në pak komuna dhe gjithsesi me peshë ne 1% popullsise. Në ketë zonë nuk ka asnjëpakuice etnike përfaquesë por kemi njëshpérndarje sporadike dhe johomogenë të tyre.
  - **Gjuha e folur dhe pakicat liguistike:** Shqipja është gjuha qe flitet nga thuajse 99% e popullsise. Pakicat linguistike ekzistojnë por në raport me totalin pesha e tyre është mjaft e limituar.
  - **Përkatesia Fetare:** kjo zonë rezulton me dominace të theksuar të fesë muslimanë e cila historikisht ka qenë besimi fetar në pothuajse totalin e popullsise. Ne komunat Arras, Fushë Cidhen, Kala e Dodes, Maqellare, melan, Tomin, Sillove, dhe Zall Rec përqindja e muslimaneve është mjaft prane 100%. Fe të tjera prezantë janë : Feja katolike, Ortodoksë dhe bektashi ( dy të fundit me shifra marxinale).

**12. Prezenca e aftësive të kufizuara:** *Niveli mesatar i zonës* i popullsisë qe me të pakten njëaftësi të kufizuar është 5.6%, ndërsa shumatorja e aftësive të kufizuara prezentë në popullsinë banuese është 11.9%. Disa komuna, ndyshe nga të tjerat, kanë përqindje me të larta së mesatrja e zonës në përgjithesi dhe për anomali të caktuara në veçanti. Si psh: Komuna Arras, Fushë Muhur, Zall Dardhe, Selisht, Zall Rec, Sllove, Melan, Kala e Dodes e Kastriot kanë përqindje me të larta së mesatrja si të pësonave me të pakten njëaftësi të kufizuar ashtu edhe për shumatoren e aftësive të kufizuara. Zonat qe kanë prezencen me të ulet të aftësive të kufizuara në raport me popullsisë banuesë janë: bashkia Peshkopi (2.6%), Lurë (2.2%), Maqellare 3.7% dhe Qendër Tomin (4%).

- **Lloji I aftësisë së kufizuar** qe mbizotron në të gjitha komunat është anomalia në ecje, e cila përben gati njëtë treten e anomalive fizike prezentë në popullatë. Më pas renditën kufizimet në komunikim me 17.4% të totalit, problemet në kujtese 16.5%, në kujdesin ndaj vvetes 14.1% dhe në fund kufizimet në degjim (12.1%) dhe në shikim(10.8%).

**13. Statusi civil , lloji bërthamave familjare dhe madhësia mesatre e familjes**

- **Statusi civil:** dominon familja tradicionale patriakale dhe lidhjet farefisnore janë mjaft të forta. Fenomenet e urbanizimit si për shembul divorci apo shtyrja e moshes së martesës janë mjaft të kufizuar në të gjithe zonen. Kjo vlen si për qëndrat urbane po ashtu edhe për ato rurale. Siaps censusi 2011, mesatarisht 60% e meshkujve rezultojnë të martuar dhe kjo përqindje është akoma edhe më e lartë tek femrat.
- **Madhësia mesatare e familjeve** është 5.1 përsone për familje. Kjo është nga me të lartat në vend dhe vjen nga niveli i lartë i lindjeve qe vijon të mbetet nga me të lartit në vend, 14 lindje për cdo 1000 banorë. Vihet re së zonat rurale kanë madhësi mesatare me të lartë së zonat urbane si dhe madhësia e familjes lidhet në përpjestim të drejtë me nivelin e jetës së varférinë.
- **Llojet e bërthamave familjare:** Forma dominuese është çift i martuar me fëmijë.
- **Familje me shumë së gjashtë përsone:** përbëjnë tipologjinë dominuese në pjesen me të madhe të komunave. Në disa rastë të veçanta regjistrohen përqindje mjaft të larta, sic është rasti i komunave Kala e Dodes me 57.1%, Zall rec 48%, etj.
- **Kryefamiljar femer:** është njëforme jo e zakoneshme ne këto zona me përqindje qe luhaten nga njëminimum prej 3.5% në komunen Sllove njënjëmaksimum prej 11.5% në lurë.
- **Kryefamiljar pensionist:** Familjet ku kryefamiljari është pensionist përbëjnë njëpjesë te vogel totalit të familjeve.
- **Cift me fëmijë :** Nen ndikimin e vlerave të forta konservatore , familja tipike patriakale vijon të jetë forma dominuese e organizimit familjar, me shifra qe në varesi të

komuave kanë vlera nga 60-70%. Këto zona kanë numer të lartë të martesave si dhe moshe mesatare **martesore** me të ulet së mesatarje e Shqipërise, sidomos tek femrat.

- **Cift pa fëmijë:** frekuence e ulet në përgjithesi në të gjitha komunat, zakonisht nen 10%. Mospasja e femijve vjen vetëm si pamendesi fiziologjike sesa si zgjedhje ekonomiko-sociale apo mënyrë jetëse.
- Vlen për tu theksuar së në qëndrat urbane, qyteti I Peshkopisë dhe komuna Maqellare për rastin në fjale, vihet re njëlloj *evolimi i strukturës familjare* drejt formave ma pak tradicionale, ndryshe nga pjesa rurale e cila mbetet brenda kornizes së familjes patriakale, me shumë fëmijë, ku divorci është akoma njëtabu dhe ku familjet me vetëm njëprind përbejnë përjashtime të veçuara.

#### 14. Statistika Juridike

- **Numri i veprave penale dhe lloji i tyre:** peshën me të madhe e zenë aktet kundër rendit dhe standardeve të sjelljes me reth 76% të totalit. Në vend të dytë për nga frekuanca vije krimet në fushën ekonomike dhe financiare me 7.4% ndjekur nga krimet në fushën e korruptionit me 6.4%, ato në fushën e droges 4.5% si dhe kundër përsorit 3.4%. Kategoritë e tjera kanë peshë specifike relativisht të ulet. Në nivel qarku, Dibra ka numrin me të ulet të veprave penale për cdo 1000 banorë. Ajo regjistrion 6.2 veprave penale për 1.000 banorë nga 8.5 qe është mesatarja kombëtare. Në raport me qarqet e tjera të shqipërisë dhe me mesataren kombëtare, Dibra ka përqindje me të uleta për krimet kundër prones, trafiqet e paligjeshme dhe atyre në fushën e droges. Ndërsa pozicionohet me lart sa i takon krimeve kundër përsorit dhe Korruptionit. Për pjesen tjetër të grupveprave është në linjëme mesataren kombëtare.
- **Numri i të burgosurve:** Në vitin 2010, në qarkunë dibrës kishim 251 të burgosur prej te cilëve, 248 ishin mbi 15 vjec ndërsa vetëm 3 prej tyre ishin nen 18 vjec. Numri i të burgosurve në vitin 2014 ishte 296 ku 293 ishin mbi 18 vjec dhe përsori 3 persona ishin nen 18 vjec. Numri i të burgosurve për përiudhen 2010-2014 është rritur me 17.9%. Kjo norme është vetëm pak më e ulet sesa mesatrja e Shqipërisë prej 18.5%.
- **Dhuna në familje:** Në vitin 2014 , në qarkun e Dibrës kemi rreth 7.6 raportime për 10.000 banorë. Nga 349 raportime të dhunës në familje gjithsej gjatë 2010-2014, vetëm 4.6% janë raportuar gjatë vitit 2010, 13.2% gjatë vitit 2011, 36.4 % e tyre janë raportuar në vitin 2012, 16.3% ne 2013 dhe 29.5% gjatë vitit 2014. Sic shihet qartë tendencia e raportimeve është në rritje pasi raportimet për vitin 2014 janë rreth 6 here me shumë së ato të vitit 2010.

#### 15. Statistika të shëndetësise: Jetëgjatësia në shqipëri vazhdon të rritet dhe kjo pjesërisht mund të shpjegojë ndryshimet demografike në strukturën e popullsisë, si dhe stilin e jetësës. Vëmendje e politikave ka qenë gjithnjë e fokusuar në cilësinë e jetës. Institucionet bazë që ofrojnë këto shërbime janë: Spitalet, poliklinikat, qëndrat shëndetësore,

ambulancat dhe shërbimet e veçanta të konsulitorit të fëmijëve dhe të gruas. Shumica e banorëve të Dibrës shërbimet bazë publike i përfiton në qytetin e Peshkopise. Spitali rajonal i Peshkopisë me 10 pavione, 340 infermiere, 23 doktorë është qëndra më e madhe që mbulon gjithë zonën.

- **Numri i shtreterve në spitale:** Gjatë viteve të fundit numri i shtreterve në dispozicion në shkallë vendi ka rene, kjo situatë u reflektua edhe në qarkun e Dibrës ku nga 27 shtreter për 10.000 banorë qe kishim ne 2009 u reduktuan ne 25 në vitin 2013. Konkrektisht, numri i shtreterve është reduktuar nga 542 qe kishim ne 2009 ne 512 shtreter ne 2013.
- **Numri i poliklinikave:** Numri poliklinika ve ka mbetur i pandyshuar gjatë viteve të fundit. Vijojnë të mbeten 3 poliklinika ashtu si në shumicen e qarkeve të shqipërise. Krahasuar me nivlein mesatar në shkallë vendi, për vitin 2013 kemi njëpoliklinike për cdo 46.130 banorë ndërkohë qe mesatarja e vendit është 1 poliklinike për 62.986 banorë. Sidoqoftë ketu duhet marre parasysh jo vetëm numri i banorëve por edhe shpërndarja e popullsisë sipas zonave. Aksesi i zonave malore në shërbimet shëndetësore mbetet problematik.
- **Numri i Qëndrave shëndetësore:** Gjatë viteve 2009-2013 numri i qëndrave shëndetësore është reduktuar duke zbritur nga 39 qëndra në vitin 2009 ne 34 qëndra shendetësore në vitin 2013. Krahasuar me mesataren kombetar prej 7085 banorëve për qendër shëndetësore, kjo zonë pozicionohet me lartë pasi rezulton me 4070 banorë për qendër shëndetësore. Por në rast së marrim në konsideratë numrin e fshatrave dhe largesinë e tyre me qëndrat urbane njëpjesë e madhe e popullsisë së zonave malore e ka mjaft të veshtire aksesin në qëndrat shëndetësore
- **Numri i ambulancave:** Numri i ambulancave ka ardhur në rritje edhe pse modeste, duke kaluar nga 158 në vitin 2009 ne 163 të vitit 2013. Mesatarisht kemi njëambulance për 850 banorë ndërkohë qe mesatarja e vendit është 1450 banorë/ambulance.
- **Numri i konsulitorit të gruas dhe fëmijës:** Situata rezulton e pandryshuar gjatë të njëjtë përiudhe me 187 qëndra ne 2013 nga 188 qe ishin ne 2009. Krahasuar me mesataren e vendit kemi njëkonsultor për cdo 740 banorë nga 1380 qe është mesatarja kombëtare

## 16. Statistika Arsimore

- **Alfabetizimi:** Si rezultat i trashigminisë së përiudhes komuniste (1945-1990) analfabetizmi nuk përbën problem shqetesues. Situata e analfabetizimit paraqitet e kenaqeshme në bashkinë e Peshkopise (1.6%), Lurë ( 1.6%) dhe Maqellare(2.1%) ndërsa normen me të lartë e kanë komunat Zall Rec(5.2%), Luzni(5.2%), Fushë Cidhen(4.4%), Arras(4.5%). Pjesa tjetër e komunave kanë vlera të përfshira në intervalin 2.5%-3.5% .
- **Ndjekja e Arsimit:** *Arsimi fillor baze* është relativisht e kenaqeshme me shifra qe varijojnë nga 70%-80% të popullsisë. Me problematike është ndjekja e *arsimit të mesem* sidomos në ato komuna malore qe paraqesin veshtiresi komunikimi. Si gjithome gjejme

ketu komunat, Kala e Dodes, Luzni, Selishte, Zall Rec etj. Ndjekesit e arsimit të mesem janë në relativisth në nivele të mira në qëndrat urbane( peshkopi) dhe në komunat në afërsi të tyre ndërsa ka deficencia në disa komuna si për shembull:Kala e Dodes, Luzni, Selishtë apo edhe Zall Rec. Ndjekja e *arsimit të lartë rezulton mjaft e ulet.* Me përjashtim të bashkisë së peshkopise, ku të regjistruarit ne arsimin e lartë janë 11.3%, pjesa tjetër e komunave rezultojme me përqindje mjaft minimale me njëmesatare rrëth 4.3%. Disa komuna malore si për shembull Kala e Dodes, Zall Rec, Zall Dardhe, Selishte, Luzni arsimi universitar rezulton nen kuoten 1.5%.

- **Arsimi 9 vjecar:** Gjatë përiudhes 2009/10 indikatoret e arsimit 9 vjecare tregojnë për njërenjtë lehtë e cila rezulton mesë e natyrshme po të kemi parasysh renjen e lindshmerisë gjatë viteve të fundit.
- **Numri i shkollave 9-vjecare** ka mbetur i njejtë në përiudhen 2009/10-2013/14 ndërsa numri i mësuesve, numri i nxënësve të regjistruar si dhe numri i nxënësve të diplomuar ka pësuar renje. **Numri i mësuesve** është reduktuar me rrëth 14% ndërsa **numri i nxënësve të regjistruar** dhe i atyre të diplomuar me rrëth 20%. **Mesatrja nxënës për mësues** në arsimin 9 vjecar në vitin 2013/14 është 14 nxënës për mësues nga 15 qe ishtë në vitin shkollor 2009/10. Pjesa më e madhe e shkollave 9 vjecare , rrëth 90% e tyre, ndodhen në zonat rurale.
- **Indikatoret e arsimit të mesem:** në përgjithesi kanë ndyshuar pozitivisht. Gjatë të njës përiudhe është rritur **numri i shkollave të mesme** nga 23 ne 25 dhe është rritur gjithashtë **umri i mësuesve** (nga 329 ne 345), **numri i nxënësve të regjistruar** (nga 6270 ne 6925) si dhe numri i nxënësve të diplomuar (nga 1762 ne 1844).
- **Raporti nxënës për mësues** është rritur por jo në mënyrë domethenese (nga 19 ne 20 nxënës për mësues). Në arsimin e mesem mbizoterojnë të regjistruarit në gjimnaze për të gjitha vitet me rrëth 95% të të regjistruarve. Njënga arsyet kryesore është prezenca minimale e arsimit professional.
- Sa i takon **aspektit gjinor**, si në pjesmarrjen në shkolle ashtu edhe në mesidhenje,të dy gjinjët ndjekin të njetin trend dhe nuk rezultojnë disbalanca gjinore. Numri i meshkujve është lethesisht më i lartë por sidoqoftë në linjëme raportin gjonor të zonës.

## 2.2.2 Të tjera informacionë socio – ekonomike

### 2.2.2.1 Përbërja etnike

Sipas te dhënave te censusit të vitit 2011, zona e Dibrës përbhet kryesisht nga shtetas me kombesi Shqiptare, ndërsa kemi njëpresence minimale të etnive të tjera në pak komuna dhe gjithsesi me peshë ne 1% popullsise. Në ketë zonë nuk ka asnjëpакice etnike përfaquesë por kemi njëshpërndarje sporadike dhe johomogjenë të tyre. Konkretilisht prezencen me të e madhe e gjeme në fushë Cidhen, përfaqsuar nga komuniteti rom me 0.7% ndekur nga komuniteti Egyptian

në qendër Tomin me 0.54% . Prezencat e tjera janë nen 0.5%, si ajo Greke dhe aromunë në zall Dardhe dhe Peshkopi.

Nr	Bashkia/Komuna	Shqipetar	Grek	Arumun	Rom	Egyptian
1	ARRAS	98.9%	-	-	-	-
2	FUSHË ÇIDHËN	97.0%	-	-	0.7%	-
3	KALA E DODËS	97.9%	-	-	-	-
4	KASTRIOT	96.8%	-	-	-	-
5	LURË	95.3%	-	-	-	-
6	LUZNI	91.0%	-	-	-	-
7	MAQELLARË	97.3%	-	-	-	-
8	MELAN	98.2%	-	-	-	-
9	MUHURR	85.8%	-	-	-	-
10	PESHKOPI	95.4%	-	0.2%	-	0.04%
11	QENDËR TOMIN	95.0%	-	-	-	0.54%
12	SELISHTË	97.1%	-	-	-	-
13	SLLOVË	97.6%	-	-	-	-
14	ZALL DARDHË	87.1%	0.4%	-	-	-
15	ZALL REÇ	97.1%	-	-	-	-

### 2.2.2.2 Përkatesia Fetare

Edhe sa i takon përkatesisë fetare , sipas censusi 2011, kjo zonë rezulton me dominace të theksuar të fesë muslimanë e cila historikisht ka qenë besimi fetar në pothuajse totalin e popullsisë. Në komunat Arras, Fushë Cidhen, Kala e Dodes, Maqellare, melan, Tomin, Sllove, dhe Zall Rec përqindja e muslimaneve është mjaft prane 100%. E gjithe popullsia muslimane është "Sunite" e traditës "Hanefi", ndërkohë qe nuk regjistrohen prezenca të sekteve të ndyshme. Fe të tjera prezente janë : Feja katolike , Ortodoksë dhe bektashi edhe pse dy të fundit me shifra fare marxinale. Kemi vetëmk njëkomunë ku rreth 8.3% të popullsisë qe është deklarur e krishtere e Besimit Katolik. Gjithashtu në komunë zall dardhe kemi rreth 1% besimtar ortodoks dhe 0.6% bektashi. Prezencat e tjera janë minimale dhe nuk mund të konsiderohen domethenese.



### 2.2.2.3 Gjuha

Zona e Dibrës historikisht është shquar si vater historike dhe kulturore e Shqipërise. Shqipja është gjuha qe flitet nga thua jse 99% e popullsisë. Pakicat linguistike ekzistojnë por në raport me totalin pesha e tyre është mjaft e limituar. Në tabelen e mëposhteme jepen të dhënrat për secilen komunë ku shihet qarte qe gjuha Shqipe flitet ne gati 100% të popullsisë ndërsa vetëm ne komunat Kastriot, Kala e Dodes dhe Zall Rec kemi popullsi të cilat flasin Greqisht apo Maqedonisht por sidoqoftë me përqindje me pak se 0.3%!

Nr	Bashkia/Komuna	Guha e Folur			Përkatesia fetare			
		Shqip	Greqisht	Maq.	Musliman	Bektashi	Katolik	Ortodoks
1	ARRAS	99.97%	-	-	96.4%	-	0.1%	-
2	FUSHË ÇIDHËN	99.24%	-	-	96.7%	-	-	-
3	KALA E DODËS	99.91%	-	0.04%	98.0%	-	-	-
4	KASTRIOT	99.95%	0.02%	-	97.2%	-	0.1%	-
5	LURË	99.91%	-	-	72.7%	-	8.3%	-
6	LUZNI	100.00%	-	-	91.7%	-	0%	-
7	MAQELLARË	99.94%	-	-	97.4%	0.038%	0.03%	0.2%
8	MELAN	99.92%	-	-	97.0%	-	0.03%	-
9	MUHURR	99.89%	-	-	85.4%	-	0.04%	-
10	PESHKOPI	99.75%	-	-	93.0%	0.023%	0.2%	0.04%
11	QENDËR TOMIN	99.95%	-	-	96.0%	-	-	-
12	SELISHTË	100.00%	-	-	90.3%	0.1%	0.1%	-
13	SLLOVË	99.92%	-	-	96.8%	-	0.0%	-
14	ZALL DARDHË	99.43%	0.29%	-	86.1%	0.6%	0.4%	1.0%
15	ZALL REÇ	100.00%	-	-	96.6%	-	0.1%	-

#### 2.2.2.4 Prezenca e aftësive të kufizuara

Kufizimet e aftësive të popullates janë njëelement i rëndësishem në të kuptuarit e cilesisë së njëpopullatë të caktuar, pasi ajo prek drejtepërdrejtë jetën e individave të shoqerise. Shpeshhere prezenca e tyre përtet normave normale lidhet me standartinë e jetës, mungesen e kujdesit shëndetësor, faktore ambiental natyror apo mundet të jenë edhe derivatë të veprimtarisë njerezore. Nga ana tjetër, evidentimi i llojit të kufizimit dhe frekuences se tyre, luan një rol vendimtar në përcaktimin e llojit, numrit dhe vendodhjes së instituteve të specializuar në trajtimin e tyre. Hulumtimi i prezences së anomalive fizike në individet e njëpopullate është i rëndësishem për te evidentuar frekuencia anormale ne mënyrë qe te analizohen faktoret potencialisht përcaktues.

Niveli mesatar i zonës i popullsisë qe me te pakten një aftësi te kufizuar është 5.6%, ndërsa shumatorja e aftësive të kufizuara prezantë në popullsinë banuese është 11.9%. Disa komuna,

ndyshe nga të tjerat, kanë përqindje me të larta së mesatrja e zonës në përgjithesi dhe për anomali të caktuara në veçanti. Njëprej komunave qe rezultojnë me frekuence me të lartë të prezences së aftësive të kufizuara në raport me popullsinë banuesë të komues është komuna Fushë Cidhen, ku krahas numrit të lartë të aftësive të kufizuar në vlerë absolute, është gjithashtu komuna ku shuma e të gjitha aftësive të kufizuara prezentë në populatë është 27.8%, si dhe popullsia me të pakten njëaftësi të kufizuar është 12.3%.

pesha e seciles paafesi në totalin									
		Përsone me të pakten njëpaftësi	Në shikim	Në degjim	Në ecje	Në kujtese	Në kujdesin	Në ndai vetes	Në komunikim
1	FUSHË ÇIDHËN	12.3%	10.4%	11.9%	32.3%	17.9%	12.9%	14.4%	
2	ARRAS	13.0%	6.2%	8.0%	16.7%	16.0%	11.3%	41.8%	
3	MUHURR	8.2%	11.8%	15.4%	30.5%	14.7%	13.2%	14.4%	
4	ZALL DARDHË	6.9%	19.3%	13.6%	23.6%	16.4%	14.3%	12.9%	
5	SELISHTË	8.8%	13.6%	12.1%	31.6%	15.5%	12.6%	14.6%	
6	ZALL REÇ	8.8%	8.6%	13.6%	32.1%	16.0%	14.8%	14.8%	
7	SLLOVË	6.5%	9.7%	11.7%	23.7%	18.7%	17.0%	19.3%	
8	MELAN	6.8%	8.6%	11.0%	28.1%	18.8%	18.1%	15.3%	
9	KASTRIOT	7.0%	11.7%	13.0%	34.0%	14.5%	11.6%	15.3%	
10	KALA E DODËS	7.3%	11.5%	9.1%	36.0%	18.6%	13.4%	11.5%	
11	LUZNI	5.8%	15.8%	15.3%	28.2%	15.8%	12.9%	12.0%	
12	QENDËR TOMIN	4.0%	10.0%	13.4%	29.7%	17.0%	14.9%	15.1%	
13	MAQELLARË	3.7%	10.6%	11.3%	28.3%	17.9%	17.0%	14.9%	
14	PESHKOPI	2.6%	12.4%	12.6%	31.4%	14.0%	14.7%	14.9%	
15	LURË	2.2%	2.5%	12.5%	25.0%	22.5%	17.5%	20.0%	
	TOTALI	5.6%	10.8%	12.1%	29.0%	16.5%	14.1%	17.4%	

Të tjera komuna që rezultojnë problematike në treguesin e prezences së aftësive të kufizuar në raport me popullsinë banuesë janë : Komuna Arras, ku rreth 13% rezulton me të pakten njëkufizim në aftësi ndërsa shuma e të gjitha kufizimeve në aftësi përbën 22.9% ; Fushë Muhur, ku shuma e të gjitha aftësive të kufizuara ze 19.7% ndërsa 8.2% e popullsisë rezultojnë me të pakten njëkufizim; Zall Dardhe, Selisht, Zall Rec, Sllove, Melan, Kala e Dodes e Kastriot kanë përqindje me te larta se mesatarja si te përsoneve me të pakten një aftësi te kufizuar ashtu edhe për shumatoren e aftësive të kufizuara. Zonat qe kanë prezencen me të ulet të aftësive të kufizuar në raport me popullsisë banuesë janë: bashkia Peshkopi (2.6%), Lurë (2.2%), Maqellare 3.7% dhe Qendër Tomin (4%). Komuna Lurë ka përqindjen me të ulet të përsoneve me të pakten njëkufizim në aftësi në krahasim me totalin e popullsisë.

Lloji I aftësisë së kufizuar qe mbizotron në të gjitha komunat është anomalia në ecje, e cila përben gati njëtë treten e anomaliave fizike prezantë në popullatë. Më pas renditën kufizimet në komunikim me 17.4% të totalit, problemet në kujtese 16.5%, në kujdesin ndaj vettvetes 14.1% dhe në fund kufizimet në degjim (12.1%) dhe në shikim(10.8%). Në vlerë absolute, komuna Kastriot rezulton me numrin me të madh të anomaliave me 913 kufizime , më pas renditën Fushë cidhen me 808 e më pas Maqellare , Arras dhe Peshkopi. Rastë të veçanta qe vlen të përmenden ketu janë: Komuna Arras ku 41.8% e anomaliave kanë të bejnë me problemet në komunikim apo komuna Zall Dardhe ku rreth 20% e kufizimeve janë në shikim.

Duhet theksuar si institutet e trajtimit të ketyre anomaliave lënë mjaft për të deshiruar. Kjo problematike behet akoma me e ndjeshme ne rastin e femijve ku rreziku i izolimit dhe mostrajtimit në formen e duhur është shumë i madh. Hapat për tu bërë në ketë drejtim janë akoma shumë dhe sfida nuk është e lehte qofte për mundësите buxhetore te pakta, lloji i kualifikimit të pësonelit, veshtiresitë infrastrukturorte, etj.

#### **2.2.2.5 Statusi civil dhe Madhësia mesatere e familjes ( 5.1 përrsona/ familje ) Statusi civil**

Zona e Dibrës shquhet për sundimin e traditës konservatore sa i takon aspekteve të lidhura me familjen. Këto janë zona ku dominon familja tradicionale patriakale dhe lidhjet farefisnore janë mjaft të forta. Fenomenet e urbanizimit si për shembul divorci apo shtyrja e moshes së martesës janë mjaft të kufizuar në të gjithe zonen. Kjo vlen si për qëndrat urbane po ashtu edhe për ato rurale.

Siaps censusi 2011, mesatarisht 60% e meshkujve rezultojnë të martuar dhe kjo përqindje është akoma edhe më e lartë tek femrat ku përgjithesisht, femrat e martuara janë mbi 60% në secilen komune. Emblematik është fakti i numrit mjaft të reduktuar të divorceve qe në rastin me të keq prek 4% (Muhur 4.3% dhe Peshkopi 4.1%) ndërsa në njëpjesen të madhe të komuneve nuk arrin kuotën e 2%. Në rast së nga njera anë ky fenomen tregon lidhjet e forta dhe peshën e traditës apo opinionit publik, nga ana tjetër mundet të fshehe veshtiresi në gjendjen e gruas brenda familjes dhe emancipimit të saj në përgjithesi

**Madhësia mesatare e familjeve** është 5.1 përrsona për familje. Kjo është nga me të lartat në vend dhe vjen nga niveli i lartë i lindjeve qe vijon të mbetet nga me të lartit në vend, 14 lindje për cdo 1000 banorë. Vihet re së zonat rurale kanë madhësi mesatare me të lartë së zonat urbane si dhe madhësia e familjes lidhet në përpjestim të drejtë me nivelin e jetësës dhe verferine. Madhësinë mesatare me të madhe e gjejme në komunen Kala e Dodes me mesatarisht 6.3 pjestare për familje, ndërsa numrin me të vogel e ka qyteti i Peshkopisë me 4.4 pjestar.

Nr		Madhësia mesatare e familjes	Të martuar - Meshkuj	Të martuar - Femra	Familje me njëpjestar	Familje me shumë se 6 përsona	Kryfamiljare Femer	Cift pa fëmijë	Cift me fëmijë	Kryefamiljar në pension
1	ARRAS	5.1	57.6	60.0	2.5%	39.6%	5.8%	9.8%	70.8%	6.0%
2	FUSHË ÇIDHËN	4.8	56.7	59.7	4.3%	34.7%	6.9%	7.6%	68.9%	6.0%
3	KALA E DODËS	6.3	61.4	62.1	0.0%	57.1%	5.0%	4.8%	63.9%	0.1%
4	KASTRIOT	5.0	59.6	65.1	2.6%	36.9%	9.9%	9.6%	63.3%	3.9%
5	LURË	4.8	52.2	53.3	5.3%	38.5%	11.5%	11.9%	67.7%	7.1%
6	LUZNI	5.0	59.8	62.7	3.5%	41.7%	9.8%	8.5%	69.1%	4.1%
7	MAQELLARË	4.9	64.3	69.5	1.5%	33.0%	8.0%	9.0%	65.0%	2.8%
8	MELAN	5.0	61.8	68.2	1.5%	35.5%	7.6%	7.6%	64.3%	4.2%
9	MUHURR	4.9	59.3	67.1	1.4%	34.3%	5.3%	9.6%	65.0%	5.3%
10	PESHKOPI	4.4	65.3	66.8	2.1%	20.3%	8.1%	8.8%	71.1%	3.6%
11	QENDËR TOMIN	5.1	62.7	65.9	1.3%	39.2%	11.1%	7.5%	61.7%	3.6%
12	SELISHTË	5.3	59.0	62.6	2.3%	45.9%	6.9%	6.6%	68.2%	2.0%
13	SLLOVË	5.2	58.6	64.7	0.9%	40.5%	3.5%	9.8%	68.8%	3.3%
14	ZALL DARDHË	4.9	57.9	59.1	12.2%	44.1%	6.6%	7.0%	56.3%	0.9%
15	ZALL REÇ	5.4	51.8	60.6	3.1%	48.0%	3.9%	8.7%	70.9%	2.4%

### Llojet e bërthamave familjare

Familjet me njëpjestar kanë frekuence të ulet dhe përbejnë përashtim në realitetin e zonës. Veten në zall Dardhe regjistrohet presence domethenesë e kesaj kategorie me 12.2%.

**Familje me shumë së gjashtë përsona:** përbejnë tipologjinë dominuesë në pjesen me te madhe të komunave. Në disa rastë të veçanta regjistrohen përqindje mjaft të larta, sic është rasti i komunave Kala e Dodes me 57.1%, Zall rec 48%, etj. Është qyeti i Peshkopisë ku kjo tipologji ka frekuencen me të ulet me rrëth 20% .

**Kryefamiljar femer:** është njëforme jo e zakoneshme në këto zona me përqindje qe luhaten nga njëminimum prej 3.5% në komunen Sllove njënjëmaksimum prej 11.5% në lurë.

**Kryefamiljar pensionist:** Familjet ku kryefamiljari është pensionist përbejnë njëpjesë të vogel totalit të familjeve. Prezenca e tyre është më e lartë në komunat Lurë(7.1%), Arras(6%) dhe Fushë

Cidhen(6%), ndërsa ka vlerat me të uleta në komunat Kala e Dodes (0.1%), Zall Dardhe(0.9%) dhe Selishte(2%).

**Cift me fëmijë :** Nen ndikimin e vlerave të forta konservatore , familja tipike patriakale vijon të jetë forma dominuesë e organizimit familjar, me shifra qe në varesi të komuave kanë vlera nga 60-70%. Këto zona kanë numer të lartë të martesave si dhe moshe mesatare martesore me të ulet së mesatarje e Shqipërise, sidomos tek femrat.

**Cift pa fëmijë:** frekuence e ulet në përgjithesi në të gjitha komunat, zakonisht nen 10%. Mospasja e femive vjen vetëm si pamendesi fiziologjike sesa si zgjedhje ekonomiko-sociale apo mënyrë jetëse.

### 2.2.3 STATISTIKAT JURIDIKE

#### 2.2.3.1 Veprat Penale

Gjatë vitit 2014 në qarkun e Dibrës janë regjistruar 862 vepra penale gjithsej ku peshën me të madhe, ashtu sikursë në të gjithe qarqet e Shqipërise, e zenë aktet kundër rendit dhe standardeve te sjelljes me reth 76% të totalit. Ne vend të dytë për nga frekuanca vije krimet ne fushën ekonomike dhe finaciare me 7.4% ndjekur nga krimet në fushën e korruptionit me 6.4%, ato në fushën e droges 4.5% si dhe kundër pësonit 3.4% . Kategoritë e tjera kane peshë specifike relativisht të ulet.


Grup-vepra penale	Shqipëria	Qarku	% mbi totalin e veprave te qarkut	% mbi totalin e kategorisë për Shqipëri
Kundër pësonit	485	30	3.5%	6.19%
Kundër Prones	115	1	0.1%	0.87%
Trafiqë të paligjshme	653	5	0.6%	0.77%
Në fushën e droges	1,533	39	4.5%	2.54%
Ekonomike dhe finaciare	2,107	64	7.4%	3.04%
Korruption	1,121	58	6.7%	5.17%
pastrimi i parase	392	11	1.3%	2.81%
Aktë kundër rendit dhe standardeve të sjelljes	18,130	654	75.9%	3.61%
<b>TOTALI</b>	<b>24,536</b>	<b>862</b>	<b>100.0%</b>	<b>3.51%</b>

Ndërsa krimet në rrithin e Dibrës përbjegjne 3.51% të totalit nga 4.8% qe është përqindja qe ze popullsia e Dibren në raport me Shqipërinë. Në nivel qarku, Dibra ka numrin me të ulet të veprave penale për cdo 1000 banorë . Ajo regjistron 6.2 vepra penale për 1.000 banorë nga 8.5 qe është mesatarja kombëtare. Numrin me të lartë në terma relative e ka qarku i Gjirokastres me 13.8%. Ne raport me qarqet e tjera të shqipërisë dhe me mesataren kombëtare, Dibra ka përqindje me të uleta për krimet kundër prones, trafiqet e paligjeshme dhe atyre në fushën e droges. Ndërsa pozicionohet me lart sa I takon krimeve kundër pësonit dhe Korrupsionit. Për pjesen tjeter të grupveprave është në linjëme mesataren kombëtare.


Në vitin 2014 , në qarkun e Dibrës kemi rrith 7.6 raportime për 10.000 banorë. Nga 349 raportime të dhunës në familje gjithsej gjatë 2010-2014, vetëm 4.6% janë raportuar gjatë vitit 2010, 13.2% gjatë vitit 2011, 36.4 % e tyre janë raportuar në vitin 2012, 16.3% ne 2013 dhe 29.5% gjatë vitit 2014. Sic shihet qartë tendanca e raportimeve është në rritje pasi raportimet për vitin 2014 janë rrith 6 here me shumë së ato të vitit 2010. Sidoqoftë ky mbetet njëproblem shqetesues akoma I patrajtuar mirë në kompleksitetin e tij dhe duhen marre masa për parandalimin si dhe trajtimin me ndihme të kualifikuar për pësonat të cilet e kanë vuajtur.

### **2.2.3.2 Të burgosurit**

**Numri i të burgosurve:** Në vitin 2010, në qarkunë dibrës kishim 251 të burgosur prej të cilëve, 248 ishin mbi 15 vjec ndërsa vetëm 3 prej tyre ishin nen 18 vjec. Numri i të burgosurve në vitin 2014 ishte 296 ku 293 ishin mbi 18 vjec dhe përsëri 3 pësona ishin nen 18 vjec. Pra, në vetëm kater vjet numri i të burgosurve është rritur me rrith 18% duke regjistruar njëmesatare prej me shumë se 4% në vit.



**Të burgosur për 10.000 banorë:** Kjo normë jep një informacion më të qartë për peshën që zë popullsia e burgosur në totalin e popullsisë së çdo qarku, shprehur për 10 mijë banorë në vitin 2014. Në këtë vit në Shqipëri regjistrohen 18,8 të burgosur për 10 mijë banorë. Nga figura shohim që qarku i Kukësit është qarku me normën më të lartë prej 34,4 të burgosur, vlerë kjo e cila është relativisht e lartë në krahasim me normën mesatare në rang vendi. Është qarku i Tiranës ai me normën më të ulët respektivisht me 10.8 të burgosur për 10 mijë banorë.



Norma ndryshimit në numrin e të burgosurve në vitin 2010 dhe 2014 ka trend në rritje përvitet në fjalë për secilin qark. Në Shqipëri norma e ndryshimit midis vitit 2010 dhe 2014 është 18.5 %, që do të thotë së në vitin 2014 kemi 18.5 % më shumë të burgosur sesa në vitin 2010, ose shprehur në terma absolut në 2014 kemi 850 të burgosur më shumë së në vitin 2010.

Në qarkun e Dibrës numri i të burgosurve për përiudhen 2010-2014 është rritur me 17.9%. Kjo norme është vetëm pak më e ulet sesa mesatrja e Shqipërisë prej 18.5%.

#### 2.2.4 SHËNDETËSIA

Për shumë vite, numri i shtretërve në spitale në Shqipëri ka rënë. Gjatë viteve të fundit numri i shtretërve në dispozicion në shkallë vendi ka rene, kjo situatë u reflektua edhe në qarkun e Dibrës ku nga 27 shtreter për 10.000 banorë që kishim ne 2009 u reduktuan ne 25 në vitin 2013. Në vitin 2013, dendësia më e lartë e shtretërve spitalorë në dispozicion në spitale është regjistruar në prefekturën e Gjirokastrës , 51 shtretër për 10 000 banorë ndjekur nga Kukësi me 43 shtretër për 10 000 banorë, e më pas ndjekur nga Dibra, Vlora, Tirana.

Në rast së konsiderojme numrin e shtreterve për 10.000 banorë, qarku I Dibrës ka patur regres në ketë drejtim. Konkretisht, numri i shtreterve është reduktuar nga 542 qe kishim ne 2009 ne 512 shtreter ne 2013. Mesatarisht kemi 25 shtreter për cdo 10.000 banorë qe rezulton të jetë më e ulet së mesatarja në shkallë vendi prej 29 shtreter/10.000 banorë.




#### 2.2.4.1 Shërbimi shendetësore

**Numri i poliklinikave :** Numri poliklinika ve ka mbetur i pandyshuar gjatë viteve të fundit. Vijojnë te mbeten 3 poliklinika ashtu si ne shumicen e qarkeve te Shqipërise. Krahasuar me nivein mesatar në shkallë vendi, për vitin 2013 kemi njëpoliklinike për cdo 46.130 banorë ndërkohe qe mesatarja e vendit është 1 poliklinike për 62.986 banorë. Sidoqoftë ketu duhet marre parasysh jo vetm numri i banorëve por edhe shpërndarja e popullsisë sipas zonave. Aksesi i zonave malore në shërbimet shëndetësore mbetet problematik.

**Numri i Qëndrave shëndetësore:** Gjatë viteve 2009-2013 numri i qëndrave shëndetësore është reduktuar duke zbritur nga 39 qëndra në vitin 2009 ne 34 qëndra shendetësore në vitin 2013. Krahasuar me mesataren kombetare prej 7085 banorëve për qendër shëndetësore , kjo zonë pozicionohet me lartë pasi rezulton me 4070 banorë për qendër shëndetësore. Por në rast së marrim në konsideratë numrin e fshatrave dhe largesinë e tyre me qëndrat urbane njëpjesë e madhe e popullsisë së zonave malore e ka mjaft të veshtire aksesin në qëndrat shëndetësore.

**Numri i ambulancave:** Numri i ambulancave ka ardhur në rritje edhe pse modeste, duke kaluar nga 158 në vitin 2009 ne 163 të vitit 2013. Mesatarisht kemi njëambulance për 850 banorë ndërkohe qe mesatrja e vendit është 1450 banorë/ambulance.

**Numri i konsulitorit të fëmijëve dhe i gruas :** Situata rezulton e pandryshuar gjatë të njëjtës përiudhe me 187 qëndra ne 2013 nga 188 që ishin ne 2009. Krahasuar me mesataren e vendit kemi njëkonsultor për cdo 740 banorë nga 1380 që është mesatarja kombëtare.



Qarku Dibër	Qëndra shëndetësore	Ambulanca	Konsultori i fëmijëve	Konsultori i gruas
Viti 2009	39	158	188	188
Viti 2010	40	133	163	163
Viti 2011	40	133	163	163
Viti 2012	34	164	163	163
Viti 2013	34	163	187	187
<b>Shqipëria</b>	<b>409</b>	<b>1998</b>	<b>2100</b>	<b>2099</b>

## 2.2.5 ARSIMI

Si rezultat i trashigminisë së përiudhes komuniste (1945-1990) analfabetizmi nuk përbën problem shqetesues. Situata e analfabetizimit paraqitet e kenaqeshme në bashkinë e Peshkopise (1.6%), Lurë ( 1.6%) dhe Maqellare(2.1%) ndërsa normen me të lartë e kanë komunat Zall Rec(5.2%), Luzni(5.2%), Fushë Cidhen(4.4%), Arras(4.5%). Pjesa tjetër e komunave kanë vlera të përfshira në intervalin 2.5%-3.5% .

Mesatarisht popullsia e zonës ka rreth 9 vitë shkollimit. Në qytetin e Peshkopisë vitet mesatar të shkollimit janë 11.2 ndërsa në komunen Kala e Dodes 8.4 vite. Sidoqoftë, në secile nga komunat vitet mesatare të shkollimit nuk zbresin poshtë nivelit te 8 viteve dhe në pjesen me të madhe i tejkalojne 9 vitetë e shkollimit.

Ndjekja e Arsimit fillor baze është relativisht e kenaqeshme me shifra qe varijojnë nga 70%-80% të popullsisë. Me problematike është ndjekja e arsimit të mesem sidomos në ato komuna malore qe paraqesin veshtiresi komunikimi. Si gjithome gjejme ketu komunat , Kala e Dodes, Luzni, Selishte, Zall Rec etj. Ndjekesit e arsimit të mesem janë në relativisht në nivele të mira në qëndrat urbane (peshkopi) dhe ne komunat ne afërsi te tyre ndërsa ka deficencia ne disa komuna si për shembull:Kala e Dodes, Luzni, Selishtë apo edhe Zall Rec.

Nr	Bashkia/Komuna	% e analfabetizmit	Fillore	E mesme	E lartë dhe me tej	Mesatarja e Viteteve të shkollimit
1	ARRAS	4.5%	72.3%	18.3%	3.3%	9.0
2	FUSHË ÇIDHËN	4.4%	72.6%	19.4%	2.5%	9.1
3	KALA E DODËS	2.6%	85.3%	7.6%	1.2%	8.4
4	KASTRIOT	3.3%	70.3%	22.0%	3.1%	9.2
5	LURË	1.6%	71.7%	22.7%	2.9%	9.5
6	LUZNI	5.2%	80.1%	11.3%	1.6%	8.6
7	MAQELLARË	2.1%	77.3%	17.0%	2.8%	9.1
8	MELAN	3.7%	75.4%	16.9%	2.2%	8.7
9	MUHURR	3.0%	69.2%	22.1%	4.2%	9.3
10	PESHKOPI	1.6%	45.7%	38.7%	12.9%	11.2
11	QENDËR TOMIN	2.7%	72.4%	20.5%	3.0%	9.3
12	SELISHTË	3.4%	83.6%	10.7%	1.6%	8.8
13	SLLOVË	3.2%	70.5%	22.4%	2.7%	9.3
14	ZALL DARDHË	3.1%	68.3%	22.8%	3.8%	9.3
15	ZALL REÇ	5.2%	78.7%	13.6%	1.3%	8.6

Situata arsimore ne fakt paraqitet problematike ne rast se konsiderojme arsimin e larte (universitar dhe pas universitar). Me përashtim të bashkisë së peshkopise, ku të regjistruarit në arsimin e lartë janë 11.3%, pjesa tjeter e komunave rezultojme me përqindje mjaft minimale me njëmesatare rreth 4.3%. Disa komuna malore si për shembull Kala e Dodes, Zall Rec, Zall Dardhe, Selishte, Luzni arsimi universitar rezulton nen kuoten 1.5%. Ky fakt ka ndikim të

menjëhershem në punësimin aktual por qe do të ndikoje negativisht edhe në njëoptike afatmesem dhe afatgjatë në punësimin e forces së punës.

#### 2.2.5.1 Indikatore të tjere arsimor

**Arsimi 9 vjeçar:** Gjatë përiudhes 2009/10 indikatoret e arsimit 9 vjecare tregojnë për njërenjtë lehtë e cila rezulton mesë e natyrshme po të kemi parasysh renjen e lindshmerisë gjatë viteve të fundit. Konkretisht, numri i shkollave 9-vjecare ka mbetur i njejtë në përiudhen 2009/10-2013/14 ndërsa numri i mësuesve, numri i nxënësve të regjistruar si dhe numri i nxënësve të diplomuar ka pësuar renje. Numri i mësuesve është reduktuar me rreth 14% ndërsa numri i nxënësve te regjistruar dhe i atyre të diplomuar me rreth 20%.

Mesatrja nxënës për mësues në arsimin 9 vjeçar në vitin 2013/14 është 14 nxënës për mësues nga 15 qe ishtë në vitin shkollor 2009/10.

Pjesa më e madhe e shkollave 9 vjecare , rreth 90% e tyre, ndodhen në zonat rurale. Konkretisht, në vitin 2013/14, nga 97 shkolla të arsimit 9-vjeçar, 86 ishin në zonat rurale dhe vetëm 11 ishin në zonat urbane. Edhe numri i të regjistruarve dhe të diplomuarve në zonat rurale është mjaft më i lartë së në zonat urbane.

Indikatore arsimore	viti 2009/10	viti 2013/14	ndryshimi	Ndyshimi
			në numër	
Shkolla 9 vjecare	97	97	0	0%
Mësues në shkollat 9 vjecare	1,750	1,510	-240	-14%
Nxënës të regjistruar në arsimin 9 vjeçar	26,830	21,200	-5,630	-21%
Nxënës të diplomuar në arsimin 9 vjeçar	3,161	2,528	-633	-20%
<b>Nxënës për 1 mësues në arsimin 9 vjeçar</b>	<b>15.3</b>	<b>14.0</b>	<b>-1.3</b>	<b>-8%</b>
Shkolla të mesme	23	25	2	9%
Mësues në shkollat e mesme	329	345	16	5%
Nxënës të regjistruar në arsimin e mesem	6,270	6,925	655	10%
<b>Nxënës për 1 mësues në arsimin e mesem</b>	<b>19.1</b>	<b>20.1</b>	<b>1</b>	<b>5%</b>
Nxënës të regjistruar në gjimnaz	5,967	6,459	492	8%
Nxënës të diplomuar në arsimin e mesem	1,762	1,844	82	5%
Nxënës të diplomuar në gjimnaz	1,474	1,716	242	16%

**Indikatoret e arsimit të mesem** në përgjithesi kanë ndyshuar pozitivisht. Gjatë të njetës përiudhe është rritur numri i shkollave të mesme nga 23 ne 25 dhe është rritur gjithashtë numri i mësuesve (nga 329 ne 345), numri i nxënësve të regjistruar (nga 6270 ne 6925) si dhe numri i nxënësve të diplomuar (nga 1762 ne 1844).

**Raporti nxënës pér mësues** është rritur por jo në mënyrë domethenese (nga 19 ne 20 nxënës pér mësues). Në arsimin e mesem mbizoterojnë të regjistruarit në gjimnaze pér të gjitha vitet me rreth 95% të të regjistruarve. Njënga arsyet kryesore është prezanca minimale e arsimit professional. Në fakt kjo rezulton të jetë njënga pikat thelbesore në analizen e zhvillimit afatgjatë të zonës pasi përqindja e atyre qe ndjekin studimet e larta është minimale ( me pak se 4% ) dhe shkollimi professional është i domosdoshem dhe faktor kyç në kualifikimin e forces së punës.

Sa i takon aspektit gjinor, si në pjesmarrjen në shkolle ashtu edhe në mesidhenje, të dy gjinitë ndjekin të njetin trend dhe nuk rezultojnë disbalanca gjinore. Numri i meshkujve është lehtesishët më i lartë por sidoqoftë në linjëme raportin gjonor të zonës. Vlen pér tu permendur qe në ketë zonë mungojnë plotesisht institucionet e arsimit privat.

Arsimi 9-vjecar	viti			viti		
	Gjithsej	Qytet	Fshat	Gjithsej	Qytet	Fshat
Shkola 9 vjecare	97	13	84	97	11	86
Mësues në shkollat 9 vjecare	1,750	410	1,340	1,510	341	1,169
	Gjithsej	Femra	Meshkuj	Gjithsej	Femra	Meshkuj
Nxënës të regjistruar në arsimin 9 vjecar	26,830	12,908	13,922	21,200	9,897	11,303
Nxënës të diplomuar në arsimin 9 vjecar	3,161	1,490	1,671	2,528	1,206	1,322
Nxënës pér mësues në arsimin 9 vjecar	15.3			14.0		

Arsimi i mesem	Gjithsei	e	shkoll	Gjithsei	e	shkoll
		mesmë	a		mesmë	a
Shkola të mesme	23	22	1	25	24	1
	Gjithsej	Femra	Meshkuj	Gjithsej	Femra	Meshkuj
Mësues në shkollat e mesme	329	169	160	345	184	161
Nxënës të regjistruar në arsimin e mesem	6,270	3,276	2,994	6,925	3,436	3,489
Nxënës pér mësues në arsimin e mesem	19.1			20.1		
Nxënës të regjistruar në gjimnaz	5,967	2,776	3,191	6,459	3,201	3,258
Nxënës të diplomuar në arsimin e mesem	1,762	968	794	1,844	987	857
Nxënës të diplomuar në gjimnaz	1,474	753	721	1,716	907	809

## 2.2.6 Turizmi

Menjehere pas Bujqesise, turizmi është sektori i dytë prioritar dhe me shumë mundësi pér zhvillimin e zonës së Dibrës. Dibra ka potencialet e larta turistike të pashfrytëzuar sic duhet. Mundet te permendim ketu, burimet e shumta natyrore, vlerat e mëdha kulturore dhe historike, kulinaria tradicionale e pasur, janë potenciale pér turizmin. Potencialet më të larta janë pér zhvillimin e turizmit kurativ, malor, historik dhe kulturor.

### Turizmi kurativ:

Në luginën e përroit të Llixhave është burimi i famshëm termal i Llixhave. Në këtë territor ndodhet dhe kompleksi balnear i Llixhave që është pronë e bashkisë Peshkopi, dhe ku afrohen të gjitha shërbimet e nevojshme duke filluar nga pishina, vaska, masazhi, balta dhe shërbimi mjekësor. Cilësia e ujit të Llixhave të Peshkopisë është nga më të mirat në Europë. Numri më i madh i pushuesve janë të moshës nga 45-70 vjec dhe janë më shumë pushues që vijnë nga pjesa e Shqipërisë Veriore, Tiranë, Durrësi, Kosova, dhe Maqedonia. Ky turizm është sezonal dhe frekuentohet kryesisht në vjeshtë (Shator-Nëntor) dhe në periudhën e pranverës në sezonin (Mars-Qershori). Akomodimi dhe shërbimi turistik, është në gjendje të kënaqshme dhe ofrohet nga një numër i konsiderueshëm hotelesh dhe shtëpi pritëse. Në këto ambjene shërbimi ofrohet i plotë ditor (duke përfshirë fjetje, ushqim, dhe terapinë e ujit të ngrohtë). Kostoja e shërbimit nuk është e lartë, që i përgjigjet mundësive të klientelës.

Potenciali turistik kurativ në zonën e Dibrës ka mundësi të zhvillohet edhe më shumë duke rritur numrin e vizitorëve nëpërmjet shtimit të sezonit të pushimit edhe gjatë muajve të verës si dhe gjatë muajit të dimrit për një numër më të vogël, por më elitarë. Në kompleksin balnearë të Llixhave ka mundësi të krijohen ambjente më cilësore për vizitorët, duke investuar në krijimin e një pishine dhe në ambjente të tjera shërbime për fizioterapi, kurim, dhe ambjente sociale, duke u bazuar dhe në eksperiencën e qendrave balneare të Dibrës së Madhe (Kosovrast dhe Banisht).

### Turizmi malor dhe rural:

Lugina e Dibrës rrrethohet nga dy anët nga vargmalit "Deshat-Korab" që është dhe mali më i lartë në Shqipëri, dhe vargmalet e "Lurë-Selishtë" ku janë dhe 21 liqenet akullnajore. Peizazhi piktoresk i zonës së Dibrës pëershkohet në të gjithë gjatësinë e tij nga Lumi Drin i Zi, lumi më i gjatë në Shqipëri, dhe njihet edhe si lugina e Drinit. I gjithë territori dallohet për monumente te shumta natyre qofshin këto gjeo-monumente, hidro-monumente apo bio-monumente, të cilat dallohen për vlerat e tyre të veçanta historike, estetike, turistike, biologjike. Jane një numër i madh objektesh dhe pejzashesh si monumente natyre, që janë pjesë e parkut natyror Korab-Korritnik dhe parkut kombëtar të Lurës. Në këtë territor ka një florë dhe faunë shumë të pasur ku gjinden më shumë se 138 lloje të rralla bimësh (bima e rralë autoktone tulipani i Korabit) dhe kafshë të rralla si Tigri i Ballkanit, Dhia e Egër, gjeli i egër dhe shumë shpendë të tjera të egër më e famshmia është shqiponja e Korabit. Krahasimisht me rajonët fqinje turizmi malorë dhe ruralë në Dibër është më pak e zhvilluar. Një ndikim negativ në mos-zhvillimin e turizmit ka luajtur dhe infrastruktura e dobët rrugore me Tiranën. Vizitorët e paktë që vizitojnë janë turistët e huaj që vijnë kryesisht nga Evropa Perëndimore dhe Qendrore si dhe Amerika e Veriut për periudha të shkurta prej 1-5 ditë. Një numër i konsiderueshëm i vizitorëve, sidomos ata një-ditorë, vijnë nga Tiranë dhe Durrësi. Bisneset vendase janë në fillesat e para investimet në ngritjen shtëpive pritëse për turistët dhe disa hotele të vogla. Vetëm në Lurë janë 2 hotele të rregulluara, ndërsa në komunat e tjera janë thjesht disa shtëpi pritëse, të cilat në të shumtën e rasteve janë të iniciuara nga agjensia lokale

turistike KTT (Korabi Tracking Tour) që punon me agjensi turistike të huaja, kryesisht me turistë adhurues të zonës malore, studiues të florës dhe faunës, dhe turizmit të aventurës.

Promociioni për turizmin është në hapat e para, ku më seriozi është guida turistike, strategja për vargamlin e Deshatit, dhe grupi i veprimit lokal "Dibra Turistike" që po promovojnë zhvillimin e turizmit malor dhe rural në Dibër. Faqja e internetit dhe shumë faqe sociale janë hapur nga organizata, institucionet dhe individë që promovojnë vazhdimesh bukuritë dhe resurset e Dibrës.

Turizmi malor dhe rural në Dibër ka shumë potenciale për t'u zhvilluar dhe te kthehet ne një burim te ardhurash per zonen sidomos pos fshtarat ne zonat malore te pasura me pasuri natyrore. Janë disa fshatra malore që mund të kthehen në fshatra me profil turistik si në Maqellarë, Melan, Tomin, Kastriot, Sllovë, Kala e Dodës, Lurë, Reç, Dardhë, Arras, Muhurr dhe Selishtë. Ne keto fshatra ekziston një kapacitet i konsiderueshem shtëpishe pritëse i pashfrytezuar. Stimulimi per hapjen e shtëpive pritëse me siguri do te ndikoje ne zhvillimin e turizmit malor.

**Agro Turizmi gjithashtu eshte akoma i paeksploruar por qe ka potenciale te medha zhvillimi. Kulinaria dhe produktet tipike te kuzhines dibrane, me nderhyrjet e nevojshme ne strukturat priteze dhe ne promovimin e tyre mundet te kthehen ne atraksion turistik brenda nje kohe te shkurter dhe me potenciale ekonomike te konsiderueshme.**

#### **Turizmi Historik dhe kulturor:**

Dibra është një trevë shumë e njohur dhe e pasur për historinë dhe kulturën. Doket, zakonet, kostumografia, lojrat populllore dhe ritet festive pagane dhe religjoze janë një thesar për zhvillimin e Turizmit Kulturor. Oda Dibrane , kanuni i Dibrës që njihet si kanuni i Skënderbeut, kullat dhe shtëpitë e gurit, dasma dibrane, kostumet populllore janë disa nga elementët atraktivë për Turizmin Kulturor. Në zonën e Dibrës janë disa rrënoja arkiologjike që duhet të studiohen si të periudhës Ilire të fiseve te Deborëve dhe Penestëve, të periudhës se bizantit me shumë rrënoja kishash dhe manastiresh, dhe të periudhës së mesjetës otome me xhami, teqe dhe oxhaqe. Dibra është kufiri ndarës i katolicizmit dhe ortodoksisë, si dhe shumë rrënojave arkiologjike pak të zbuluara ku me e madhja është kalaja e Grezhdanit, e cila vetëm një pjesë është e zbuluar nga gërmimet arkiologjike.

Analizë e sektorit te turizmit mund ta permblehdhim shkutimisht si me poshte:

#### **Anët e Forta**

- PBurimet e shumta Natyrore, Ujërat termale të Llixhave; Korabi (Mali më i lartë në Shqipëri)  
Vargmali i Lurës me 23 liqene akullnajore;24 monumentet e natyrës;
- Vlerat e pasura historike, Vendlindja e Skëndërbeut;
- Zbulimet arkeologjike ne kalanë e Grezhdanit, Kishat e Peshkopisë, Kalaja e Cetushit,  
zbulimet arkeologjike në Cidhën, Muzeu i Peshkopisë dhe i Sinës;
- Tradita e pasur me doket dhe zakonet e lashta, Oda Dibrane (folk festival dhe tarditë),

Kanuni i 9-të Maleve, (Skënderbeut), Vallet dhe këngët popullore,

- Kulinaria dibrane, guzhina e pasur

#### Dobësitë

- Infrastruktura rrugore dhe turistike e dobët dhe e largët me qendrat metropolitan;
- Cilësi e dobët e shërbimeve turistike, Mungesa e shërbimeve turistike, Mungesa e operatorëve turistike;
- Kapacitete të ulëta njerëzore për shërbime turistike;
- Mungesa e Investimeve në sektorin e turizmit;
- Dëmtimi i burimeve natyrore, mos-kujdesi për zonat e mbrojtura dhe monumentet e natyrës; Dëmtimi i monumenteve të kulturës, mos-kujdesi për zonat e historike dhe monumentet e cultures;
- Mungesa e promocionit turistik të zonës

#### Mundësitë

- Turizmi si prioritet i politikave qeveritare;
- Prania e donatorëve me fokus të punës sektorin e turizmit;
- Përvoja e suksesshme rajonale (Alpet e Shqipërisë, Korca, Maqedoni, Kosovë), Orientimi i tregut për turizmin

#### Kërcënimet

- Konkurenca rajonale dhe e territoreve fqinje që kanë infrastrukturë më të mire;
- Politika të gabuara dhe spontane të pa-bazuara në zgjidhjen e problemeve reale të turizmit (hapa të mëdha pa kaluar në hapa të vegjël);
- Pronësia e paqartë për pyjet, natyrën, dhe monumentet e natyrës

#### 2.2.7 Sinteza e relacionit te trashegimise kulturore

Bashkia e Dibrës shtrihet në pjesën Veri-Lindore të Shqiperise dhe ka një terren kryesisht malor. Rajoni i Dibres shtrihet ne lindje te Shqiperise ne një terren te thyer per gjithësisht malor por i kombinuar ne te ashtuquajturen zone e ulet qe fillon nga lumi Drin i Zi dhe sa vjen e lartesohet ne pllaja kodra dhe male te thepisura deri ne kufi me Republiken e Jugosllave te Maqedonise. Simboli i lartë historik i Dibrës lidhet dhe me vendlindjen e heroit kombëtar Gjergj Kastriotit dhe 24 betejat e tij u zhvilluan në Dibër. Në territorin e Dibrës ndodhen rrënoja arkeologjike që shume pak janë të eksploruara, të cilat lidhen me qytetërimin Ilir, Bizantin, Kristian dhe Mesjetar.

Pasuritë natyrore janë potenciale shumë të mëdha për ketë qytet. Duke qënë se Dibra dallohet për një larmishëmri në aspektin morfologjik dhe morfogenetik, ajo zotëron një trashëgimi shumë të pasur natyrore. Ku ndër to mund të përmendim: Liqeni i Zi (Lurë), Liqeni i Luleve, Burimi termomineral i Llixhave të Peshkopisë, Morenat e Fushëlurës, Hartinat e Lurës, Fusha e Pelave, Gryka e Setës, Cirku i Kurorës së Lurës, Liqeni i Madh (Lurë), Shpella e akullit, Vakufi i Sinës së Epërme, Gryka e Madhe e Lurës, Shpella e Rusit, Rrapi i Cidhnës, Burimi dhe shpella e Sopanikës,

**Kodra e Parave-Bllicë, Shpella e Qytezës, Pasqyra e Gramës, Karsti i Malit të Bardhë, Kroj i Mbretit-Serakol, Liqeni i Zi ( mbi Radomirë), Gropa e Panairit, Rrafshi i Korabit, Bjeshka e Zonjave Zimur, Boroviku i Begiuneçit, Krasta e Poçestit, Ujëvara e Poçestës, Guri i Kërcinit, Shpella e Gurit të Kuq.**

Sic u përmend më siper në zonën e Bashkisë së Dibrës kemi gjetje të shumta arkeologjike të cilat dëshmojnë për një territor të pasur me histori. Duke u bazuar tek gjetjet e përfaqësimeve kulturore mund të themi se këto gjetje datojnë në periudhat e pre dhe protohistorike, duke filluar nga neoliti i hershëm kur shfaqen qytetërimet e para të vërteta neolitike, deri në fundin e priudhës arkaikë, kur shenohen fillimit e lindjes së qyteterimit llir. Nga gjetjet arkeologjike të cilat janë shpallur monumente të kategorisë së Parë mund të përmendim: **Gradishten e Peshkopisë, Gradishten e Belloves, Qytetin e Skënderbeut.**

Fortifikimet ne qytetin e Dibrës zënë një vend të rëndësishëm në trashëgiminë kulturore dhe arkitektonike të vendit. Ndër keto fortifikime, një pjesë e tyre janë shpallur monumente të të kategorisë se Parë. Ndër to mund të përmendim: **Kalanë e Dodes, Kalanë e Grezhdanit, Kalanë e Lashkizës (Zonë e Mbrojtur).** Ndërsa fortifikimet e tjera që nuk janë shpallur monumente, mbartin vlera të mëdha historike dhe arkitekturore gjithashtu.

Pjesë e rëndësishme kulturore e qytetit të Dibrës janë dhe objektet e kultit. Gjetja e kishave ose bazilikavë të periudhës romake dhe bizantine janë dëshmi e kësaj trashëgimie e cila bën që Dibra të njihet ndryshe dhe si kufiri midis Ortodoksisë dhe Katolicizmit. Shfaqjet e para të xhamiave nisën si rezultat i pushtimit nga Perandoria Osmane. Një pjesë e objekteve të kultit janë shpallur monumente të kategorisë se Parë: **Kisha e Cveti Spass, Kisha e Shen Dhimitrit, Kisha e Shpërfytyrimit, Xhamia e Allajbegisë.**

Kullat e veçuara kanë shërbyer si pika vrojtimi për kontrollin e rrugëve apo të kufijve, për shkëmbime sinjalesh ose për aktivitete të ndyshme. Bashkimi i kullave dhe i banesave te ndryshme me kanik, bënин të mundur që këto kulla të krijonin tipin e një banese të fortifikuar. Një pjesë e banesave tradicionale janë shpallur monumente të kategorisë se Parë: **Banesa e Lazim e Munir Karajt, Banesa e Mustafa Shires, Banesa e Selman Tolles, Banesa e Tashko Markos, Banesa e Vehap Isakut e Ramadan Hyses, Dhoma e Dom Nikoll Kacorrit, Ish Mulliri i Tolles, Banesa e Mudë Sali Kadriut, Banesa e Reshit Zunës, Kulla e Zef Doçit.** Monumente të kategorisë së dytë janë: **Kulla e Dine Hoxhes.**

Ne perendim te qendrës së qytetit ndodhet zona që më parë funksiononte si zone industriale per te gjitha llojet e ndermarrjeve, por qe per shkak te kushteve ekonomike aktualisht është lënë jashtë funksionit. Zona industriale përfshinte: **Uzinen Mekanike, SMT-ën, Ndërmarrjen e Grumbullimit, Ndërmarrjen Tregtare, Ndërmarrjen Bujqesore, Ndërmarrjen e Punimeve të ndryshme, Ndërmarrjen Ushqimore, Parkun e Automjeteve, Minierën e Mermerit, Ndërmarrjen**

**Komunale, Ndërmarrjen Ndertim-Banesave, Ndërmarrjen e Ujësjellesit, Ndërmarrjen Mirëmbajtjes Rrugë-Ura.** Pavarësisht kushteve aktuale kjo zonë ka potencial për t'u rinovuar dhe rehabilituar. Gjithashtu ia vlen të përmenden dhe pasuritë minerale të Dibrës ku ndër ta mund të përmëndim: kromin dhe mermerin. Konsiderimi i kësaj Zone dhe vendosja e saj në funksion mund të ishte një hap i rëndesishem për Bashkinë e Dibrës. Vendbanimet vendosen kryesisht me perbërje gjeologjike.

Qyteti është i ndertuar në të dy anet e nje lugine gje e cila u krijon banoreve ndjenjen e të qenurit të strehuar e të mbrojtur. Arkitektura e ndërtimeve dhe mënyra e jetsës në zona të izoluara është e përcaktuar gjithashtu nga reliivi, i cili ka ndikuar dhe në rrjetin kryesor rrugor, duke e kushtëzuar kalimit e rrugëve brënda për brënda zonave të banuara dhe përreth tij.

Rrjetet e transportit përfshijnë lidhjet kryesore ajrore, hekurudore dhe rrugore në nivel ndërkombëtar, rajonal dhe lokal. Nyjet përfshijnë pikat kryesore të kryqëzimit. Rrjeti i rrugëve: Rruja e Arbit, Unaza perëndimore e qytetit, Rrugë interurbane dytësore, Rrugë urbane kryesore, Rrugë urbane dytësore, Rrugë lokale, Rruja e bulevardit dytësore.

Për tu përmendur janë dhe burimet e ujërave termale të cilat mund të rrisin dhe interesin e turizmit kurativ. Reabilitimi dhe trajtimi i plotë i Përroit të Lixhave si një kompozim hapsinor urban mund të bënte që ai të kthehej në një pikë referimi për qytetin dhe jo vetëm. Parku i Lixhave përfshin zonën aktuale të Lixhave zgjerohet drejt jugut e përendimit deri në bashkimin e dy përrenjve dhe në shpatet e kodrave në drejtimin verior dhe lindor.

Peshkopia zhvillohet me një qëndër lineare, përgjatë së cilës shtrihen funksionet kryesore si: administratat, institucionet arsimore, komplekset sportive etj. Lineariteti i qendrës shërben si pjesë lidhëse midis rrugëve kryesore të qytetit. Përgjatë unazës lidhet edhe me qëndrën, në të cilën shtrihen shërbime të ndryshme te bashkisë.

Vlen për t'u theksuar se ka dhe një degradim të ndërtueseve të gurta të ndërtuara para viteve '90. Një shtrirje të gjërë të këtyre banesave, e kemi në bulevardin kryesor, ku shumica prej tyre janë në gjendje shumë të degraduar dhe kanë nevojë për ndërhyrje. Silueta përgjatë bulevardit, ka marrë karakterin e një facade të vandalizuar pa asnjë vlerë estetike dhe arkitektonike. Keto ndërtesa kanë karakter institucional, ku në funksion është vetëm kati përdhe, ndërsa katet e tjera janë jashtë funksionit. Duke u bazuar tek vlera historike e këtyre ndërtueseve, restaurimi dhe vendosja në funksion e tyre mund të ishte një pike që duhet konsideruar.

## 2.2.8 Sinteza e relacionit gjeologjik

Hapsira rajonale që administrohet nga Bashkia e Dibrës, në aspektin gjeologjik (në kuptimin më të gjërë të fjalës), ofron territorin më të larmishëm të vëndit. Këtu haset një gamë e gjërë

shkëmbinjsh, që për nga kohëformimim i tyre, fillojnë nga më të vjetërata që njihen në Shqipëri, (Paleozoi), e deri në formacionet e reja të Kuaternarit dhe përfaqsohen nga formime magmatike, të origjinës kimike, terrigjene e molasike.

Në aspektin strukturor, fal edhe zhvillimeve të fuqishme tektonike në kohë, dukuria e tyre në sipërfaqe përfshin / ndërton larmi formash: nga ato të rregullta strukturore, pjesë a fragmente të tyre, luspa tektonike, mbihipje...., e deri masa shkëmbinjsh të shariazhuara për kilometra të tëra. Nga ana morfollogjike, dominon terreni me relief mjaft të aksidentuar, në të cilin ndodhet edhe majë më e lartë e vëndit, M. i Korabit.

Ndër pasuritë nëntoksore të rajonit përmëndim ato të Cromit, Fekurit, Boksidet, Squfrin, gurët dekorativ, ujërat termale, etj. Po ashtu, i pasur është edhe në ujëra nëntokësore ku përhapjen më të madhe e ka akuiferi karbonatik-karstik në sektorët lindor të rajonit. Akuferët me porozitet ndërkokrrizor janë më të kufizuar dhe shtrihen kryesisht në zonat ulura në jugë të rajonit.

Llojshmëria e shkëmbinjve të pranishëm në territor, mbi bazën e treguesit gjeoteknik "Rezistenca në shtypje", është kategorizuar në pese grupe:

*shkëmbinj të fortë; mesatar; të dobët; me / pa kohezion; dhera me veti speciale*

Mbi bazën e kategorizimit të mësipërm, në mënyrë të përgjithsuar, jepen edhe disa nga parametrat gjeoteknikë kryesor të shkëmbinjve që ndërtojnë territorin e B. Dibër, si më posht:

- Shkëmbinj të fortë, me rezistencë në shtypje  $> 500 \text{ kg/cm}^2$  ku bëjnë pjesë: shkëmbinjtë ultrabazikë e bazikë (Iu, Ib), mesataro-acidë (Ima), shkëmbinjtë efuzivë bazikë (Eb), metamorfikë rreshporë (Rm), metamorfikë rreshporo-gëlqerore (Gr), ata gëlqerorë (G) dhe ata gëlqerorë-silicorë (Gsi), me këta tregues gjeteknik të shkëmbit:

○ Pesha volumore	$\Delta = 2,2 - 2,85 \text{ gr/cm}^3$
○ Poroziteti	$n = 1,0 - 8,0 \%$
○ Rezistenca në shtypje njëboshtore	$Rsh = 500 - 1100 \text{ kg/cm}^2$
○ Moduli i elasticitetit	$E = 10^3 - 5 \times 10^5 \text{ bar}$
○ Ngarkesa e lejuar	$\sigma: > 6 - > 20 \text{ kg/cm}^2$

- Shkëmbini mesatarë kanë rezistencë në shtypje  $50 - 500 \text{ kg/cm}^2$ . Në këtë grup bëjnë pjesë: konglomeratë e ranorë me çimentim mesatarë (Kl), grapi i shkëmbinjve efuzivo-sedimentarë (Es), shkëmbinjtë flishorë ritmikë argjilo-alevrito-ranorë (Fl), dhe shkëmbinjtë mallasikë argjilor, ranoro-konglomeratike (Ma, Mrk). Parametrat gjeoteknik të përgjithsuar janë:

○ Pesha volumore	$\Delta = 1.8 - 2,6 \text{ gr/cm}^3$
○ Poroziteti	$n = 5.0 - 85,0 \%$
○ Rezistenca në shtypje njëboshtore	$Rsh = 50 - 500 \text{ kg/cm}^2$

- Moduli i elasticitetit  $E = 103 - 5 \times 103 \text{ bar}$
- Ngarkesa e lejuar  $\sigma: >2.5 - 20.0 \text{ kg/cm}^2$
- **Dhera pa kohezion ( $c=0$ )**: Në këtë grup përfshihen shkëmbinj të tillë si, zhavorre e popla me origjinë aluviale dhe proluviale (C) ku madhësia e copërave të tyre është tepër heterogene. Parametrat gjeoteknikë të tyre janë:
  - Pesha volumore  $\Delta = 1.6 - 2.1 \text{ gr/cm}^3$
  - Poroziteti  $n = 30.0 - 85.0 \%$
  - Kendi i fërkimit të brëndshëm  $\phi = 22 - 42^\circ$
  - Kohezioni  $c = 0.0 \text{ kg/cm}^2$
  - Moduli i deformimit  $E = 150 - 250 \text{ kg/cm}^2$
  - Ngarkesa e lejuar  $\sigma: 1.8 - 4.0 \text{ kg/cm}^2$
  - Koeficënti i filtrimit  $K > 50 \text{ l/24orë}$
- **Dherat me kohezion**, Këtu futen argjilat e mbivendosura mbi zhavorret (Szh) Në përgjithësi këto dhera gjenden në pjesën e sipërme të prerjes së dherave të Kuaternarit me origjinë aluviale dhe deluviale. Parametrat gjeoteknikë të tyre janë:
  - Pesha volumore në gjendje natyrale  $\Delta = 1.75 - 1.95 \text{ gr/cm}^3$
  - Poroziteti  $n = 35 - 75 \%$
  - Këndi i fërkimit të brendshëm  $\phi = 12 - 22^\circ$
  - Kohezioni  $c = 0.15 - 0.35 \text{ kg/cm}^2$
  - Moduli i deformacionit  $E = 50-200 \text{ kg/cm}^2$
  - Koeficienti i filtrimit  $K < 1 \text{ l/24ore}$
  - Ngarkesa e lejuar  $\sigma = 1.6 - 2.5 \text{ kg/cm}^2$
- **Formime me veti speciale** (Gik): Formime evaporitike me karst të zhvilluar e të përfaqësuar nga gipse, anhidrite, selenite dhe kanë këto parametrat gjeoteknikë:
  - Pesha volumore  $\Delta = 52.5 - 2.8 \text{ gr/cm}^3$
  - Poroziteti  $n = 2.0 - 15.0 \%$
  - Rezistenca në shtypje njëboshtore  $R_{sh} = 50 - 500 \text{ kg/cm}^2$
  - Moduli i elasticitetit  $E = 103 - 104 \text{ bar}$
  - Ngarkesa e lejuar  $\sigma > 5 \text{ kg/cm}^2$

Në territorin e bashkisë Dibër, janë të pranishëm edhe mjaft elemente të rrezikut gjeologjik, që jo rrallë, jepin mpakte negative në veprat inxhinierike a sociale. Ndër to përmëndim: rrëshqitjet, rrëzimet, shërbjet, vratat e erozionit, zonat karstike, problematikat nga prania e përrenjve dhe lumenjve, thyerjet tektonike, tërmetet, etj. – studimi i të cilave duhet bërë rast pas rasti.

Në "Studimi inxhinjero-sismologjik..." për këtë territor, rezulton se ai karakterizohet nga vlera mjaft të larta të rrezikut sismik, të cilat shkojnë duke u rritur nga perëndimi drejt lindjes dhe se të dhënët e paraqitura, mund të përdoren për qëllime studimore dhe planifikim të territorit, ndërsa vlerësimet e treguesëve sismik për objekte a vepra të veçanta, duhen bërë në vendin konkret.

Në materialin e paraqitur tekst dhe grafikë, gjënjë pasqyrim këto dukuri që shprehen me zonimin përkatës të territorit mbi bazën e kushteve gjeologo – inxhinierike dhe pranisë së fenomeneve të rrezikut gjeologjik. Problemet e ndotjes mjedisore dhe burimit të tyre, nga stoqet apo minierat e abandonuara, nga karrierat, mbetjet urbane, shfrytëzimi i inerteve, etj. përbëjnë një tjetër aspekt ku tërhiqet vëmëndja në planifikimet dhe masat që do ndërmarrë kjo Bashki.

Kjo, (*nevoja e mjedist të pastër*), dhe fakti i pranisë së pasurive të mëdha nëntoksore dhe resurseve gjeoambjentale, përbëjnë padyshim vlera e resurse për këtë Bashki, të cilat duhet të njihen dhe planifikohen për t'u kullandrisur me nikoqirillëk.

Gjérësish, në materialin gjeologjik të paraqitur, jepen edhe rekomandimet përkatëse për çdo disiplinë dhe zgjidhja e tyre në ecuri e rast pas rasti, gjat planifikimit dhe ndërtimit të veprave të ndryshme në hapësirat e kësaj Bashkie.



### 3 PROJEKSIONE DEMOGRAFIKE 2030


#### 3.1 Të dhëna socio -demografike

Popullsia banuase e rrethit të dibrës, sipas censusit të vitit 2011, është 61.619 banorë dhe është e shpërndarë në 15 Njesi te Qeverisjes Vendore, njëbashki dhe 14 komuna. NJQV-të janë: Bashkia e Peshkopisë dhe Komunat e Maqellarë, Melan, Tomin, Kastriot, Fushë-Cidhën, Sllovë, Kala e Dodës, Zall Rec, Zall-Dardhë, Arras, Muhurr, Luzni, Selishtë dhe Lurë

Në vitin 1989 popullsia e zonës në rang qarku ishte 100.3496 banorë, ajo është reduktuar ne

85.699 në vitin 2001 dhe ka vijuar zbritjen me ritme akoma të të shpejta për dhjetëvjecarin në vijim duke dyfishuar ritmin e renjes ne -28.1% gjate 2001-2011. Humbja totale e popullsisë banuese gjatë përiudhes 1989-2011 është 38.6% dhe numri i popullsisë ka zbritur ne 61.619 banorë në vitin 2011. Pra kemi njëzonë ku numri i popullsisë është gati përgjysmuar në njëpëriudhe 20 vjecare. Situata behet akoma me alarmantë në rast së konsiderojme komuna të veçanta, sidomos ato të zonave malore si psh: Zall Rec, Zall Dardhe, Lurë, Kala e Dodes, ku vihet re njërenjëe popullsisë me shifra shqetesuese.

Bashkia Peshkopi, së bashku me komunen Fushë Cidhen, janë të vetmet zona ku nuk kemi renjëpor përkundrazi, rritje të numrit të popullsise. Bashkia Peshkopi, ka regjistruar njërritje gjatë përiudhes 1989-2001 me 13.8%, duke kaluar nga 12.320 banorë ne 14.017 banorë por ka pasur njëtrend me shenjtë kundërt gjatë dekades tjetër 2001-2011, me njërenjëtë popullsisë prej 5.5%. Sidoqoftë, popullsia e bashkisë së peshkopise është rritur me rreth 7.6% gjate 1989-2011 pasi qyteti i Peshkopisë përben njëpikë nervralgjike për zonen dhe destinacion kryesor të migrimit te brendëshem të popullsise.



Nr	Komuna	Popullsia – viti			Diferenca ( viti)		
		1989	2001	2011	2001-89	2011-01	2011-89
1	ARRAS	6,653	5,168	3,055	-22.3%	-40.9%	-54.1%
2	FUSHË ÇIDHEN	2,691	4,203	2,909	56.2%	-30.8%	8.1%
3	KALA E DODES	5,385	4,003	2,252	-25.7%	-43.7%	-58.2%
4	KASTRIOT	9,352	8,520	6,200	-8.9%	-27.2%	-33.7%
5	LURË	5,028	2,043	1,096	-59.4%	-46.4%	-78.2%
6	MAQUELLARE	12,348	12,493	10,662	1.2%	-14.7%	-13.7%
7	MELAN	6,662	5,500	3,649	-17.4%	-33.7%	-45.2%
8	MUHURR	4,439	4,051	2,780	-8.7%	-31.4%	-37.4%
9	PESHKOPI	12,320	14,017	13,251	13.8%	-5.5%	7.6%
10	Q. TOMIN	11,646	10,238	7,590	-12.1%	-25.9%	-34.8%
11	SELISHTE	4,974	3,116	1,605	-37.4%	-48.5%	-67.7%
12	SLLOVE	6,303	4,448	2,405	-29.4%	-45.9%	-61.8%
13	ZALL DARDHE	4,373	2,154	1,051	-50.7%	-51.2%	-76.0%
14	ZALL REÇ	3,958	1,944	681	-50.9%	-65.0%	-82.8%
15	LUZNI	4,214	3,801	2,433	-9.8%	-36.0%	-42.3%
	<b>TOTAL</b>	<b>100,346</b>	<b>85,699</b>	<b>61,619</b>	<b>-14.6%</b>	<b>-28.1%</b>	<b>-38.6%</b>

### Dendësia

Dendësia mesatare e popullsisë rezulton të jetë mjaft e ulet, rrëth 78.2 banorë/km<sup>2</sup>, një shifër shumë më e ulët së nivelit kombëtar prej 148 banorë/km<sup>2</sup>. Dendësia ka luhatje të konsiderueshme në varesi të komunave. Komunat fushore kanë njëdendesi relativist me të larte (135 banorë për km<sup>2</sup> në maqellare, 165 ban/km<sup>2</sup> në fushë Muhur dhe 128 ban/km<sup>2</sup> në sllove) ndërsa komunat malore, kanë dendesi me të ulet dhe në disa raste, si për shembull në lurë, arrin deri ne 11 banorë/km<sup>2</sup>. Dendësinë më të madhe e ka Bashkia e Peshkopisë me 1,018 banorë/km, ndërsa dendësinë më të ulët e ka komuna e Zall-Dardhës, Zall Rec dhe Lurë që variojnë tek 11-24 banorë/km<sup>2</sup>. Komuna e Zall-Dardhës, Rec dhe Lurës janë komuna të cilat rrezikohën seriozisht nga shpopullimi duke regjistruar fluksë neto dalesë të popullsisë me mbi 80% .

### Përbërja gjinore

Nga totali i popullsisë banuesë prej 61.619 banorë të vitit 2011, 31.924 janë meshkuj (51.8%) dhe 29.695 (48.2%) janë femra. Raporti gjinor është 1.03 dhe evidenton njëdominance të lehtë të

meshkujve në krahasim me femrat, sidomos në grupmoshen 0-14 vjec, ku meshkujt zene 26.3% ndërsa femrat 24.9%. Në secilen nga komunat e koeficienti meshkuj/femra është më i madh se 1 (>1) por në veçanti në komunat Zall Dardhe dhe Zall Rec ky koeficinet është akoma dhe më i larte (111 meshkuj për 100 femra).

### **Gruposhat**

Popullsia e Dibrës, është njëpopullsi relativisht e re, me grupmoshen 15-64 vjec qe ze peshën kryesore me rreth 66 % të totalit të popullsisë banuese, e ndjekur më pas nga grupmosha 0-14 vjec me 26% si dhe të moshuarit me rreth 8%. Në rast së analizojme situaten në secilen komune, diferencat janë minimale, pasi strukturat e popullsisë janë mjaft të ngjashme me njera tjetren. Në rast së do na duhet te hetojme për të gjetur diferenca , shohim qe disa komuna kanë përqendrime pak me të larta apo me të uleta të disa prej treguesve demografik në krahasim me mesatren e zonës. Për shembull, në selishte, Luzni dhe Zall Rec, përqindjet e moshave të reja janë me të larta së pjesa tjetër e komunave (me vlera prane 30%), në këto komuna , përqindja e lartë e të rinjve, shoqerohet me përqindje me të uleta të popullsisë së grupmoshes 15-64 vjec ( rreth 62-63%).

Nr	Bashkia/Komuna	Popullsia	Dendësia	Grupmosha ( vjec)			Raporti gjinor
				0-14	15-64	65+	
1	ARRAS	3,055	71	26.6%	65.4%	8.0%	106.6
2	FUSHË ÇIDHËN	2,909	57	25.4%	66.3%	8.3%	107.6
3	KALA E DODËS	2,252	165	27.1%	66.8%	6.1%	108.3
4	KASTRIOT	6,200	36	24.2%	67.4%	8.4%	113.4
5	LURË	1,096	117	25.3%	65.6%	9.1%	103.3
6	LUZNI	2,433	11	29.3%	63.8%	6.9%	101.4
7	MAQELLARË	10,662	73	26.1%	65.8%	8.1%	108.2
8	MELAN	3,649	135	23.7%	67.2%	9.1%	111.3
9	MUHURR	2,780	62	23.8%	67.8%	8.3%	110.3
10	PESHKOPI	13,251	1,018	25.3%	67.5%	7.2%	105.4
11	QENDËR TOMIN	7,590	20	24.7%	66.7%	8.6%	104.7
12	SELISHTË	1,605	37	30.2%	61.7%	8.1%	110.6
13	SLLOVË	2,405	128	26.1%	66.9%	6.9%	105.6
14	ZALL DARDHË	1,051	25	27.4%	64.3%	8.3%	111.0
15	ZALL REÇ	681	25	29.8%	63.4%	6.8%	110.8

### Raportet e varësisë.

Zona e Dibrës ka njëkoeficient të varesisë së përgjitheshme prej 52.1 ku koeficineti i varesisë së të rinjve ze peshën me të madhe me 40.1, ndërsa koeficienti i varesisë së të moshuarve është reth 12. Koeficientin e përgjithshem me të ulet e ka komuna Muhur 47.5 ndjekur nga bashkia peshkopi me 48.2, ndërsa me të lartin e ka komuna Selisht me 62.1 ndjekur nga komunat Zall Rec dhe Luzni me rreth 57%. Koeficienti i varesisë së të rinjve varion nga 35.2 % në melan dhe Muhur ne 49% në selisht. Përqindjen me të lartë te të moshuurve në raport me forcen aktive të punës e ka komuna Lurë me 13.9 ndërsa me të ulten komuna Kala e Dodes me 9.1.

Nr	Bashkia/Komuna	Raportet e varësisë			Ndryshimi i popullsisë ne %		
		Përgjithe- shem	të rinjve	te moshuar	popullsia	0-14 vjec	65+ vjec
1	ARRAS	53.0	40.8	12.2	-40.9%	-19.7%	-1.1%
2	FUSHË ÇIDHËN	50.7	38.3	12.4	-30.8%	-19.9%	-0.8%
3	KALA E DODËS	49.6	40.5	9.1	-43.7%	-24.0%	-1.2%
4	KASTRIOT	48.5	35.9	12.5	-27.2%	-17.8%	0.5%
5	LURË	52.4	38.5	13.9	-46.4%	-21.0%	-0.4%
6	MAQELLARË	52.0	39.7	12.3	-14.7%	-10.3%	0.8%
7	MELAN	48.8	35.2	13.5	-33.7%	-15.7%	0.2%
8	MUHURR	47.5	35.2	12.3	-31.4%	-20.0%	0.0%
9	PESHKOPI	48.2	37.4	10.7	-5.5%	-9.0%	1.7%
10	QENDËR TOMIN	50.0	37.0	13.0	-25.9%	-16.6%	0.9%
11	SELISHTË	62.1	49.0	13.1	-48.5%	-21.2%	-1.2%
12	SLLOVË	49.4	39.0	10.4	-45.9%	-21.3%	-1.3%
13	ZALL DARDHË	55.5	42.6	12.9	-51.2%	-23.1%	-2.5%
14	ZALL REÇ	57.6	47.0	10.6	-65.0%	-29.2%	-4.1%
15	LUZNI	56.8	45.9	10.9	-36.0%	-21.3%	-1.2%

### Lindshmëra

Dibra së bashku me Kukësin paraqet koeficientin bruto të lindjeve me të lartë në shkallë vendi dhe regjistron rritje natyrore positive prej 14 lindje për 1000 banorë . Kjo shifer është ndjeshem më e lartë së mesatarja e vendit prej 12 lindje. Nnryshe nga pjesa tjeter e vendit, ku gjatë dekadave të fundit lindshemria pesoi renjëtë konsiderueshme, kjo zonë vijon të ketë norm atë larta të lindjeve edhe pse në renjënë krahasim me përiudhat e meparshme. Situata paraqitet e ngjashme në të gjitha komunat.

## Vdekshmëra

Për shkak të përmirësimeve të mëdha në sistemin shëndetësor dhe në shëndetin publik, vdekshmëria ka pasuar rënje të qëndrueshme për të gjitha moshat. Ndërmjet viteve 1950 dhe 1989, jetëgjatësia në lindje u rrit nga përburrat e përgatit. Vdekshmëria e të rriturve vazhdoi të pësojë rënje deri në vitin 2011. Vdekshmëria foshnjore, nga ana tjetër, ka qenë ne nivele te larta të larta, pavarësisht një rënjeje të konsiderueshme që nga viti 1989. Aktualisht, vdekshmeria luhatet në intervalin 6-7 vdekja për 1000 banorë. Situata paraqitet e ngashme në të gjitha komunat.

## Popullsia urbane/rurale dhe migrimi i brendshëm

Popullsia e zonës së dibrës është kryesisht rurale. Duke filluar qe nga fillimi i viteve '90 kemi njëtendence evidentë të reduktimit në numer të popullsisë si dhe levizje të popullsisë nga fshati në drejtim te qytetit, duke shkaktuar luhatje të ndjeshme të raportit popullsi urbane-popullsi rurale. Ndyshimi i raportit popullsi urbane/rurale i detyrohet kryesisht faktit së migrimi nga zonat ruarale ka qenë më i lartë së ai urban.

Popullsia urbane banuese është e përqëndraur në qytetin e Peshkopise. Popullsia e qytetit te Peshkopise është rritur me reth 14% gjatë përiudhes 1989-2001 dhe më pas në përiudhen 2001-2011, ka pësuar njërenjë prej 5.5%, duke shnuar njërritje të akumuluar prej 7.6% (viti 2011 në raport me vitin 1989). Kjo rritje e popullsisë në zonat urbane i detyrohet prurjeve nga fshatrat, te cilat në disa rastë kanë regjistruar renjëderi edhe ne 50%.

	Popullsia viti 1989	Popullsia viti 2001	Popullsia viti 2011	Diferencia	Diferencia	Diferencia
				2001-1989	2011-2001	2011-1989
<b>TOTAL</b>	<b>100,346</b>	<b>85,699</b>	<b>61,619</b>	<b>-14.6%</b>	<b>-28.1%</b>	<b>-38.6%</b>
URBANE	12,320	14,017	13,251	13.8%	-5.5%	7.6%
RURALE	88,026	71,682	48,368	-18.6%	-32.5%	-45.1%

Kjo lloj levizje e popullsisë me *tendance drejt urbanizimit*, mundet të ndahet në dy faza. Në njëfaze të parë (viti 1989-2011), popullsia rurale e fshatrave ka levizur në drejtim te qytetit te peshkopisë dhe ndërsa vetë popullsia urbane e qytetit te peshkopisë ka levizur drejt qëndrave kombëtare urbane si Tirana dhe Durrësi. Gjatë kesaj faze zona humbi rreth 14.6% të totalit të popullsisë ose 14.647 banorë, ku popullsia rurale u reduktua me 16.344 apo -18.6%, ndërsa ajo urbane u shtua me 1697 banorë apo + 13.8%. Në ate qe mund te quajme faze të dyte (viti 2001-2011), të dy kategorite, urbane dhe rurale, kane migruar në drejtim të metropolit me ritme akoma

me të larta së përiudha paraardhesë duke regjistruar njëhumbje në numrin e popullsisë totale prej -28.1% nga -14% të përiudhes paraardhese. Në ketë faze vihet re qe shpopullimi i fshatit ka vijuar akoma me shumë por qe edhe popullsia urbane ka pësuar renjënë vlere absolute

### Emigrimi dhe migrimi i brendëshem

Zona e Dibre ka normen me të lartë të migrimit të brendëshem të popullsise, (norma bruto 11.2 % ne 2014), drejt qëndrave Urbane të vendit dhe emigrimit ndërkombëtar. Qarku i Dibrës , së bashku me atë të kukësit, jaanë dy zona ku migrimi i brendëshem drejt zonave urbane është po aq i rëndësishem sa migrimi ndërkombëtar. Këto zona kane pasur dhe vazhdojne te kenë një shpopullim të fshatrave të zonave malore drejt qytetit të peshkopisë dhe në të njejtën kohe një spostim të brendëshme nga qyteti i Peshkopisë drejt qëndrave kombëtare si Tirana dhe Durresi. Sic e theksuan edhe me lart, flukset dalesë të popullsisë tejkalojnë ndjeshem flukset hyresë qe do të coj në njëreduktim të popullsisë në të ardhmene. Kjo ka sjelle në njërenjëtë numrit të popullsise, pamvarsisht rritjes natyrore qe rezulton positive. Njënormë emigrimi kaq e lartë ka pasoja direktë në tregun e forcave të punës si dhe në kontekstin social në përgjithësi ku vjen të mungoje limfa e shoqerisë gjithmonë e me shumë.

### 3.2 Tendenca demografike – Projekcion 2031

Popullsia e pranishme, sipas Institutit Kombëtar të Statistikave, në qytetin e Peshkopisë sipas kufirit të ri administrativ, i cili përfshin 15 komunat e vjetra, është më shumë se 61,600 banorë (2011). Në ndarjen territoriale banorët janë shpërndarë 21% në kryeqendrën e Peshkopisë (13250 banorë), ndërsa pjesa e mbetur prej 79% është e shpërndarë në 14 qendrat e mbetur. Tri qendra i tejkalojë 5.000 banorë: Maqellarë me më shumë se 10.000 banorë, Q.Tomin me 7600 dhe Kastriotit me 6200 banorë. Qendrat e tjera kanë një popullsi rreth 2-3 mijë banorë përashtuar Zall Rec që ka më pak se 1000 (681 banorë).

Në të gjitha qendrat, popullësia në 10-15 vitet e fundit ka rënë dhe është theksuar fenomeni i braktisjes dhe emigracionit drejt pjesëve të tjera të Shqipërisë, por edhe jashtë vendit.

Parashikimet sipas INSTAT per vitin 2031, Jane per një popullsi ne renje prej rreth 30%. Keto stima jane perfunduar duke u bazuar ne hipoteza te caktuara ne lidhje me lindshemire, vdekshemrine si dhe migrimin e brendeshme dhe nderkombetar, por ato *nuk marrin ne konsiderate* veprimet dhe masat nxite se nga politikberesit ne permiresimin e gjendjen dhe persepektivave ekonomiko-demografike te zones. Konkretilisht, perfundimi i rruges s e Arberit, finacimet e projekteve ne Buqesi dhe Turizem ( Agro Turizem , turizem Malor, etj), mbeshtetja e projekteve per te bere qyetin e Peshkopise një qender grumbullimi, perpunime dhe shperndarje te produkteve bujqesore dhe blegtore per zonen, si dhe ndërhyrjet e rendesishme ne rilindjen urbane te qendrave te njesive administrative, pritet te kene efekte pozitive ne kontrast me pritshmerite demografike ngushtesisht teknike te INSTAT-it.

Keshtu qe, nga ponderimi i ketyre dy vektoreve me shenja te kundert, pritshmerite demografike, sipas stimave te bera nga ne, karakterizohen nga nje populsi ne ekspansion ne Qytetin e Peshkopise si dhe nga ana tjeter, nje reduktim ne zonat rurale malore por sidoqofte me i permbajtuar sesa stimat e INSTAT sipas "skenarit mesatar".

Karakteristikat e stimave demografike per vitin 2031 i kemi permblehdhur si me poshte:

- Qyteti i Peshkopise do te vijoje te behet gjithnje e me shume atraktive si nyje ekonomike dhe kulturore e e zones. Kjo do te sjelli nje rritje te populsisë me 7.9% ( nga 7.4% qe ka qene per vitet 1989-2011 ). Ka disa zona me tendence pozitive si per shembull Maqellara, si dhe disa zona te tjera me potenciale zvillimi te konsiderueshme si per shembull Kastriot dhe Fushe Cidhen.
- Per secilen zone rurale dhe malore, si rezultat i masave ekonomiko-politike qe priten te merren ne Bujqesi dhe ne sektorin e Turizmit nga njera ane, si dhe nga rritja e nivelit ekonomik ne nivel Kombtar nga ana tjeter, do te bejne qe 20 vitet e ardheshme 2011-2031, pritet te jene gjithsesi me pozitive se njezetyjecari paraardhes i karakterizuar me largime ne mase te populsisë
- Largimet ne mase te viteve te fundit sidoqofte do te kene pasoja per vitet ne vijim dhe disa zona ( Zall Rec, Zall dardhe, Lure) do te vuajne konsequencat me shume se qendrat e tjera administrative.

Ne tabelen e meposhteme po paraqisim keto pritshemrine ne numra:


nr	komuna	Popullsia viti 2011	ndyshimi ne % ( 2011 - 2031)	gejndja ne vitin 2031 ( ne numer)
1	PESHKUPI	13,251	7.9%	14,301
2	ARRAS	3,055	-31.1%	2,105
3	FUSHE ÇIDHEN	2,909	-18.9%	2,359
4	KALA E DODES	2,252	-33.3%	1,502
5	KASTRIOT	6,200	-20.2%	4,950
6	LURE	1,096	-50.2%	546
7	MAQELLARE	10,662	1.0%	10,762
8	MELAN	3,649	-26.0%	2,699
9	MUHURR	2,780	-23.4%	2,130
10	QENDER TOMIN	7,590	-21.1%	5,990
11	SELISHTE	1,605	-31.2%	1,105
12	SLLOVE	2,405	-33.3%	1,605
13	ZALL DARDHE	1,051	-38.1%	651
14	ZALL REÇ	681	-51.4%	331
15	LUZNI	2,433	-32.9%	1,633
	TOTAL	61,619	-14.5%	52,669

#### 4 PERCAKTIMI I TERRITORIT NE TE 5 SISTEMET DHE ANALIZA SWOT

Territori i bashkise , me qëllim të përgatitjes së PPV, është ndarë në pesë sisteme në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 107/2014 dhe te rregullores aktuale:

1. Sistemi Urban (UB)
2. Sistemi Infrastrukturor (IN)
3. Sistemi Natyror (N)
4. Sistemi Ujor (U)
5. Sistemi Bujqesor (B)

Këto sisteme nuk duhet të lexohen si komponente të izoluara, por në ndërveprim të vazhdueshëm dhe lidhje midis tyre në një perspektivë të zhvillimit strategjik të territorit, në bazë të potencialeve, problemeve dhe nevojave te mundshme dhe specifike të çdo sistemi.



Ndarja aktuale e territorit në sistemet e ndryshme paraqitet nga tabela e mëposhtme në të cilën janë reguar si në vlerë absolute (në hektarë) ashtu dhe në përqindje:

Sistemi	Ha	%
<i>Sistemi Urban (UB)</i>	2,000	2,1%
<i>Sistemi Infrastrukturor (IN)</i>	1,211	1,3%
<i>Sistemi Natyror (N)</i>	74,389	79,3%
<i>Sistemi Ujor (U)</i>	532	0,6%
<i>Sistemi Bujqësor (B)</i>	15,639	16,7%

Duke iu referuar skenareve për vitin 2030, në përputhje me objektivat e strategjisë territoriale është vlerësuar së do të ndryshojë vlera në përqindje sidomos e sistemeve urbane, natyrore dhe bujqësore. Në mënyrë të veçantë, për t'iu përgjigjur nevojave për strehim të lidhura si me rezidencat ashtu edhe me shërbimet dhe sistemin e prodhimit, do të ketë një rritje të sipërfaqes së zenë nga sistemi urban të llogaritur + 0.5% për një përqindje totale të sistemit urban prej 2.5%. Kjo rritje behet edhe nga nevoja për të përshtatur dhe legalizuar strukturat ekzistuesë dhe nga nevojat e sistemit ekonomik, pavarësisht nga parashikimet demografike të qarkut të dibrës qe tregojnë një rënie të konsiderueshme në popullsisë. Në të njëjtën kohë ju do të ketë një rritje të sipërfaqeve të destinuara kulturave bujqësore në përputhje me objektivin e rritjes së prodhimeve bujqësore vendasë dhe për të përmirësuar produktivitetin dhe rentabilitetin e sektorit si një mundësi për rritje; Prandaj, është llogaritur një rritje në zonën e sistemit bujqësor prej rreth 4 pikë përqindjeje në rreth 21% në përgjithësi. Paralelisht sistemi natyror do të ulet me rreth 5% duke arritur nën 75% në përgjithësi. Për sa i përket sistemit hidrografik, objektiivi është për të ruajtur ekuilibrin e sipërfaqeve. Ndryshime të vogla në përqindje mund të regjistrohen edhe për sistemin e infrastrukturës, pa shkaktuar ndryshime të rëndësishme në total.

Sistemi	% 2015	% 2030
<i>Sistemi Urban (UB)</i>	2,1%	2,6%
<i>Sistemi Infrastrukturor (IN)</i>	1,3%	1,3%
<i>Sistemi Natyror (N)</i>	79,3%	74,8%
<i>Sistemi Ujor (U)</i>	0,6%	0,6%
<i>Sistemi Bujqësor (B)</i>	16,7%	20,7%
<b>totali</b>	<b>100%</b>	<b>100%</b>

#### 4.1 Sistemi Urban (UB)

Sistemi territorial i Dibrës është strukturuar mbi variacione te madhe natyrore te ultesires së madhe bujqësore përgjatë Drinit, ne te cilën ndodhet Peshkopia dhe lokalitet kryesore. Në perëndim të parkut te Lures eshte territori kodrinor dhe në fund në lindje parku kombëtar Korab-Koritnik. Territori urban i zonave të banuara përbëhet nga qyteti i Peshkopisë dhe 141 fshatra, që gjenden në territorin e 14-të Njësive Administrative dhe përkojnë me ish-komunat. Pjesën më të madhe të këtij territori e zënë sipërfaqet për përdorim "banimi" - banesa private, 1 dhe 2-katëshe, me oborre në zonat rurale dhe apartamente 3-5 katëshe më së shumti, por edhe më të larta në zonën urbane të Peshkopisë.

Në zonat rurale dendësia është e ulët dhe kushtet e banimit të dobëta, me mungese e objekteve dhe sherbimeve publike, njekohesisht aksesibiliteti në zonat kryesore urbane është i dobët.




Figura 1: Densiteti i banimit i sistemit te nderimeve te Bashkise Diber

Nga të dhënat e strategjise per territorin e Dibres tregon se nëse i referohemi hartës së kategorizimit të zonave sipas lartësisë mesatare, vihet re se ato variojnë:

1. Për zonën e urbanizuar urbane numri i kateve varion nga 1 deri në 11 kate. Përqendrimi maksimal i banesave 4-5-katëshe vihet re në lagjen Dobrovë, në Lagjen e Re, në lagjen "Gjokë Doçi", etj.
2. Në zonën e urbanizuar rurale vihen re ndërtime masive me 1-2 kate.

Më poshtë jepen të dhënat rreth zonimit të funksioneve brenda territorit të bashkisë Dibër:

Kategoria baze	Nenzonat	Siperfaja ne ha
Zona banimi	Fshatrat	14469
	Dendesi e ulet para 90	0.6
	Dendesi e mesme para 90	1.2
Zona bujqesore	Toke bujqesore	19117
	Livadhe	11886
Zone sherbimesh	Rruge	10
	Fushe sporti	4
	Sociale	1
	Nenstacione	4
Zone industriale	Zona mikse	10
	Industriale	6
Zona natyrore	Pyje	53857
	Burime ujore	8
Zonat e perdorimet te veçante	Varrezat	710
	Minierat	16

Qyteti i Peshkopisë ndodhet ne qendren e fushës së madhe bujqësore që shtrihet nga bregu lindor i Drinit te Zi dhe mbyllt në perëndim nga parku i Lures me terrenin e saj kodrinor dhe në lindje me parkun kombëtar Korab-Koritnik. Vendndodhja strategjike e Peshkopisë e kthen atë ne kryqezim të drejtimeve ekologjike të gjelbër dhe blu, zonave te ndertuara dhe infrastrukturës që e lidhin ne drejtimin gjatesor (veri-jug) dhe tërthor (lindje-perëndim) ultesiren bujqesore, duke forcuar rolin ne territor.

Pas reformës administrative, bashkia e Dibrës u riorganizua si me poshtë:

Njësitë administrative përbërëse	Qytetet dhe fshatrat në përbërje të tyre
Peshkopi	Peshkopi
Tomin	Tomin, Brezhdan, Cetush, Dohoshisht, Pilafe, Pollozhan, Rrashnapojë, Selane, Ushtelenxë, Bahute, Staravec, Shimçan, Zimur, Zdojan
Melan	Melan, Cerjan, Rabdisht, Zagrad, Begjunec, Trepçë, Grevë, Ilnicë, Bellovë, Pejkë, Pjeçë, Trenë

Kastriot	Kastriot, Brest i Sipërm, Brest i Poshtëm, Kishavec, Kandër, Kukaj, Vakuf, Fushë-Kastriot, Borovjan, Deshat, Limjan, Sohodoll, Sohodoll i Vogël, Vrenjt, Përgjegje
Lurë	Fushë-Lurë, Borie-Lurë, Arth, Gurë-Lurë, Lurë e Vjetër, Arrëmollë, Krej-Lurë, Pregj-Lurë, Sumej, Vlashej
Maqellarë	Maqellarë, Billatë e Poshtme, Billatë e Sipërme, Burim, Çernen, Fushë e Vogël, Katund i Vogël, Kërçisht i Sipërm, Kërçisht i Poshtëm, Kllobçisht, Kovashicë, Majtarë, Pocest, Pesjak, Podgorc, Vojnik, Dovolan, Erebarë, Grezhdan, Herbel, Popinar, Gradec
Muhurr	Muhurr, Bulaç, Fushë-Muhurr, Hurdhë-Muhurr, Rreth-Kale, Shqath, Vajmëdhej
Luzni	Katund i Ri, Hotesh, Lishan i Poshtëm, Lishan i Sipërm, Arap i Sipërm, Arap i Poshtëm
Selishtë	Selishtë, Kacni, Lukan, Murrë, Qafë-Murrë, Selishtë e Sipërme
Sllovë	Sllovë, Kallë, Vleshë, Zall-Kalis, Dypjakë, Palaman, Sllatinë, Shumbat, Venisht, Trojak
Kala e Dodës	Ceren, Kullas, Ploshtan, Radomirë, Shullan, Tejzë, Ujëmirë, Vasie
Zall-Dardhë	Zall-Dardhë, Lashkizë, Lugiej, Menesh, Nezhaj, Qa, Soricë, Shënlleshën, Tartaj
Zall-Reç	Zall-Reç, Bardhaj-Reç, Draç-Reç, Gur-Reç, Hurdhë-Reç, Kraj-Reç, Ndërshenë, Qafdraj, Tharkë
Fushë Çidhën	Fushë Çidhën, Blliçe, Laçe, Rrenz
Arras	Arras, Gur i Zi, Lazrej, Kodër Leshaj, Mustafe, Sinë e Sipërme, Sinë e Poshtme, Çidhën, Grykë Nokë

Strukturat ne funksion te arsimit, nga pikëpamja e shërbimeve për arsimin mbipopullimi i zonës urbane në Peshkopi ka krijuar probleme, të cilat lidhen, jo vetëm me shpërndarjen gjeografike të shkollave, por edhe me funksionimin normal të orëve mësimore në shkollat ekzistuese. Në zonën urbane numri i nxënësve për një klasë është në rritje. Në të gjitha klasat e shkollave në qytet ky numër i kalon kuotat normale dhe arrin deri në 40- 42 nxënës për një klasë në arsimin nëntëvjeçar dhe 35-40 nxënës për një klasë në arsimin e mesëm. E kundërt paraqitet gjendja në zonat rurale. Shpërndarja e madhe territoriale e komunitetit dhe numri i ulët i nxënësve për çdo klasë ka çuar në krijimin e klasave mikse, me deri 18 nxënës për shkollën nëntëvjeçare dhe 15 nxënës për shkollën e mesme, si në Zall-Dardhë, Reç, Muhurr, Kala e Dodës, etj. Në Dibër gjendet një shkolla e mesme profesionale "Nazmi Rushiti", ku ofrohet arsim i mesëm profesional në degët pedagogji, gjuhë të huaja, ekonomi, mekanikë. Ndërkohë, si rrjedhojë e nevojës së tregut, kësaj shkolle pritet t'i shtohen së shpejti edhe disa degë të tjera, si bujqësi, blegtori, etj.

Mbyllja e universitetit "Aleksandër Moisiu" në Dibër shënoi një regres për sistemin arsimor në Dibër. Universiteti pati një ndikim pozitiv në rritjen e njohurive dhe nxjerrjen e studentëve për degë të ndryshme, që përshtateshin mjaft mirë me tregun e punës. Megjithëse degë e universitetit të Durrësit, ai pati dhe një impakt social e shoqëror në rajonin e Dibrës, duke i dhënë pamjen e qytetit universitar, me më shumë gjallëri. Kjo eksperiencë shtron nevojnë e hapjes së një dege universitare në Dibër, me orientim drejt tregut të punës dhe më afër profilit të zonës, që lidhet me zhvillimin agrar dhe ekonominë rurale.

Per sa i perket sistemit shendetesor, në Dibër aktualisht operojnë në nivel komuniteti 162 qendra mjekësore pa shtretër (1 poliklinikë, 15 qendra shëndetësore dhe 146 ambulanca, 1 spital rajonal, 15 konsultore të nënës, 15 konsultore për fëmijë dhe 15 farmaci dhe 11 klinika dentare private). Spitali rajonal ofron shërbime në patologji, obstetri-gjinekologji, kirurgji, infektiv, pediatri, reanimacion, radiologji dhe shërbime laboratorike. Spitali ka një kapacitet prej 270 shtretërish.

Numri i punonjësve në shërbimin shëndetësor është 24 mjekë specialistë, 222 staf mjekësor (infirmierë) dhe 137 punonjës administratice. Struktura gjinore e stafit spitalor është 84% femra, ndërkohë që femrat përbëjnë vetëm 33% të mjekëve specialistë. Shërbimi spitalor është i përqendruar në tri godina, ku kurohen, jo vetëm pacientë nga bashkia, por dhe nga të gjitha njësítë administrative të rrethit të Dibrës. Në sajë të investimeve të kryera janë përmirësuar ambientet dhe pajisjet mjekësore, ndërkohë që mbetet shqetësim mungesa e mjekëve në disa specialitete. Kjo mungesë detyron shumë pacientë të shkojnë për kurim dhe vizita mjekësore më të specializuara drejt Tiranës.

Persa i perket banimit, strehimi në Dibër është kryesisht privat. Numri total i banesave nuk është i regjistruar, por vlerësohet të jetë tek 11,000 shtëpi në zonën rurale dhe 3,250 shtëpi në zonën urbane, vlerësim i bërë nga zyra për planifikimin e urbanistikës në bashki. Aktualisht njësia e qeverisjes lokale, që është përgjegjëse për strehimin ka mbuluar vetëm jesën e familjeve që jetojnë në zonën urbane (qytetin e Peshkopisë), sepse në zonën rurale është mbuluar nga vetë banorët. Për momentin janë 750 familje të regjistruara si të pastreha dhe që po presin të marrin një apartament. Ka shumë prej këtyre familjeve që jetojnë me të afërmit e tyre, apo diku tjetër me qera. Më parë bashkia e Peshkopisë ka përfituar nga mbështetja e qeverisë qendrore me programet e saj për strehimin, falë dhënes së kreive me interes 0, si dhe me projektin e banesave sociale, financim i CEB-së (Banka Qendrore Evropiane). Në total janë ndërtuar 26 apartamente dhe u janë shpërndarë të pastrehëve. Gjatë viteve të fundit janë ndërtuar disa pallate me apartamente të shumta në disa lagje të qytetit, ashtu siç është përcaktuar nga bashkia, shumë banesa private multifunksionale dhe shtëpi private në periferi të qytetit. Këto shtëpi janë ndërtuar si prona private, por pa leje ndërtimi (në total 2,932 kërkesa janë në proces legalizimi). Vetëm 122 certifikata legalizimi janë përfunduar.

Ne perfundim te analizes mundet te rendesim pikat e forta, dobesite , mundesite dhe kercenimet e sektorit urban:

#### Anët e Forta

- Pozicion i favorshëm gjeografik , mundësi për shfrytezimin e fondeve të BE-së për bashkëpunimin ndërkufitar.
- Peshkopia dhe fshatrat perreth janë zona urbane kompakte.
- Dibra sipas politikave kombëtare është qendra ndërmjetese e aglomerateve rajonale, që nënkupton avantazhe nga prania e zyrave dhe shërbimeve publike.

#### Dobësitë

- Cilesi e ulet e sherbimeve ne zonat rurale
- Mungesa e banesave sociale per grupet ne nevoje
- Zgjerimi i paplanifikuar i qendrave urbane, me mungese te hapësirave v publike dhe cilësi te ulet urbane.
- Evicenca e ulet ne ofrimin e sherbimeve.
- Mungesa e aktiviteteve kulturore.
- Infrastruktura arsimore me cilesi te ulet.

#### Mundësitë

- Bashkepunim ekonomik dhe social ne nivel rajonal.
- Mundesa e kalimit te Korridorit 8

#### Kërcënimet

- Fenomeni i migrimit nga keto zona drejt Tiranës dhe Durrësit
- Tendenca e të rinjve për të braktisur zonën


## 4.2 Sistemi Infrastrukturor (IN)

Bejne pjesë ne sistemin e infrastrukturor të Dibrës:

- Rrjetet rrugore te nivelit kombëtar, rajonal dhe lokal dhe të sistemit të transportit publik;
- Rrjetet teknologjike që përfshijnë: linjat e energjisë, tubacionet e gazit, ujësjellësit, kanalizimet, vendgrumbullimet e mbeturinave

Sistemi rrugor i zonës funksionale të Dibrës përbëhet nga një sistem rrugor prej 911 km, nga të cilat 145 km janë të asfaltuara dhe 766 km të paasfaltuara. Infrastruktura rrugore funksionon mbi bazën e tre kategorive kryesore rrugore, që janë: rrugë kombëtare, gjithsej 109 km, nga të cilat 60 km janë të asfaltuara, rrugë rajonale, gjithsej 72 km, ku vetëm 3 km janë të asfaltuara dhe rrugët lokale të brendshme që lidhin fshatrat dhe lagjet me njëra-tjetrën, gjithsej 730 km, nga të cilat 82 km të asfaltuara. Në figurën më poshtë jepen treguesit e sistemit rrugor.

Siç shikohet edhe nga grafiku, shumica e rrugëve janë të paasfaltuara, por edhe rrugët e asfaltuara, që përbëjnë 16% të infrastrukturës rrugore, lënë për të dëshiruar, sidomos pjesa e akseve të rrugës nacionale. Zona e Dibrës ka një akses të vështirë e të kufizuar në rrjetet infrastrukturore kryesore të vendit, përfshi kryeqytetin, portet dhe aeroportin. Projekti i ndërtimit të Rrugës së Arbit i hap një mundësi shumë të rëndësishme zhvillimit të zonës në lidhje me aksesin shumë të shpejtë në tregjet kombëtare dhe rajonale, nga 182 km vetëm në 78 km, dhe me rrugë cilësore.



Burimi: Strategjia e territorit të Dibrës

### Infrastruktura dhe transporti publik: Dobët

Zona e Dibrës ka një akses të vështirë e të kufizuar në rrjetet infrastrukturore kryesore të vendit përfshirë Kryeqytetin, Portet e Aeroportin. Megjithëse jo shumë distance ne km, për të udhëtar për në Dibër të duhen jo më pak se 5 orë udhëtim për të arritur në Peshkopi. Mungojnë investimet serioze në këtë aks rrugor, segmentet rrugore që kanë filluar ose përfunduar janë jo të projektuara mirë dhe jo në standarde teknike. Projekti në vijim i ndërtimit të rrugës së Arbrit i hap një mundësi shumë të rëndësishme zhvillimit të zonës në lidhje me aksasin shumë të shpejtë në tregjet kombëtare dhe rajonale. Peshkopja dhe komunat përreth komunikojnë me një rrjet rrugor të asfaltuar së fundmi dhe relativisht në gjendje të mirë. Asfaltimi i rrugës drejt Kukësit hap edhe perspektivën e zhvillimit të turizmit malor rreth malit të Korabit.

Sistemi rrugor për zonën e Dibrës, funksionon mbi bazën e tre kategorive kryesore rrugore që janë: Rrugë Kombetare, Rruge rajonale Rrugët lokale.

Rrugët kombëtare janë arteriet kryesore që lidhin zonën e Dibrës më sistemin kombëtar të rrugëve. Rrugët rajonale nationale në zonën e Dibrës janë 109 km, nga të cilat 60 të asfaltuara dhe 49 të pa-asfaltuara.

Rrugët rajonale dhe lokale rurale (nga 25-40km) nuk janë në nivelin e duhur, sidomos rrugët që lidhin Peshkopinë me zonën turistike të Lurës, Recit, Selishtës, Zall-Dardhës, Arrasit duke krijuar kështu zona periferike të largëta, të pazhvilluara, të vështira për tu mbuluar me shërbime dhe të pa-kontrolluara nga dëmtuesit e pyjeve dhe florës e faunës në përgjithësi. Kapaciteti teknik dhe finansiar për mirëmbatje dhe investim në sistemin e rrugëve lokale është i dobët dhe i pa-përballueshëm nga buxhetet e Njësive Qeverisjes Vendore, kjo ndikon në gjendjen e keqe të këtyre rrugëve. Rrugët rajonale janë në invetarin e Ndërmarrjes së Rrugëve Rurale që është në varësi të Këshillit të Qarku Dibër. Në varësi të kësaj ndërmarrje për zonën e Dibrës janë gjithsej 72 km nga të cilat 3 km të asfaltuara dhe 69 km të pa-asfaltuara.

Rrugët lokale janë në varësi të pushtetit lokal të cilat përgjigjen për mirëmbatjen e tyre. Zakonisht vendoset një buxhet për mirëmbatjen e rrugëve, por përdoren dhe fondet për

emergjencat si shpenzimet për pastrimin e rrugëve gjatë dimrit. Këto zëra janë nën pjesën e investimeve në buxhetin e NJQV. Sipas NJQV ky është shpenzim për mirëmbajtjen e rrugëve.

### Transportit publik

Transporti Publik është privat dhe kryhet me furgona. Në të gjithë zonën e Dibrës nuk kemi transport më Autobuzë, tren apo aeroport. Transporti lokal që lidh qendrat e komunave dhe fshatrat me Peshkopinë kryesisht bëhet më furgona jo të licensuar. Kushtet e transportit publik janë të pranueshme, por për transportin brenda zonës se Dibres paraqitet veshtirësi. Zonat periferike si Lura, Reçi, Zall-Dardha, Selishta dhe Arrasi qe janë larg nga Peshkopia dhe aksesi rrugor është i vështirë pasi rruga është e pa-asfaltuar dhe në gjendje të keqe. Këto qendra periferike kanë fshatra me distancaedhe më të largëta, duke bërë të vështirë aksesin rrugor të tyre me qendrën urbane të Peshkopisë. Për zonat e tjera pothuajse ka në çdo kohë furgona. Transporti publik me Tiranën behet me furgona( mbi 11 +1) të licensuar, me orar dhe brenda kushteve teknike dhe standardeve të vendosura nga Ministria e Punëve publike dhe Transportit. Janë gjithsej reth 250 furgona që nisen çdo ditë nga Peshkopia dhe Tirana në orare fikse .

### Sherbimet publike

#### Furnzimi me uje: I kenaqshëm

Problematika kryesore lidhet me mungesë e shërbimit të furnizimit me ujë të gjithë territorit të Dibrës. Më problematike janë komunat e Luznisë, Tominit, Maqëllara, Recit dhe Lurës të cilat një pjesë e madhe e fshatrave nuk kanë akses në shërbimin e Ujit të Pijshëm. Edhe komunat e Zall-Dradhës, Kalsë, Muhurrit, Arrasit kanë një % të konsiderushme të fshatrave që nuk kanë Ujësjellës.

Cilesia e Sherbimit te furnizimit me uje te konsumatoreve vazhdon te jete e dobet. Kjo konsiston ne mosfurnizimin e vazhdueshem te klienteve me uje te pijshem, ne mos sigurimin e presionit te duhur te ujit prane konsumatoreve, ne vonesat e riparimeve te difekteve te konstatuara, etj. Shumë pak linja ujësjellësish ofrojnë furnizim me ujë pa ndërprerje drejt konsumatorëve. Mos kontrolli i burimeve të ujrave dhe mungesa e një sistemi të klorifikimit është rrezik për shëndetin e banorëve të Dibrës, ku vetem 20% e sasisë së ujit i nënshtrohet testit të kontrollit të kushteve bakteoro-kimike të ujit në burim dhe pas klorifikimit te tij.

**Dobesite menaxheriale:** Ketu po permendim disa me kryesorët që lidhen me performancën e administrimit sic janë:

Mungesa e planeve të menaxhimit të ujit të pijshëm;

Nivel të ulët të arkëtimeve kjo për shkak të mos faturimit si duhet të sasisë së ujit që harxhohet, dhe mungesës së një sistemi modern dhe të besueshëm faturimi dhe arkëtimi;

Mungesa të matësve në shumicën e lidhjeve dhe dëmtimi i atyre matësve në pikat që janë vendosur;

Kostoja e lartë e prodhimit dhe shërbimit të ujit të pijshëm si mungesë e eficencës në menaxhimin dhe administrimin e këtij shërbimi, si pasojë e shpenzimeve të shumta dhe borxheve që i kanë ndërmarrjes së ujësjellësit klientët sidomos ato shtetërorë ;

Konfliktet sociale për çështjet e pronësisë, e cila është bërë pengesë për investime dhe për realizimin e disa ujësjellësve, ku më i madhi është mos-funksionimi i ujësjellësit të Luznisë .

### Trajtimi I mbetjeve urbane: Dobët

Cilësia e shërbimit të pastrimit në Dibër është e ulët. Në zonat rurale që janë nën juridksionin administrativ të komunave ky shërbim pothuajse mungon fare, vetem disa komuna si Maqellara, Melani, Tomini, Selishta, Muhurri kanë marrë disa masa elementare për menaxhimin e mbetjeve, por që nuk kanë një sistem menaxhimi por vetëm disa elementë të kujdesit të grumbullimit të mbetjeve. Shumica e mbetjeve në zonat rurale hidhen nga vetë banorët buzë përrrenjve dhe lumenjve duke ndotur mjedisin dhe rritur rrezikun që vjen nga ndotja e ujerave për mjedisin dhe ajrin. Mbulimi me shërbimin e menaxhimit të mbetjeve, vetem 26.3% e familjeve ne nivel te zonës funksionale mbulohen me shërbimin e menaxhimit të mbetjeve. Këtu vetëm Bashkia Peshkopi që mbulon të gjitha familjet .

Mungon procesi i ndarjes dhe ricklimin te mbetjeve qe tek qytetari deri tek fusha e depozitimit.

**Fshirja e rrugëve dhe gjelbërimi:** Ky proces shërbimi përmban fshirjen e rrugëve dhe rrugicave të qytetit, mbledhjen e mbeturinave në sipërfaqen publike të qytetit, pastrimin e pusetave, mbledhjen e mbeturinave inerte dhe kujdesin për sipërfaqet e gjelbërtë të lulishteve . Ky shërbim ofrohet vetëm në Qytetin e Peshkopisë.

**Rickiliimi:** Nuk kemi një proces të formalizuar të ricklimit të mbetjeve në zonën e Dibrës, si për mbetjet që janë organike dhe për mbetjet jo-organike. Në zonën e Dibrës si dhe në zonat e tjera kemi në mënyrë informale të mbledhjes së mbeturinave të riciklueshme .

Arkëtimi nga tarifat e pastrimit eshte vetem 32 % e buxhetit që harxhohet për shërbimin e pastrimit dhe grumbullimit të mbetjeve. Këto të ardhura kryesisht NJQV i grumbullojnë nga të ardhurat e tyre, kështu më shumë se 67.7% mbulohet nga buxheti I NJQV, I cili mund të ishte planifikuar për shërbime të tjera në territorin e NJQV-së.

**Tarifa dhe arkëtimi:** me vendime të këshillave vendore janë përcaktuar tarifat për pastrimin. Bashkia Peshkopi ka lloje të ndryshme tarifash përsa i përket natyrës, si për familjarët, bisneset, firmat e mëdha etj. Ndërsa njësitë vendore të tjera kanë vetëm për familjarët e cila varion tek 1200 leke vit për familje. Norma e arkëtitit është e lartë në Peshkopi që arrin tek 92% kjo për arsy që bashkia përdor zyrat dhe shërbimet e tjera në bashki për vjeljen e kësaj tarife..

**Personeli dhe administrimi:** Në të gjitha NjQV-të menaxhimi i mbetjeve bëhet nga zyra e shërbimeve e cila është e ngarkuar për të ofruar këtë shërbim. Në 8 Komunat që ofrojnë këtë shërbim është i punësuar vetëm 1 person, i cili është përgjegjës për grumbullimin dhe transportimin e mbetjeve. Në bashkinë Peshkopi është një brigadë e posacme që merret me këtë proces.

**Sherbimi shendetesor :** Shumica e banorëve të Dibrës shërbimet bazë publike i arrin në Peshkopi. Spitali rajonal i Peshkopisë me 10 pavione, 340 infermiere, 23 doktorë është qendra më e madhe që mbulon gjithë zonën. Aktualisht ne qarkun e Dibres sherbimi shendetosore ofrohet nepermjet një spitali rajonal, 3 Poliklinikave , 34 Qendra shendetosore , si dhe 187 konsultore te gruas dhe femijeve. Zona e Dibres ka rreth 37 shtreter per banore.

**Sherbimi arsimor:** Filiali i Universitetit "Aleksandër Mojsiu" dhe 2 shkollat e mesme (e përgjithshme dhe profesionale) që janë në Peshkopi e bëjnë qytetin qendrën arsimore të zonës së Dibrës. Aktualisht është një shkollë e mesme profesionale që aftëson nxënësit në disa degë kryesore si mekanike, elektrike, tekstile, pedagogjike, ekonomike, etj. Megjithëse janë rreth 417 nxënës që që ndjekin shkollën e mesme profesionale, kërkesat për degë të tjera që t'i pergjigjen tregut të punës janë të shumta dhe si më emergjentet janë ato që lidhen me bujqësinë, turizmin malor, ndërtimin etj. Në zonën e Dibrës e perfundojnë shkollën 9-vjecare rreth 1200 nxënës dhe ndjekin shkollën e mesme vetëm 1000 nxënës, pra janë rreth 200 të tjerë që nuk ndjekin shkollën mesme. Pra nevoja për kurse të formimit profesional është shumë e lartë pasi janë 17% që nuk ndjekin ansjë shkollë dhe është një numër i madh nxënësish që kanë mundësi të ndjekin shkollat profesionale ose një potencial për kurse profesionale

Ne perfundim te analizes mundet te rendesim pikat e forta, dobesite , mundesite dhe kercenimet e sektorit Infrastrukturor:

#### Anët e Forta

- Përmirësimi i aksesit ne fshatra (Financim nga Fondi Shqiptar i Zhvillimit)
- Nderhyrje cilesore në sistemin e furnizimit me ujë të Peshkopise (furnizimi, shpërndarja dhe administrimi); një praktikë e mirë për tu aplikuar te gjithe rajonin.

#### Dobësítë

- çështje kritike është aksesibiliteti i dobët i brendshem: rrugët në zonat rurale janë të shtruara dhe shpesh bëhen të pakalueshme, sidomos në dimër
- Mungesa e ujit të pijshem
- Infrastruktura e dëmtuar e rrjetit të ujësjellësit
- Lidhjet informale
- Menaxhimi i keq i mbeturinave
- Mangesi ne trajtimin e ujrate te zera

#### Mundësítë

- Ndërtimi i rrugës së Arbit, e cila do të mundesoje që territori i Dibrës te integrohet në Korridorin 8;
- Ndërtimi i infrastrukturës rrugore të brendshme që lidh qytetin me fshatrat e ndryshme dhe me zonat me potencial turistik të larte si Kastriot-Lurë, Muhurr-Selishte, Peshkopi-Zimir dhe Mons-

**Rabdisht;**

- Përmirësimin e furnizimit me ujë të pijshëm, duke zgjeruar shembullin pozitiv të Peshkopisë

**Kërcënimet**

- Mungesa e lidhjeve ne sistemin rrugor.
- Transporti publik me Tiranen i dobet.

### **4.3 Sistemi Natyror (N)**

Qyteti i Dibres është e pasur me burime ujore dhe ofron një shumëlojshmëri të biodiversitetit. Mbrojtja e mjedisit dhe biodiversitetit janë veçanërisht të rëndësishme për zonën e Dibres, të karakterizuar nga prania e ligenit të Fierzës që përfaqëson bashkimin e disa përrrenjeve dhe lumenjve. Lumejte rrezikohen nga ndotja e ujit si rezultat i dekompozimit tembeturinave me origjine urbane bujqesore dhe industriale.

Territori i zonës së Dibrës dallohet për monumente të shumta natyrore (41 monumente), qofshin këto gjeo-monumente, hidromonumente apo bio-monumente. Për vlerat e tyre të veçanta historike, estetike, turistike, biologjike ato përbëjnë një numër të madh objektesh dhe peizazhesh të shpallura si monumente natyre. Këto monumente janë:

- |  |                                |
|--|--------------------------------|
| 1. Shpella e Gurit të Kuq,                                 | 20. Liqeni i Madh (Lurë),      |
| 2. Karsti i Malit të Bardhë,                               | 21. Hartinat e Lurës,          |
| 3. Burimi dhe Shpella e Sopanikës,                         | 22. Shllinasi,                 |
| 4. Liqenet e Kasnisë,                                      | 23. Guri i Kërçinit,           |
| 5. Pasqyrat e Gramës,                                      | 24. Krasta e Pocestit,         |
| 6. Gropa e Panairit,                                       | 25. Boroviku i Begjuncit,      |
| 7. Liqeni i Zi (mbi Radomirë),                             | 26. Burimet e Bellovës,        |
| 8. Ujëvara e Pocestës (Maqellarë),                         | 27. Gryka e Madhe, Lurë,       |
| 9. Bjeshka e Zonjave, Zimur,                               | 28. Rrafshi i Korabit,         |
| 10. Gryka e Setës (pjesa më e ngushtë<br>dhe më e thellë), | 29. Morenat e Fushëlurës,      |
| 11. Shpella e Rusit (Grykë-Nokë),                          | 30. Cirku i Kurorës së Lurës,  |
| 12. Shpella e Qytezës,                                     | 31. Kodra e Parave, Blliçe,    |
| 13. Shpella e Akullit – Bulaç,                             | 32. Fusha e Pelave – Lurë,     |
| 14. Burimi i Ujit të Ftohtë, Vleshë,                       | 33. Rrapi i Kërçishtit,        |
| 15. Burimi i Kërçinit,                                     | 34. Pisha e Blliçes,           |
| 16. Kroj i Mbretit – Serakol,                              | 35. Ahu i Blliçes,             |
| 17. Burimi termomineral i Llixhave të<br>Peshkopisë,       | 36. Lisi i Dobit,              |
| 18. Liqeni i Luleve (Lurë),                                | 37. Vakufi i çangës,           |
| 19. Liqeni i Zi (Lurë),                                    | 38. Lisi Kabe,                 |
|  | 39. Vakufi i Sinës së Sipërmë, |
|  | 40. Rrobulli i Lurës,          |

#### 41. Rrapi i Çidhnës

Zonat e mbrojtura, monumentet e natyrës e të kulturës në kufij me liqenin e Fierzës janë:

- Parku Natyror Korab-Koritnik,
- Monumentet e natyrës:
  - Ekosistemi ligatinor Kënetë e Kashtës,
  - Ahishta e Liqenit të Kuq,
  - Pisha e Gjinajve,
  - Pisha e Gjegjanit,

Në veçanti, zonat e mbrojtura te Dibrës mbulojnë sipërfaqet e mëposhtme:

Lura	Park Kombëtar	kategoria II	shpallur me VKM Nr.96. date 21.11.1966
Vlashaj	Monument natyre	kategoria III	shpallur me VKM Nr.102, date 15.01.1996
Korab-Kornitnik	Rezervat Natyror i Menaxhuar	kategoria IV	shpallur me VKM Nr.898, date 21.12.2011
Luzni-Bulace	Zone e Mbrotjur e Burimeve Natyre	kategoria VI	shpallur me VKM Nr.15.01.1996
Bjeshka e Oroshit	Zone e Mbrotjur e Burimeve Natyre	kategoria VI	shpallur me VKM Nr.15.01.1996

#### Lista e monumenteve te natyres si me poshte

N.	Monumente Natyre
1	Kanion, gryke, ure shkembore
2	Shpelle karstike
3	Kanion, gryke, ure shkembore
4	Burim
5	Dru, grup druresh, habitate e
6	Dru, grup druresh, habitate e
7	Cirk akullnajor
8	Dru, grup druresh, habitate e
9	Liqen akullnajor-Zi
10	Liqen akullnajor-Hotit
11	Liqen akullnajor-Madh
12	Liqen akullnajor-Lopeve
13	Morene akullnajore, depozitime
14	Kanion, gryke, ure shkembore
15	Dru, grup druresh, habitate e
16	Shpelle karstike
17	Dru, grup druresh, habitate e

18	Shpelle karstike
19	Dru, grup druresh, habitate e
20	Liqen akullnajor
21	Dru, grup druresh, habitate e
22	Dru, grup druresh, habitate e
23	Dru, grup druresh, habitate e
24	Ujevare
25	Burim
26	Gur, shkemb me forme karakteri
27	Burim termomineral me avull
28	Burim
29	Shpelle karstike
30	Dru, grup druresh, habitate e
31	Lugine e lugje akullnajore e k
32	Dru, grup druresh, habitate e
33	Maje, koder
34	Dru, grup druresh, habitate e
35	Burim

36	Dru, grup druresh, habitate e
37	Dru, grup druresh, habitate e
38	Burim
39	Peizazh karstik
40	Rrase, pasqyre shkembore
41	Rrase, pasqyre shkembore
42	Burim
43	Cirk akullnajor
44	Lugine e lugje akullnajore e k
45	Burim
46	Liqen akullnajor
47	Liqen akullnajor
48	Liqen akullnajor-Kallabekës
49	Fusha e Pelave
50	Liqen akullnajor-Luleve
51	Liqen akullnajor-Thate
52	Liqen akullnajor-Thate

53	Liqen akullnajor-Rrasave
54	Liqen akullnajor-Rrasave
55	Liqen akullnajor-Tushes
56	Liqen akullnajor-Madh2
57	Liqen akullnajor-Madhe3
58	Liqen akullnajor
59	Liqen akullnajor-Kolo Madhit
60	Kanioni Setes
61	Burim
62	Burim
63	Kanion-Setes
64	Kanion-Setes
65	Kanion-Setes
66	Kanion-Setes
67	Kanion-Setes

Më poshtë problemet kryesore që hasen në sistemin natyror të përshkruar në draft Strategjine e territorit te Dibres.

Problematika mjedisore në zonën e Dibrës lidhet më së shumti me menaxhimin e mbetjeve, biodiversitetin (mbrotjen e florës dhe faunës), erozionin, zjarret, etj.

Problemi më i madh mjedisor në Dibër është prerja e pyjeve të larta, sidomos ato të Parkut Kombëtar të Lurës dhe maleve të Selishtës, në Prat, Kacni, Lukan, etj. Masivë të tërë me pyje të larta janë masakruar nga prerjet pa kriter, pa studim, pa cilësi dhe në sasi të mëdha. Prerjet janë kryer më tepër për lëndë drusore ndërtimi, industri dhe lëndë djegëse. Mendohet se janë më shumë se 1,500 ha pyje të larta të dëmtuara në territorin e Dibrës, duke na lënë kështu një masakër mjedisore dhe pyjore, e cila kërkon vite dhe masa të shumta shtrënguese për rigjenerimin dhe kthimin në situatën e mëparshme.

Erozioni vepron në kundërshti me ekuilibrin natyror të ekosistemave. Nevojitet një kohë shumë e gjatë për të kompensuar humbjen e lëndës, të shkaktuar nga erozioni për një kohë fare të shkurtër.

Faktorët që përcaktojnë erozionin në zonën e Dibrës renditen si më poshtë:

- Relievi/pjerrësia: konfigurimi i terrenit dhe pjerrësia janë një faktor bazë në përcaktimin e rrezikut potencial të erozionit. Shumica e përrrenjve në Dibër janë të rrëmbyeshëm dhe terreni është i pjerrët. Kështu, kemi rrezik dhe ngjarje erozioni në Gjelagjosh (zhavorizimi i fushës së Kubenit), te Përroi i Gramës, Përroi i Veleshicës, Përroi i Dohoshishtit, Përroi i Kusares, Përroi i Arrë-Mollës, etj.

- Faktorët klimatikë: reshjet dhe temperaturat, që të konvertuara në indeksin Fourier dhe indeksin Bagnouls - Gaussen përcaktojnë potencialin e klimës për të stimuluar erozionin e tokës në një rajon të caktuar.
- Faktorët tokësorë: tekstura, thellësia e tokës dhe përmbajtja e gurëve, që përcaktojnë erodibilitetin e tokës, ose aftësinë e saj për t'u shkëputur, transportuar dhe depozituar gjatë procesit të erozionit.
- Vegjetacioni: vlerësimi i shkallës së mbulesës bimore si faktor frenues për erozionin, që njëkohësisht bën lidhjen mes rrezikut potencial dhe erozionit. Zhveshja nga bimësia e shpateve të maleve, nga ku dhe e kanë burimin ujërat, e favorizon erozionin.
- Faktori njerëzor: duhet përmendur që ky faktor mund të ndikojë potencialisht në të dy drejtimet, për mirë dhe për keq. Fatkeqësisht ndërhyrjet njerëzore përgjithësisht kanë rënduar situatën e erozionit në vend.

Vlerat e këtyre faktorëve në kushtet e territorit të Dibrës favorizojnë potencialisht nivelin e lartë të erozionit të tokës. Të dhënat teorike tregojnë se në rreth 45% të tokave bujqësore rreziku potencial është mesatar, ndërsa në rreth 55% të tokave rreziku është i lartë. Relievi i thyer, reshjet, dëmtimi i vegjetacionit natyror, braktisia e tokave bujqësore, etj., ngelen faktorë që nxisin proceset e shkarjeve dhe shembjeve të tokës. Faktorët më kryesorë që ndikojnë në shkarjet e tokës janë:

- mosmenaxhimi i ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore;
- mbikullotja në zonat me bimësi livadhore ;
- reshjet me sasi relativisht të larta;
- ndërtimi hidrogjeologjik i shtresave të tokës;
- sipërfaqet e tokave të rrëshqitura në vitin 2014 rezultojnë të kenë të njëjtën tendencë krahasuar me vitet më parë.

Për shkak të reshjeve dhe mungesës së menaxhimit të ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore rreziku i shkarjeve të tokës mbetet i lartë.

Një tjetër lloj erozioni është gërryerja e tokës në brigjet e lumenjve dhe përrrenjve. Gjatë viteve të fundit dëmtimet në brigjet e lumenjve kanë ardhur si rezultat i shfrytëzimit të materialeve inerte në shtretërit e lumenjve, i dëmtimit të objekteve mbrojtëse dhe dëmtimit të vegjetacionit përgjatë shtratit të tyre.

Zjarret në pyje kanë shkaktuar dëme të konsiderueshme, duke u shoqëruar me pasoja të mëdha e negative për ekosistemet, si: humbja e biodiversitetit, shkretëtirëzimet, gërryerja e tokës, prishja e rregjimit ujor, por mbi të gjitha, humbja e funksioneve biologjike, të cilat pasohen me humbje të mëdha socialekonomike.

Sipërfaqet e djegura gjatë periudhës 1990-2014 janë të madhësive të ndryshme. Niveli më i lartë u arrit në vitin 2007, me 600 ha pyje. Kjo dukuri negative ka qenë e shtrirë në të gjithë territorin e Parkut të Lurës dhe pjesës së Selishtës. Përveç pyjeve prodhuese, zjarret kanë djegur edhe zona të



mbrojtura, në sipërfaqe të konsiderueshme, duke u humburatyre vlerat dhe rëndësinë që kanë patur. Përsa u përket shkaqeve, në shumicën e rasteve ato nuk kanë qenë natyrore. Temperaturat e larta vetëm kanë favorizuar përhapjen e zjarreve.

Zjarret, në mënyrë të veçantë ato të 10-vjeçarit të fundit, në shumicën e rasteve kanë shërbyer si faza përbyllëse e prerjeve të paligjshme. Ato kanë shërbyer për "zhdukjen e këtyre gjurmëve", në sipërfaqet e shfrytëzuara me dhe pa kontrata, sepse pikërisht këto sipërfaqe janë djegur prej tyre. Kjo mbetet arsyja kryesore për pjesën më të madhe të rasteve, duke konfirmuar shkakun kryesor të tyre, faktorin njeri.

Menaxhimi i mbeturinave është një problem i madh per sistemin natyral. Menaxhimi i mbetjeve në bashkinë Dibër klasifikohet ende në një nivel të ulët. Me sisteme për grumbullimin e mbetjeve është pajisur vetëm qyteti, por jo zonat rurale. Në zonën e Dibrës akses në shërbimin e menaxhimit të mbetjeve kanë vetëm 23.6% e familjeve. Në Peshkopi ndodhet një vend depozitimi i mbetjeve me një kapacitet prej 33 tonësh në ditë dhe kapacitet të plotë rrëth 1,000 ton. Kjo pikë depozitimi është jashtë çdo standardi teknik të një fushe depozitimi. Në zonat rurale si vend depozitim shërbejnë shtratet e lumenjve, duke u kthyer kështu në rrezik për shëndetin e njerëzve dhe peizazhin. Problemet kryesore që lidhen me këtë shërbim janë:

- Sistemet për grumbullimin dhe heqjen e mbetjeve janë të pamjaftueshme dhe joefektive;
- Vendimet për mbledhjen dhe heqjen e tyre nuk mund të ekzekutohen, në mungesë të një informacioni të besueshëm;
- Nuk ka një traditë të mirëfilltë për trajtimin dhe heqjen e mbetjeve;
- Burimet financiare dhe teknike janë të pamjaftueshme;
- Publiku ka mungesë informacioni përsa i përket rrezikut që shkaktohet nga administrimi i dobët i mbetjeve;
- Mungon plani i menaxhimit të mbetjeve;

Nga pikëpamja e florës dhe faunës, zonat më të kërcënuara janë zona e Parkut të Lurës, ku ka prerje masive të pyjeve, gjë që ka ndikuar dhe në habitatin përreth, zona e Pratit në Selishtë dhe disa lloje bimësh mjekësore, që rrezikohen nga vjelja pa kriter, si agulica dhe 32 lloje të tjera bimësh. Më e rrezikuar është situaçia për disa lloje kafshësh, shpendësh dhe gjallesash të tjera, që rrezikojnë zhdukjen, si pasojë e degradimit të mjedisit natyror (pyjeve të prera, ose të djegura), por dhe ndërhyrjes pa kriter nga dora e njeriut. Të rrezikuara janë gjeli i egër, dhia e egër, thellëza, etj. Kërcënimet kryesore ndaj biodiversitetit janë: gjuetia ilegale pa kriter, peshkimi me lëndë plasëse dhe helmuese, erozioni i tokës, energjia dhe minierat, transporti dhe turizmi, zhvillimi industrial, urbanizimi, sektorë këto që kanë ndikim në shumëlojshmërinë biologjike.

Aktivitetet antropogjene, ku përmenden shpyllëzimi dhe lënia djerrë e tokës së punueshme, shkatërrimi i livadheve dhe kullotave kanë pasur një ndikim të madh në ndryshimet e habitateve në të kaluarën e afërt.

Ndërtimi i rrugëve dhe ndryshimet në rrjedhën e ujit, ndotja që vjen nga origjina të ndryshme, zjarret, sëmundjet dhe ndryshimet klimatike janë arsyet e degradimit dhe fragmentimit të habitateve në Dibër.

Mbrojtja e biodiversitetit mund të arrihet vetëm duke pranuar dhe respektuar objektivat dhe parimet e ruajtjes dhe rritjes së zhvillimit të qëndrueshëm në sektorët që lidhen me biodiversitetin. Këta sektorë janë: bujqësia, pylltaria, peshkimi, industria, urbanizimi, transporti dhe turizmi.

Ne perfundim te analizes mundet te rendesim pikat e forta, dobesite , mundesite dhe kercenimet e sektorit Natyror:

#### Anët e Forta

- Prezenca e shumë burimeve natyrore: siperfaqe pyjore, miniera, ujë.
- Potenciali turistik: turizmi lumor dhe malor
- Vlerat historike dhe natyrore, prania e ujërave termale, liqeneve akullnajore, monumenteve arkeologjike dhe kulturore, vendi i lindjes së heroit kombëtar Skënderbeut
- Peisazh agrar me vlera

#### Dobësítë

- Keqperdonimi i burimeve te disponueshme.
- Zona te degraduara mjedisore.
- Shfrytëzimi i ulet i burimeve egzistuese
- Mungesa e njojurive te popullsise mbi nevojën për të menaxhuar në mënyrë adekuate mbeturinat
- Sistemet e grumbullimit dhe menaxhimit të mbeturinave te papershatshem me ndikim në ndotjen e mjedisit
- shfrytëzimi i tepruar i kullotave
- gjueti e paligjshme dhe e pakontrolluar
- Shpyllëzimi i pakontrolluar

#### Mundësítë

- Bujqësia moderne dhe organike.
- Zhvillimi i prodhimit të energjisë hidroelektrike (energji e pastër)
- Zhvillimi i aktiviteteve të lidhura me sistemin e minierave (gips, mermer, krom)

#### Kërcenimet

- Ndotja
- Mungesa e kontrollit mjedisor
- Erozioni dhe shpyllëzimi

#### 4.4 Sistemi Ujor (U)


Rezervuaret kryesore hidrologjike janë paraqitur në tabelën e mëposhtme. Mjedisi ujor është pasuri për këtë territor. Këtu gjenden disa burime ujore sipërfaqësore dhe nëntokësore. Burimi ujor më i madh është Lumi i Drinit të Zi, i cili ka vlera estetike, turistike dhe biologjike për territorin.

Lumi	Gjatesia (km)	Pellgu (km <sup>2</sup> )	Prurja mesatare (m/s)	Moduli i prurjes (1/s/km <sup>2</sup> )	Raporti i prurjes (maks/min)	Mineralizimi (mg/l)
Drini	285	14.173	352	24,8	5,1	257
Matl	115	2.441	103	42,6	9,3	222
Shkumbini	181	2.444	61,5	25,2	13,2	317
Semanî	281	5.649	95,7	16,9	13,7	440
Vjosa	272	6.706	195	29,1	7,2	335

*Gjendja e Mjedisit Raport 2014 (Plani Kombëtar VAS)*

Megjithëse ka këto vlera, ai shfrytëzohet në mënyrë spontane për turizëm në verë dhe shumë pak për sporte ujore. Përdoret edhe për peshkim, por peshkatarët përdorin mjete dëmtuese, si eksploziv, etj.

Për shkak të topografisë malore, përrrenjtë rrjedhin përgjatë kodrave të pjerrëta. Ndryshueshmëria e tyre, vit pas viti është shumë e lartë: rrjedhjet vjetore në vite të thata përbëjnë 1/10 e rrjedhjeve vjetore në vite të lagështa. Shumica e përrrenjve paraqesin modele shumë të çrregullta të rrjedhjes sezionale. Rrjedhjet e lumenjve janë më të larta gjatë dimrit, ose në fillim të pranverës. Pothuajse të gjithë kanë më pak se 10% (dhe nganjëherë, 0 %) të mesatares së tyre të dimrit gjatë stinës së verës. Më shumë burimet ujore përdoren për ujë të pijshëm, në bujqësi për vaditje, si dhe për hidro-energji (tre HEC-e në Lurë dhe dy në Selishtë). Përrrenjtë janë të vështirë për t'u kontrolluar. Dibra është e prirur ndaj erozionit të tokës. Megjithatë ky konsiderohet një fenomen natyror tipik për zonën, pasi përrrenjtë janë malorë me rreshje të shumta dhe me pjerrësi të madhe. Në rastin e Dibrës ky fenomen është thelluar më shumë nga aktivitetet e dorës së njeriut (p.sh: shpyllëzimi). Si pasojë, vërehen sasi të mëdha sedimentesh në shtratin e lumenjve dhe dalje nga shtrati të tyre. Të rrezikshëm janë përroi i Veleshicës, i Blliçes, Gjelagjoshit, Dohoshishtit dhe Kusarres. Përdorimi i pasurive ujore për turizëm dhe hidro-energji ka nisur, por mbetet në hapat fillestare.



Harta hidrografike e Dibres – Burimi: Strategja e territorit të Dibrës

Sistemi i ujit që përfshin liqene dhe lumenj është përdorur kryesisht për energjisë elektrike, bujqësisë dhe furnizimin me ujë problemi kryesor i të cilit është i lidhur me ndotjen si pasojë e shkarkimit të ujit të patrajtuar. Monitorimi i analizave te kryera në vitet e fundit në Shqipëri, tregojnë një ndikim të rëndësishëm në cilësinë e ujit të lumenjve dhe liqeneve. Në mënyrë të veçantë, përveç dëmit të shkaktuar nga shkarkimi i ujërave të zeza të patrajtuara në afërsi të qendrave urbane, ujërat më të ndotura janë në afërsi të burimeve të ndotjes, si zonat industriale, ekzistuese, komplekseve të dikurshme industriale dhe vendeve të minierave dhe të përpunimit mineral. Monitorimi i lumenjve kryesore, duke përfshirë Drinin, eshte bere nga Agjencinë Kombëtare të Mjedisit (AKM), me 34 stacione që përfaqësojnë të gjithë gjatësinë e lumit duke u vendosur në rrjedhën e sipërme, e mesme dhe të poshtme të rrjedhës. Monitorimi e vitit 2014 tregojnë:

- Temperatura mesatare vjetore në ujërat e lumenjve të monitoruara shkon në mes 13,9-20,6 ° C enë përputhje me ndryshimet natyrore sezonale. Pjesa e Sipërme e, mait, karakterizohet nga temperatura të ulëta. Krahasimi i të dhënave të vitit 2013 dhe 2014 tregon se nuk kane ndryshuar temperaturat vjetore te ujit.
- PH e lumenjve është alkaline, me vlera pH midis 7 5-8,3 (norma lejuar <8,5). Lumi Drin është ai që ka normat më të larta të alkalinitetit.
- temperatura vjetore e ujit.

- Shkarkimi i ujërave të ndotura urbane dhe industriale jo te trajtuara në periudhën 2010-2014 çoi në një rritje në nivelin e NBO5, tregues të ndotjes organike. Në veçanti pellgu i Drinit është një nder te cilet rregjistronje vlerat më të larta të NBO5, në krahasim me të gjitha e bacinet e monitoruara në Shqipëri.
- Në lidhje me përbajtjen e amoniakut, për vitin 2014 pellgu i Drinit rezulton të jetë e cilësisë së mirë, së bashku me basene Mat, Shkumbin dhe Vjosë.
- Përbajtja e fosforit rezulton te kanë vlera më të larta në zonat me ujë të ndotur për shkak të shkarkimeve urbane që përbajnjë detergjent me baze fosfori. Baseni i lumit Drin është ende i cilësisë shumë të mirë duke ju referuar vlerave mesatare të fosforit.

Për territorin e Dibres një aspekt veçanërisht i rëndësishëm është ai në lidhje me shitjen e energjisë hidroelektrike, një burim kryesor i të ardhurave të qeverisë që ka një ndikim të drejtpërdrejtë në stabilitetin e taksave.

Ne perfundim te analizes mundet te rendesim pikat e forta, dobesite , mundesite dhe kercenimet e sektorit Ujor:

#### Anët e Forta

- Prania e një rrjeti të dendur ujor nëntokësor dhe sipërfaqësor
- Iumenj malore që ofrojnë energji hidroelektrike dhe janë një burim i ujitjes për bujqësi
- Prania e 6 rezervuareve artificial të ndërtuar ne funksion te bujqësise.

#### Dobësítë

- ndotja e madhe nga derdhjet e patrajuara në rrjedhën e Drinit dhe rrjellave ujore me të vogla
- Mungesa e infrastrukturës adekuate
- Kontroll i ulet i sistemit ujor
- Vështirësítë dhe pengesat në lidhje me shërbimet e kanalizimeve të ujërave të zeza
- Vendndodhja e rrjeteve të kanalizimeve
- Sistemi i dobet i rrjetit te kanalizimeve në zonat informale urbane
- Prurjet të parregullta të ujit sipas stineve
- Rreziku i përbajtjeve sidomos në zonat Veleshicës dhe Bllices

#### Mundësítë

- Territor i pasur me uje
- Mundesite e shfrytëzimit te fuqisë së ujit per prodhimin e energjise.
- Disponueshmëria më e madhe e burimeve hidroelektrike në dimër dhe pranverë ( ne perputhje me sezonin turistik

#### Kercenimet

- Shfrytezimi hidroenergjistik i territorit pa impakt ekonomik ne zone
- Rrezikun e përbajtjeve gjatë periudhave të reshjeve të rënda në dimër / pranverë
- Ka lidhje të shumta informale dhe të paligjshme
- Egzistenca e projekteve të ndryshme që do të mund te bejne ndryshime të mëdha përgjatë

rrjedhës së lumbit Drin, duke përmbytur e zona të mëdha të tokës bujqësore dhe transferimin e një pjese të banorëve.

#### 4.5 Sistemi Bujqesor (B)

Toka në Dibër është e ndarë në: tokë arë 25%, pyje 46%, kullota 17%, pemë frutore 2%, vreshta 1%, tokë e papërdorur 2% dhe tokë e refuzuar (vakufe) 8%. Sipërfaqja e tokës me pyje zë pjesën më të madhe të territorit, me afro 46% dhe bashkë me kullotat, ajo zë 63% të territorit. Më pak sipërfaqe zënë pemëtoret dhe vreshtaria, 1-2%. Kjo e dhënë më shumë u referohet sipërfaqeve ekzistuese.

Toka bujqësore arë zë 25% të sipërfaqes dhe për momentin punohet dhe mbillet me drithëra buke, foragjere, pemë frutore, vreshtari, perime, patate, etj. Sipërfaqja më e madhe mbillet me foragjere dhe drithëra buke, kryesisht për nevojat e blegtorisë dhe të ekonomive familjare. Figura më poshtë jep strukturën e tokës arë të mbjellë me kultura të ndryshme





Figura 2: Struktura e mbjelljeve se tokës arë sipas kulturave bujqësore (Burimi: Burimi: Strategjia e territorit të Dibrës)

Toka e refuzuar zë një sipërfaqe prej 7,531 ha, ose 11.5% (e refuzuar). Kjo sipërfaqe është tokë joproektive dhe e pambjellë. Nga përbërja kjo tokë është shumë e përshtatshme për t'u mbjellë me arrore, ose gështenja.

Mungesa e ujit vaditës të sipërfaqeve të tokës më e dukshme është në Maqellarë, Kastriot dhe territore të tjera. Pengesa kryesore është sistemi vaditës primitiv dhe rrjeti i kanaleve vaditëse,

krejt i amortizuar. Gjatë viteve 1999-2002 pati ndërhyrje për rehabilitimin e kanaleve vaditëse nga projekti IFAD2, por akoma nuk janë bërë ndërhyrje në zonën e Dibrës nga programi i ujitjes me pika, zbatuar nga ministria e Bujqësisë.

Peizazhi dominues në territorin e Dibrës është ai rural, si në aspektin e përdorimit të hapësirave të tokës, në ngastra të vogla dhe me diversitet kultivimi, si në stilin e ndërtimit të fshatrave, tipike e familjeve dhe ekonomive rurale. Peizazhi rural është i ndryshëm. Në të dallohen qartë pjesa e territoreve në zonat malore, ku përdoret guri për ndërtim, rasat për mbulim dhe tokat në ngastra të vogla e të pjerrëta. Dallohen gjithashtu edhe zona fushore me shtëpi të mëdha që kanë oborre të mbjella me pemë frutore, tokat e sistemuara të mbjella me drithëra, foragjere dhe pemë frutore. Kjo gjë konsiderohet një aset shumë tërheqës për vizitorët dhe turistët, që janë të interesuar për turizmin rural. Ky peizazh, shumë pak është shfrytëzuar për turizëm.



Aktualisht ujitja e tokave bujqësore në bashkinë e Dibrës, nga Ura e Topojanit deri në Urën e Dodës në drejtim të rrjedhës së lumbit Drin i Zi (kufijtë natyrorë), realizohet kryesisht me:

- kanale ujitëse, që sigurojnë prurje vetëm nga marrja e ujit nga perrenjtë dhe burimet natyrore;
- ujëmbledhësat, të ndërtuar pas viteve 1960;
- ujitja me ngritje mekanike, që është braktisur plotësisht.

Marrja e ujit nga rezervuaret kryesore ka qenë një teknologji e përdorur pas viteve 1960, kohë kur u ndërtuan një sërë veprash ujëmbledhëse për ujitje, por që u përdorën edhe për peshkim. Vitet e fundit, në vendet e EU-së kjo metodë përdoret si instrument për projektet e ndryshimeve

klimaterike. Me kalimin e funksionit të ujitjes bashkisë duhet patjetër që stafi i ri të ketë një studim të plotë për inventarizimin e veprave ujítëse. Ky staf duhet të ketë edhe një plan menaxhimi, në bashkëpunim me komisionet dhe shoqatat e menaxhimit të kanaleve ujítëse në ato zona ku ato janë ngritur nga programi IFAD2.

**Problematikat kryesore:**

- Frangmentarizimi i madh i tokës e cila rrit koston e shërbimeve, ul fitimin, dëmton cilësinë dhe sasinë e prodhimit, vështirëson aksesin e prodhuesve në treg dhe pengon investimet në këtë sektor;
- Mungesa e aftësisë për të bashkëpunuar dhe kooperuar mes fermerëve. Nuk ka një fushatë informimi dhe nxitje të fermerëve drej formave kooperative te bashkepunimit;
- Mungesa e konsorceve rajonale dhe strukturave te tjera private apo qeveritare per te rritur aksesin ne treg nepermjet, markave, pikat e grumbullimit, dyqanet e shitjeve, promocionit që produktet bujqësore Dibrane të kenë markën dhe linjën e tyre të tregut;
- Mungese e kontrollit dhe e informimit ne perdorimin e pesticideve dhe helmeve;
- Mungesa e studimeve dhe orientimeve të fermerëve për të kaluar nga bujqësia tradicionale dhe primitive në bujqësinë intensive dhe të integruar;
- Diversikimi i lartë i produkteve, duke bërë që familjet fermere dhe grupet prodhuese të merren me kultivimin e shumë kulturave që nuk jepin rendimet dhe norma e fitimit është e vogël; Mungesa e kapaciteteve dhe specialistëve për numr të fermerëve dhe mungesa e njoftes dhe adaptimit të njofturive, teknikave te reja në bujqësi;
- Mungesën e aftësive për të hartuar plane dhe dosjen e aplikimeve për të thithur investimet në skemën e subvencioneve dhe programeve të tjera që kanë në fokus bujqësinë.

**Propozime:**

- Të bëjë studimin dhe planin e menaxhimit të tokës për kulturat bujqësore më të përshtatshme me klimën dhe përbërjen e tokës dhe nxitjen e fermereve drejt kulturave me vlerë te shtuar dhe rendiment me te larte;
- Krijimi i koperativave ose ndërmarrjeve të bashkëpunimit bujqësorë për uljen e kostos së prodhimit dhe rritjen e të ardhurave;
- Nderhyrje per permirsimin në infatsrukturën bujqësore për vaditje ,kanale, ujëmbledhësdhe rrugë;
- Krijimi i qendrave të grumbullimit bujqësorë që nga magazinimi, tregu, kontrolli i cilësisë deri tek shërbimet bujqësore;

- Zhvillimi i zinxhirit të vlerës për produktet bujqësore të dibrës duke kriuar markën lokale, qendra të specializuara teknike që merren me kontrollin e cilësisë dhe rrjetin e dyqaneve në tregun vendas;
- Zhvillimi i zinxhirit te nënproduktit dhe produktit bujqësor nga fidanishtja deri tek përpunimi.
- Shtimi i investimeve ne sektorin e agro-përpunimit të përshtatshme me kapacitetin prodhues të zonës, dhe cilësi të lartë të prodhimit;
- Shtimi i numrit të specialistëve të bujqësisë si në drejtorinë e Bujqësisë por dhe në pushtetin local.

**Ne perfundim te analizes mundet te rendesim pikat e forta, dobesite , mundesite dhe kercenimet e sektorit Bujqesor:**

#### Anët e Forta

- Klima të përshtatshme për zhvillimin e bujqësisë;
- Kosto e lire e krahut te punes;
- Imazhi pozitiv i produkteve bujqësore i bën ato konkurrues në tregun kombëtar
- Prania e krahut te lire te punes ,mundesa e suvencioneve dhe i kthimit te investimit.

#### Dobësitë

- Mungesa e konkurrencës (sasisë së prodhuar dhe çmimi i lartë) që lidhet me madhësinë e vogël të fermave.
- Mungesa e pikave te mbledhjes
- Mungesa e bashkepunimit ndermjes prodhuesve.
- Mungesa e mbeshtetjes institucionale per aksesimin e fondeve
- Mungesa e një marke Diber,
- Mungesa e infrastrukturës mbeshtetese.

#### Mundësítë

- Zhvillimi i blegtorisë, veçanërisht në zonen malore dhe kodrinore,
- Rritja e prodhimit
- Zhvillimi i bujqësisë duke dhene rendesi veçanërisht frutoreve
- Diversifikimin e aktiviteteve përmes futjes së turizmit rural, lidhur me brigjet përgjatë rrjedhave ujore dhe shfrytezueshmerine.

#### Kërcenimet

- Madhësia e vogël e fermave, një pengesë për rritjen e produktivitetit dhe konkurueshmërisë
- Përdorimi i pakontrolluar i pesticideve
- Kërcenimet ndaj cilësisë së produkteve si rezultat i ndotjes se tokës dhe ujit.
- Aplikimi i praktikave jotepershtatshme për mjedisin

#### 4.6 Tema emergjente dhe çeshtje te evidentuara

Ne menyre te veçante, mund te behen vleresimet e para te pergjithshme, duke i kaluar me pas ne pershkrimet specifike per cdo sektor perpunimet e bashkangjitura.

- a) Situata administrative ne teresine e saj eshte perceptuar dhe ka nisur. Ashtu si te gjitha reformat, edhe kjo eshte ende ne faze eksperimentale, sepse implikon gjithashtu dhe nje ndryshim kulturor e strukturor. Transformimi nga 15-20 komuna ne nje Krye-Komune te perbashket nenkupton implikon nje teresi dorezimesh mes ish-komunave te ndryshme me nje zbatim jo te lehte.
- b) Behet fjalë per kalimin nga qeverisja e nje territori prej disa dhjetra km katrore ne nje siperfaqe prej mbi 900 km katrore per te dy vendet se bashku.
- c) Reforma duhet te parashikoje me tutje hapa te tjera te rendesishme, te tilla si percaktimin e pergjegjesive ne lidhje me sektoret dhe çeshtjet te rendesishme.
- d) Per shembull, percaktimi i pronesise se tokes pyjore dhe shfrytezimin e tij per qellime agro-pylltarie dhe te ekonomise turistike.
- e) Ose percaktimin e shfrytezimit te burimeve hidroenergetike, tanime prerogative e pushtetit qendror, pa ndonje ndikim ne zonen lokale, nga ku dhe eshte marre. Shqetesim vecanerisht i madh nga komuniteti i Kukesit qe me centrali e saj prodhon energji per pjesen me te madhe te shtetit, dhe ku kompanieve private u eshte lejuar mundesia e shfrytezimit te burimeve me investimet e tyre, por qe ne fakt ky ndikim financiar nuk kthehet ne vendin qe i ka prodhuar.
- f) Haset akoma nje ekonomi e dobet qe ka pare shume prej forcave rimore e sipermanrese te punes te emigrojne drejt kryeqytetit apo qyteteve me te pasura bregdetare dhe me te perpunduese mundesi punesimi dhe investimi. Kjo dobesi eshte ndihet veçanerisht ne Peshkopi.
- g) Haset akoma nje qendrese e forte ne sektorin bujqesor e cila ka zevendesuar vetem pjeserisht ate mbizoteruese (ose ekskluzive) me vlere publike. Kalimi nga ekonomia shterore-publike ne ate private ka pasuar mylljen e qendrave te grumbullimit dhe perpunimit te prodhimeve bujqesore qe ishin qeverisur nga bota e bashkepunimit te shteteror. (Peshkopi)
- h) menyre analogjike ne fushen e resurseve minerale, me te cilat e gjithe zona (e Kukesit) eshte shume e pasur, me renien e sistemit komunist edhe keto pesuan nje braktisje qe nuk eshte kompesuar nga hyrja e investimeve te huaja apo te sipermanrejeve lokale.
- i) Nje perqindje e mire e popullsise se mbetur fokusohet ne bizneset e vogla te cilat ne vetvete kontribuojne ne nje integrim te te ardhurave

- j) Sektori i ndertimit mbahet ende ne kembe, edhe pse haset ne kerkesa te uleta per strehim shkaktuar nga renia e numrit te popullsise prej emigracionit. Kerkesa mbizoteresue eshte ajo e mundesise se realizimit te baneses private me vetendertim mbi token vetjake te njojur sit e tille pas renies se sistemit komunist. Ne numer te pakte hasen disa iniciativa ndertimi te tipologjise se pallatit. Ato pak te ndertuara kohet e fundit kane mbetur pjeserisht te pabanuara.
- k) Ndertimet Publike trasheguar nga regjimi paraardhes jane ne faza braktisjeje e kundrejt kushteve me te keqja. Ajo qe duhet bere eshte parashikimi i operacioneve ndaj pasurive te patundshme per rigjenerimin urban me prishje dhe rindertime.
- l) Gjendja e infrastruktures rrugore eshte e dobet. Mirembajtja eshte e manget per shkak te mungeses se burimeve si dhe per menaxhimin e atyre ekzistuese si nga autoritetet shteterore ashtu dhe nga kompetencat lokale. E vetrnja arterie e rendesishme dhe ne gjendje mjaft te mire mirembajtjeje eshte autostrada me 4 korsi qe lidh Kryeqytetin Tiranen me Kukesin e me tutje me kufirin me Kosoven dhe kryeqytetin e saj. Per tu lidhur me Peshkopine rruga shteterore ende ka segmente te medha te lena pas dore dhe jo te mirembajtura. Nje trakt ne ndertim, dhene ne koncesion nje investitori te huaj (Kinez) nuk ka perfunduar akoma dhe ne kantier puna eshte ndaluar. Rruget me rendesi komunale si brenda qytetit ashtu dhe ato te lidhjeve nder qytete jane te keq-mbajtura. Hasen ne shkalle te madhe prania e segmenteve te rrugeve te paasfaltuara, me gropi apo me rreshqitje te dheut. Shenjat rrugore mungojne dhe / ose jane te paqarta.
- m) Edhe pse perballle ketyre çeshtjeve kritike, gjenden ende mundesi interesante qe mund te shfrytezohen dhe qe mund te perbejne gjithashtu perkufizimin e pare te nje projektimi programator ekonomik dhe urbansitiko-territorial.
- n) Kryesisht burimi ekologjik\_ Keto territore jane te pasura me burime dhe bukuri natyrore. Zonat pyjore zene reth 60-70% te territorit. Haset gjithashtu prania e nje sistemi ujor te rendesishem, lumenj dhe liqenet qe jane te pranishme per te dy vendet, Kukesin dhe Dibren. Ne keto zona mund te perqendrohen projekte specifike per sektorin e turizmit.
- o) Sektorit ambiental i eshte lidhur sektori i bukurive arkitektonike dhe ai i pranise si te te mirave monumentale te njoitura, ashtu dhe te nje arkitekture deshmuese historike qe shpreh nje identitet dhe nje komunitet lokal.
- p) Sektori bujqesor mund te zhvillohet me promovimin e produkteve lokale (geshtenja, molle, patate etj.) qe shfaqin persosshmeri.
- q) Sektori i minierave duhet te rishqyrtohet teresisht ne perpjekje per te terhequr investimet e huaja.

- r) Sektori i sherbimeve me perdonim publik, mund te jete nga ana e vet nje force levizese ne punesimin e te rinjve per t'l mbajtur ne vend. Riorganizimi administrativ eshte gjithashtu nje mundesi per te favorizuar nje profesion universitar adekuat per ndryshimin e klasses se punetoreve te vjeter ne prag te daljes ne pension dhe qe lidhen me strukturen e meparshme organizative.

## 5 VIZIONI DHE STRATEGJIA TERRITORIALE

Pershkrimi i strategjise territoriale eshte i ndare ne dy seksione:

Strategjia e territoriale insediative që integron ne menyre transversale disa elemente kyçë që dalin nga leximi i territorit në 5 sistemeve territoriale (UB, NË, N, U, B);

Objektivat dhe veprimet te ndara sipas pesë sistemeve te përmendura, me qartesine që nuk behet fjale per sektorë te izoluar dhe te pavarur, por të ndërlidhura ngushtë me njeri tjetrin në të cilin zhvillimi i çdo sistemi individual drejton dhe është drejtuar nga të tjerët.

Këto elemente të vijnë së bashku në formulimin e një vizioni rajonal që, duke filluar nga analiza e mësipërme SWOT, shpreh objektivin kryesor drejt të cilit orjentohen ndryshimet e viteve të ardhshme. Strategjia territoriale bazohet edhe në kerkesat zhvillimore derivuesë nga Plani Kombëtar, përshkruar në paragrafin e mëposhtem.

### **5.1 Parashikimet e detyrueshme te planit kombëtar te integruar ne strategji territorial**

Strategjia territoriale e Dibrës, përfshin brenda saj parashikimet zhvillimore të përcaktuara apo të sugjeruara nga Plani Kombëtar.

Vendndodhja e vaj kufitare me Maqedoninë e Kosoven, paraqet një mundësi shumë të rëndësishme në aspektin ekonomik. Rajonet ndërkufitare në fakt, në sajë të politikës së kohezionit të Bashkimit Evropian, janë të prekur nga fondet e IPA Ndërkufitare, që për 2014-2020 do ti japë Shqipërisë 75 milionë € të ndara në:


- - rreth 42 milionë euro për projektet Shqipëri-Greqi
- - rreth 12 milionë euro për projektet Shqipëri-Mal I Zi
- - rreth 12 milionë euro për projektet Shqipëri-Maqedoni
- - rreth 8,5 milionë euro për projektet Shqipëri-Kosove.

Këto fonde janë të lidhur me projekte në fushën e ekonomise, infrastrukturës, trashegimisë natyrore, historike e kulturore, shëndetësisë, arsimit dhe kulturës. Parashikimet strategjike të planit nxjerrin në pah aksin ndërkufitare me Maqedoninë i ndodhur mes Dibrës dhe Gostivarit.

Një tjetër input i rëndësishëm i Planit Kombëtar është të inkuadroje Dibren si qendër specializimi për sektorin e turizmit, lidhur me zonat e mbrojtura (qëndrat turistike të Lurë dhe Luzni-Bulac), të lidhur me Dibren nga rrugë interurbane kryesore dhe dytësore, me të cilat kombinohen "itinerare të veçanta lidhese", ndër të cilat ajo drejt Krujës (dhe nga atje për në Tiranë) është një projekt i parashikuar i Planit të përgjithshëm kombëtar.

Nga pikepamja e infrastrukturës:

- Faktori më i rëndësishëm është lidhja me Korridorin VIII, përmes ndërtimit të rrugës së arbërit, qe do të lejojë një përmirësim të ndjeshëm të lidhjeve kombëtare dhe ndërkontinentale drejt Shkupit, Sofjes, Stambollit. Korridori që ndikon në kalimin e rrugës së arbit gjithashtu paraqet një mundësi për kalimin e infrastrukturave të rëndësishme të energjitike dhe forcimin e korridoreve ekologjike;
- Për sa i përket infrastrukturave energjítike, korridori I destinuar për realizimin e rrugës për Arbërit, përfshin edhe parashikimin e gazsjellesit Tiranë-Dibër siç tregohet në vijim



Nga pikepamja ambientale, strategjia territoriale reflekton dhe përfshin në brendësi të strategisë së vendndodhjeve, vlerësimin e potencialit të turizmit në territorin e Dibrës pale pranisë së zonave të mëdha të mbrojtura përgjatë kufirit, të cilave në planin e përgjithshëm, u është lidhur identifikimi i zonave prioritare për zhvillimin e turizmit; gjithashtu është e rëndësishme prania e një korridori lumor dhe pyjesh, si dhe me sisteme kompleksë të kultivimit në afërsi të qëndrave urbane dhe përgjatë rrjedhave ujore. Në veçanti, është identifikuar kalimi i Brezit te Gjelbër

Evropian, një lidhje e rëndësishme ekologjike, një nga akset e rrjetit ekologjik Pan-Evropian, ndërtimi i të cilit është bazuar në praninë e zonave të mëdha natyrore që u zhvilluan në mungesë të aktiviteteve antropogjene. Gjithashtu e rëndësishme është dhe çështja e ndërlidhjeve dhe marrëdhënieve mes qëndrave të mëdha, të specializuara dhe lokale: Dibra duket së lidhet kryesisht me Kukësin, dhe së dyti me Matin, Bulqizen dhe Librazhdin (respektivisht në përrëndim, jug-përrëndim dhe jug). E rëndësishme është marrëdhënia me qendrën maqedonasë të gostivarit (e nga aty me Tetovën dhe Skupin).

## 5.2 Vizioni i te ardhmes per Dibren

Në përputhje me udhëzimet e dhëna nga Plani Kombëtar, strategjia është e bazuar në një vizion të Kukësit si Porta e verilindjes të vendit, në qendër të marrëdhënieve ndër-kufitare, duke pasur parasysh afërsinë e saj me Kosovën dhe aksin e përcaktuar në mes të Kukësit dhe Prizrenit, dhe me tej me Prishtinën. Potenciali i Kukësit si një qendër multimodale për statusin rajonal, kombëtar dhe në nivel ndërkombëtar është përcaktuar edhe me praninë e aeroportit dhe autostradës Durrës-Tiranë-Kosovë. Në përputhje me udhëzimet e dhëna nga Planin Kombëtar, strategjia është e bazuar në një vizion per Dibrën, si një qendër të specializuar në turizëm, duke pasur parasysh numrin e madh të burimeve natyrore, mjedisore dhe kulturore që disponon.

Vizioni në të cilin bazohet strategjia territoriale e Dibrës ka në veçanti arritjen e njëcilesie më të mirë jetësë për popullsinë rezidente, me qasje më të madhe në shërbimet publike për të gjitha shtresat sociale dhe me mundësi më të mira punësimi përmes zhvillimit të potencialeve në fushën e bujqësisë, turizmit, natyres dhe energjisë.

Nisur nga ky vizion dhe përmes ripërpunimit te Analizes SWOT, u përcaktuan 4 objektiva strategjike qe veprojnë në mënyrë të integruar me strategjinë e vendndodhjeve

### Objetivi Strategjik 1 - Një cilësi më e mirë banimi në territorin e Dibres

Kjo linjë e ndërhyrjes referohet në mënyrë të veçantë ne Sistemin Urban dhe Strategjine e Vendbanimeve dhe ka si fokus zhvillimin policentrik të bazuar në forcimin e hierarkisë se sistemeve urbane. Në veçanti tenton që të permiresoje cilësinë urbane në aspektin fizik, me ndërhyrje kualifikimi dhe përmirësimi te tesutit urban, si dhe përmirësimi te cilësisë dhe sasisë se shërbimeve bazë dhe në këtë mënyrë rritjen e numrit të vendbanimeve që aksesojne në shërbimet themelore të tilla si transporti, ujësjellësi, kanalizimet. Kjo linjë veprimi gjithashtu ndikon në temën e banesave informale dhe sociale.

## Objetivi Strategjik 2 - Aksesi më i mirë e ne zonen e brendshme të Dibres dhe vleresimi i lidhjeve ndër-rajionale dhe ndërkufitare

Cështja e aksesibilitetit është në fakt e lidhur me infrastrukturizimin e zonës dhe konsiston në: lëvizshmërinë e ngadalte duke krijuar rrugët dhe itineraret që ndikojnë në shfrytezimin e potencialeve turistike (shih sistemin natyror); transportit publik me racionalizimin dhe përmirësimin e shërbimit të mobilitetit publik lokal dhe lidhjen midis Dibres dhe pjesës tjetër të nivelit rajonal dhe kombëtar; qasja fizike që matet nga infrastrukturat e mëdha (rruga e Arberit), rrjetit rrugor sekondar qe ka nevoje per masa të rëndësishme për tu përshtatur dhe përmirësuar.

## Objetivi Strategjik 3 - Shfrytëzimi i qëndrueshëm i burimeve mjedisore si në aspektin e turizmit ashtu dhe te energjisë dhe minierave

Kjo linjë e nderhyrjes i referohet kryesisht sistemit natyror dhe sistemit te ujrate. Tema qendrore është te optimizoje në mënyrë të qëndrueshme potencialin ekonomik të burimeve në zonë: nga njëra anë për të rritur turizmin përmes një oferte të organizuar në bazë të trashëgimisë mjedisore, peizazhit dhe kulturës ne territor, në anën tjetër per të shfrytëzuar burimet ujore në aspektin e prodhimit te energjisë si dhe burimeve minerare të përhapura.

## Objetivi Strategjik 4 - Vleresimi i zinxhirit të prodhimit lokal

Vleresimi i zinxhirit të prodhimit lokal i cili, duke u bazuar ne sistemin e bujqësisë dhe ate artizanal lokal, ngrë nevojën për të kombinuar njohuritë tradicionale me egzigjencat e inovacionit të modeleve të prodhimit dhe infrastrukturave të lidhura me to në mënyrë që të janë në treg në kushte konkurruese. Në zonen e Dibres ka burime territoriale, por edhe profesionale, qe duhen rizbuluar në mënyrë që të rrisin traditat dhe njohuritë lokale. Nga ana tjetër janë te nevojshem edhe proceset inovative, të cilat nuk janë të lidhura domosdoshmërisht me produktet, por me mënyrën në të cilën këto produkte prodhohen dhe tregtohen. Nevoja është nga njera anë për të koordinuar dhe të integruar kompanitë / forcuar shërbimet e kompanive dhe nga ana tjeter për të bërë produktet të njohur dhe kualifikuar. Inovacioni dhe promovimi i sistemit të prodhimit, mund të luajë një rol edhe aktivizimin e marrëdhënieve me qendrat e mësimit / hulumtimeve / universiteteve edhe jashtë territorit.

Duke u nisur nga vizioni dhe nga objektivat strategjike është përcaktuar strategja e vendndodhjeve qe përveç së tregon strukturën territoriale, jep dhe udhezime opérative për hapin e ardhshem të preqatitjes së planit Vendor Urban. Vizioni i përgjithshëm prezantohet në diagramin e mëposhtëm

## VIZIONI I TË ARDHMES PËR DIBREN

**PËRMIRËSIMI I CILËSISË SË JETËS SE POPULLSISE REZIDENTE  
NË PËRMJET NJË OASJEJE ME TE MADHE NË SHËRBIME  
PUBLIKE PËR TË GJITHA SHTRESAT SHOQËRORE DHE NJË  
RRITJE TE PUNESIMIT NË SAJË TË ZHVILLIMIT TE  
POTENCIALEVE NË FUSHEN E BUJOËSISE, TURIZMIT, NATYRES  
DHE ENERGIJËS**

Zhvillimi policentriki  
bazuar në forcimin  
hierarkisë se  
sistemeve urbane

**OBJEKTM STRATEGJIK  
1**

Përmirësimi i sistemit  
të akcessit të  
brendshëm dhe  
vlerësimi i lidhjeve  
nëdër-rajionale dhe  
nëdërkufitarë

**OBJEKTM STRATEGJIK  
2**

Zhvillimi i  
qëndrueshëm  
burimeve natyrore në  
fushat e turizmit,  
energjisë dhe  
minierave

**OBJEKTM STRATEGJIK  
3**

Vlerësimi i zinxhirit të  
prodhimit vendor,  
bazuar në sektorin e  
bujqësisë dhe  
zejtari

**OBJEKTM STRATEGJIK  
4**

## STRATEGJIA URBANE DHE TERRITORIALE E VENDNDODHJEVE



**PPV**

### 5.2.1 Objktivi Strategik 1 - Një cilësi e mirë e jetesës në territorin e Dibër

Cilësia urbane dhe rajonale i referohet kryesisht cilësisë se jetës së atyre që banojnë në territorin e Dibres, do të thotë i kushton vëmendje pjesëve të ndryshme të territorit dhe marrëdhënieve në mes të sistemeve të ndryshme që e përbëjnë atë: të maleve dhe luginave, zonave urbane dhe fshatrave, poleve qendrore dhe zonave më marginale.

Qendrat kryesore dhe fshatrat me te vegjel nga të cilat karakterizohet territori duhet të bëhen vende të socializimit dhe të ofrimit të shërbimeve bazë. Duehen vlerësuar rrugët dhe vendet publike si vende takimi dhe konfrontimit.

Dimensionet e cilësisë së jetës janë të lidhura ngushtë me komponentët e tjera si ato ekonomike, infrastrukturore, sociale, mjedisore. Cilësia urbane dhe mjedisore nuk lidhet vetëm me aspektet materiale / fizike të qytetit dhe te territorit, por përfshin të gjithë sferën jomateriale te lidhur me mirëqenien lokale. Ajo përshtatet në këtë aspekt me masen e ndryshimeve demografike te


lidhura veçanërisht me probleme të mëdha sociale, me shpopullimin e territorit dhe shërbimeve të shperndara me karakter inkluziv dhe social. Në të njëjtën kohë merr rol qendoror dhe ofrimi i shërbimeve dhe hapësirave për të rinjtë, me qëllim jo vetëm të ofrojë mundësi për brezin e ri, por edhe për te jetuar dhe shijuar territorin në menyre të përgjegjëshme, të vetëdijshëme dhe të motivuar. Ne sinteze mund te themi qe tema i perket.


Hapësira urbane, në kuptimin e evolucionit urban, te gjendjes së ndërtesave, pajisjeve dhe sistemit te parkimit, arredimit urban dhe gjelbërimit publik; shërbime individuale (kopshtet e fëmijëve, kujdesin për njerëzit, rrjetet e kujdesit) dhe për kohën e lirë.

Indikatoret krye janë pra :

- forcimi i rolit të Dibres si qendër kryesore e funksioneve rangut rajonal;
- fuqizimi i lokaliteteve kryesore per te permblushur kërkesen per shërbime afersie
- kualifikimi i shërbimeve baze ne lokalitetet me te vogla /fshatra

Diagrama e mëposhtëme tregon strategjinë për sistemin urban që rrjedh nga analiza SWOT dhe përpunimi i elementeve të përkruara më sipër:





**Figura 3: Sistemi Urban**

	Zhvillimi i sherbimeve ne zonen urbane te Peshkopi		Aeroporti i pashfrytezuar per tu vieresuar
	Izokron- brenda 15 minutave nga Peshkopi		Gendrat urbane kryesore per tu vieresuar
	Izokron- rreth 15 - 30 minuta nga Peshkopi		Gendrat e vogla
	Izokron- rreth 30 - 45 minuta nga Peshkopi		Gendrat dyesore
	Izokron- rreth 45- 60 minuta nga Peshkopi		
	Izokron- me shume se nje ore nga Peshkopi		
	Zonat me perqendrim me te madh te ndertimeve		
	Zona e zhvillimit turistik		Vieresimi i qendres nga pikepamja turistike
	Lidhjet kryesore infrastrukturore		Shtimin e sherbimeve per popullsine ( shkolla , ambulanca, spitale, kopeshte, cerdhe)
	Itineraret panoramik dhe turistik per tu zhvilluar		Korridori lumenor
	Linjat hekurudhere Tirane – Kosove ne projekt		
	Lidhjet rugore per tu permiresuar - çeshtje prioritare		
	Lidhjet rugore per tu permiresuar ne nje faze te dyte		
	Rruget per tu asfaltuar		
	Kufijte – Vieresimi i lidhjeve nderkufitare		

Për cdo program strategjik janë identifikuar veprimë e projekte te qëndrueshme dhe funksionale në arritjen e objktivi strategjik, të cilat do të përshkruhen në shtojcën e bashkangjitur

#### Bashkengjitur.01 - Skedat e Projekteve Strategjike

PROGRAMI STRATEGJK	VEPRIMI	PROJEKTI
1.A Rritja e cilesise urbane te Bashkise Diber	1.A.1 Shtimi i numrit dhe I cilësisë se shërbimeve	1.A.1.1 Permiresimi I objekteve shendetesore rajonale
		1.A.1.2 Rikualifikimin e impianteve sportive
		1.A.1.3 Kualifikimi I objekteve kulturore: Muze, Biblioteke, ...
1.B Vleresimi I zonave bosh/te paperdoruara	1.B.2 Kualifikimi I zonave qendrore	1.B.1.1 Rikualifikimi I bulevardit
		1.B.1.2 Krijimi I qendrave dhe I vendeve te tregtimit ne 5 lagje te Peshkopise
		1.B.1.3 Densifikimin e zonave urbane bosh
		1.B.1.4 Rekuperimin e arkitektures tradicionale dhe i elementeve

		tipik rural
		1.B.1.5 Vleresimi dhe kualifikimi i lagjeve: Teke dhe Kallavere
		1.B.1.6 Baza e nderhyjes se rekuperimit per realizimin e shesheve dhe rrugeve
		1.B.1.7 Rikualifikimin e zones historike
		1.B.1.8 Plani i trafikut urban
		1.B.1.9 Rehabilitimi i ish zones ushtarake
		1.B.1.10 Rehabilitimi i ish zones industriale
		1.B.1.10 Zhvillimi i Peshkopise në juglindje dhe jugperëndim
1.C Minimizimi I abuzivizmit dhe i lagjeve informale	1.C.1 Rritja dhe permiresimi i cilesise se sherbimeve (si 1.1.1)	1.C.1.1. Hedha ne harte e sherbimeve egzistuese( formale dhe informale).
	1.C.2 Plani per ndertimet sociale	1.C.2.1 Ndertimet sociale
	1.C.3 Sistemimi i lagjeve informale.	1.C.3.1 Legalizimi dhe urbanizimi i lagjeve informale

## 5.2.2 Objktivi Strategik 2 – Një akses më i mirë në brendësi të territorit të dibrës dhe vlerësimi i lidhjeve ndër-rajionale dhe ndërkuftare


Tema e aksesibilitetit vjen në një kuptim të gjerë, duke përfshirë si çështjet që lidhen me sistemin e lëvizshmërisë ashtu dhe zhvillimi i rrjeteve të infrastrukturës e tet nenshërbimeve. Çështja e lëvizshmërisë i referohet si asaj ne zonën e brendshme, në mes të qendrave kryesore dhe fshatrave më të vogla, por edhe asaj të jashtme ne një zonë me të gjerë. Temat janë ato të raporteve ndërmjet mënyrave të transportit, sigurisë rrugore dhe implementimin e shërbimeve lokale të transportit publik. Vendosja ndërkuftar i Kukësit është një element force i territorit i aftë te involvoje potencialisht, në sektorët e ndryshme lokale (bujqësore, komerciale, industriale, etj turizmi), përdorues te jashtëm. Në anën tjetër duhet të sigurohet qe lidhja e brendshme, me zonat më të marginalizuara dhe aktualisht cilesi me te ulet sherbimi. Problem është cilesia e rrugëve të brendshme, te paksesueshme në periudha të caktuara të vitit. Duhet të mendojmë për mënyrat e reja të të shërbimit transportit që te jene sa me eficiente ekonomikisht.


Ne kuadrin e prodhimit dhe përdorimit te energjisë, skenarët e planit kërkojnë theksimin e përdorimit te burimeve hidro energjike

Indikatoret kyc jane pra :

- Permiresimi i lidhjeve te brendeshme ne vecanti per lokalitetet kryesore e sekondare;
- Aktivizimi i aeroportit dhe permiresimi i transportit publik;
- Unifikimi i korridoreve te transportit me ato energjitarke per nje tutele me te mire te territorit

Diagrama e mëposhtëme tregon strategjinë për sistemin infrastrukturor që rrjedh nga analiza SWOT dhe përpunimi i elementeve të përshkruara më sipër:





**Figura 4: Sistemi Infrastrukturor**

Kategorite e rrugave	
Rrugë Interurbane dytesore - C	
Rrugë urbane dytesore - E	
Rrugë lokale - F	
Segment i ri	
Rrethrotullim i propozuar	
Terminali i autobusave	
Rrugë dytesore a propozuar (PPK)	
Rrugë e Arbrit (PPK)	
Linja energjetike 110 kV (PPK)	
Perforime te linjeve energjetike (PPK)	
PRMS Dibër-Stacioni i Matës dhe Reduktimit të Presionit-IAP	

Për cdo program strategik janë identifikuar veprimë e projekte te qëndrueshme dhe funksionale në arritjen e objektivi strategjik, të cilat do të përshkruhen në shtojcën e bashkangjitur *Bashkengjitur.01 - Skedat e Projekteve Strategjike*

<b>PROGRAMI STRATEGJK</b>	<b>VEPRIMI</b>	<b>PROJEKTI</b>
2.A Rritja e cilesise dhe eficenses se sherbimeve	2.A.1 Menaxhimi i mbetjeve	2.A.1.1 Menaxhimi i mbetjeve
	2.A.2 Permiresimi i rrjetit te ujesjellesit	2.A.2.1 Nderhyrjet ne furnizimin me uje te pijshem dhe uje te rrjedhshem ne Peshkopi
	2.A.3 Permiresimi i rrjetit te kanalizimeve	2.A.3.1 Permiresimi i rrjetit te kanalizimeve
	2.A.4 Përmirësimi i menaxhimit të burimeve të energjisë	2.A.4.1 Aplikimi i energjisë se paster dhe eficences energjitike 2.A.4.2 Reduktimi i perdonimit te drurit si burim ngrohjeje
2.B Permiresimi i aksesibilitetit	2.B.1 Permiresimi i organizimit te transportit publik	2.B.1.1 Permiresimi i transportit, prioritet i jepet fshatrave qe ndodhen 2 km nga aksi qendor
	2.B.2 Permiresimi i rrjetit rrugor ekzistues	2.B.2.1 Reduktimi i numrit te rrugeve te paasfaltuara
		2.B.2.2 Ndertimi/ permiresimi i rrugeve rajonale qe lidhin qytetin me fshatrat dhe zonat turistike (Kastriot-Lure, Muhurr-Selishte, Bishop-Zimur, Mons-Rabdisht)
		2.B.2.3 Unaza e Peshkopise
		2.B.2.4 Sherbime infrastrukturore per zonen industriale te SMT-KUBEN
	2.B.3 Krijimi i rrugeve te bicikletave	2.B.3.1 Lidhje ciklabel ne drejtim te lokaloteteve turistike
	2.B.4 permiresim i lidhjeve kombetare dhe nderkombetare	2.B.4.1 lidhja me rrugen e Arberit
2.C Permiresimi i sitemit ekonomik	2.C.1 Vleresimi i veprave artizanale	2.C.1.1 Rivleresimi i zejit te perpunimit te kashtes
	2.C.2 Specializimi fuqise punetore	2.C.2.1 Qendra trajnimi per profesinet sanitare
	2.C.3 Zhvillimi i zonave te prodhimit	2.C.3.1 Zone e re industriale per gjat aksit Tomin-... 2.C.3.2 Rregullimin e zones doganore te Maqellares si zone ekonomike multifunksionale

### 5.2.3 Objktivi Strategik 3 - Vlerësimi i qëndrueshëm i burimeve ambientale si ne terma turistike dhe energjitike e minerare

Pasuria e burimeve natyrore të territorit duhet të jetë në radhë të parë e mbrojtur dhe administruar në mënyrë që të ruhet ose rivendoset cilësia e tij. Kjo në mënyrë të veçantë lidhet me ndotjen nga hedhja e mbeturinave dhe ujërave të zeza të patrajuara në rrjedhat e ujit dhe në basenin e Fierzës, me varferimin e pyjeve që rezulton nga menaxhimi i dobët, me pranine e



aktiviteteve minerare qe edhe pse përfaqësojnë një potencial ekonomik, ato janë gjithashtu objekte të degradimit të mjedisit për tu menaxhuar.

Sigurimi i cilësisë dhe ruajtja e burimeve natyrore është kusht i nevojshem per vleresimin e tyre. Aksioni i sistemit është strukturimi i një oferte të koordinuar turistike në nivel rajoni, duke siguruar një shërbim me cilësi të lartë, të plotë dhe konkurrues. Përdorimi i pakët i burimeve lokale është e lidhur me një veprim të dobët promovues nga ana e enteve lokale dhe mungesa e një strategjje globale të marketingut, me vështirësine për të bere te njojur jashte, ate që territori është në gjendje të ofrojë.

Turizmi mund të jetë një pasuri e vërtetë për Dibren, me gjithatë, duhen mjete, përfshirë dhe ato operative, për të ofruar shërbime për turistët dhe përdoruesit që lejojnë një transferim me të vërtetë aktiv të elementeve identitare, të përkatësisë dhe të pritjes.


Paralelisht territori i Kukësit ka një kapital hidrik i cili mund te shfrytezohet per projekte hidroenergjitime, me një rikthim afatshkurtër ne ekonomine lokale. Ky është një element kyç rreth të cilët lëvizin interesat e investitorëve potencial të cilët mund të janë një faktor i rendesishem në zhvillimin ekonomik dhe për të përmirësuar shërbimet dhe infrastrukturën. Në një kontekst dhe në një kohë kur burimet publike janë të kufizuara është thelbësore mundësimi i formave te partneritetit publik-privat, që synon zbatimin e masave të cilat nga njëra anë janë në gjendje të kthehen në përfitim për komunitetin dhe në anën tjetër të sigurojne investitorët per qëndrueshmërinë ekonomike dhe financiare te operacionit. Marrëveshjet publike-private, në forma të ndryshme praktike, janë një nxitje e nevojshme për investimet ekzistuese.

Mbrojtja, promovimi, njojja, duket të janë elementet në qendër të strategjive të nevojshme për të shfrytezuar kete trashëgimi të madhe, e aftë për gjenerimin lëvizjeve të reja turistike dhe ekonomike.

Treguesit kryesore janë si më poshtë:

- Cilësia e mjedisit nepermjet reduktimit te ndotësve, rritja e sigurisë së brendshme dhe menaxhimi më i mirë i mbeturinave (në veçanti uljen e ndotjes ne Drin);
- Zhvillimi i turizmit malor dhe ekoturizmit;
- Perfitimi ekonomik në shkallë lokale nga investimet në sektorin e energjisë dhe minierave.

Diagrami i mëposhtëm tregon strategjinë për sistemin natyrore dhe hidrik që rrjedh nga analiza SWOT dhe përpunimi i elementeve të përshkruar më sipër:







Figura 5: Sistemi Natyror

Sistemeve Territoriale	
Urban	
Infrastrukturor	
Bujqesor	
Natyror	
Ujor	
Territor qe peson konvertim sistemi	

Park Natyror Korab-Koritnik	
Zone Perdomi Tradicional (ZPT)	
Zone Qendrore (ZO)	
Zone Zhvillimi qendrueshem (ZZhQ)	
Trashegimia kulturore	
Monumente Natyre	

Zonat Mbrojtura	
I kategoria	
II kategoria	
III kategoria	
IV kategoria	
V kategoria	
VI kategoria	

Bufferzone	
Vija Blu	
Vija e kuqe	
PRMS Dibër-Stationi	
Matjes dhe Reduktimi të Presionit-IAP	
Ruga e Arbrit (PPK)	

**Figura 6: Sistemi Ujor**

Për cdo program strategik janë identifikuar veprimë e projekte te qëndrueshme dhe funksionale në arritjen e objektivi strategik, të cilat do të përshtakuhen në shtojcën e bashkangjitur *Bashkëngjitur.01 - Skedat e Projekteve Strategjike*

PROGRAMI STRATEGJK	VEPRIMI	PROJEKTI
3.A Menaxhim dhe mbrojtje me e mire e sistemit ambiental	3.A.1 Rritja e kontrollit dhe e mbrojtjes së mjedisit	3.A.1.1 Permiresimi i menaxhimit te mbeturinave ne vecanti ne zonat e mbrojtura 3.A.1.2 Mirembajtja e pyjeve dhe perfundimi i procesit te transferimit te pronave
	3.A.2 Rritja e investimeve ambientale	3.A.2.1 Ripyllezimi i zonave te Lurës, Kacnisë, Buflës, Pratit 3.A.2.2 Capacity Building, menaxhimi mjedor dhe monitorimi
3.B Vleresimi i sektorit turistik	3.B.1 Permiresimi i infrastruktures dhe rritja e investimeve per turizmin natyror	3.B.1.1 Hotel i vendosur ne zone malore 3.B.1.2 Zgjerimi dhe zhvillimi i Parkut Kombtar 3.B.1.3 Krijimi i qendrave termale 3.B.1.4 Rizhvillimi i zones per gjate ligenit 3.B.1.5 Parqe rekreative per gjate rrjedhave te lumenjve 3.B.1.6 Permiresimi i rrjetit frutor/ shtigjeve/ impianteve sportive 3.B.1.7 Zhvillimi i turizmit rural 3.B.1.8 Zhvillimi i parkut arkeologjik ne zonen e kishave antike te kodres se Gradishtes
3.C Vleresim i qendrueshem i burmieve natyrore ne terma te energjise dhe industrise se nxjerrjes	3.C.1 Administrim me i mire i ciklit te ujit 3.C.2 Vleresimi i hidrocentraleve lokal 3.C.3 Vleresimi lokal i potencialit minerar	3.C.1 Administrim me i mire i ciklit te ujit 3.C.2.1 Regjistrimi dhe gjeoreferencimi i centraleve ekzistuese 3.C.2.2 Tarifa te pershtatshme per konsumin e energjise 3.C.3.1 Vleresimi lokal i potencialit minerar

#### 5.2.4 Objktivi Strategik 4 - Vleresimi i zinxhirit te prodhimit bujqesor

Promovimi i dobët i produkteve vendore është i lidhur pjesërisht me mungesën e integrimit midis komponentëve të ndryshem të transformimit: territorit, prodhimit, marketingut, trajnimeve. Kjo mungesë kufizon aftësinë për ti dhënë vlerën neto çdo burimi potencial për zhvillim ekonomik lokal.


Vlerësimi i ulët mund t'i atribuohet mungesës së formave të perfshirjes dhe mungesës se rrjeteve organizative të brendshme ndërmjet sektorëve ekonomikë dhe vete sektoreve. Thelbesore, ne këtë kontekst, është krijimi i një marke, si një element i rendesishem për ti dhënë identitetin dhe njojjen territorit, si dhe promovimin e markave të produkteve te njoitura për specifikat territoriale.


Për krijimin e markës mund të krijuhet një sinergji e ngushtë në mes kerkimit, kërkimit te aplikuar, eksperimentimit, prodhimit, universitetit me trajnimet ne fushen e bujqësisë se bashku me prodhuesit vendor. Inovacioni eshte shume i rëndësishem si proces. Nevoja për të nxitur dhe zhvilluar koordinimin dhe integrimin në mes të ndërmarrjeve funksionon edhe per forcimin e shërbimeve për bizneset si një mjet për të përmirësuar konkurrueshmërinë e produkteve. Promovimi i një kulture bashkepunimi ne rrjet, kryesisht ka të bëjë me fushat e kërkimit dhe inovacionit, marrëdhëniet me sistemin e kredive dhe iniciativat e ndërkombëtarizimit.

Indikatorët krye pranë janë:

- Permiresimi dhe vlerësimi i zinxhirit bujqësorë deri ne krijimin e një Marke per prodhimet lokale;
- Rikompozimi i tokave dhe vlerësimi i tyre ne pllajat e Peshkopise, Maqellares e Drinit;
- Modernizim i strukturave te sherbimit ne sektor.

Diagrami i mëposhtëm tregon strategjinë për sistemin bujqësor që rrjedh nga analiza SWOT dhe përpunimi i elementeve të pëershkruar më sipër:





**Figura 7: Sistemi Buqesor**

Për cdo program strategjik janë identifikuar veprimë e projekte te qëndrueshme dhe funksionale në arritjen e objektivi strategjik, të cilat do të përshkruhen në shtojcën e bashkangjitur *Bashkëngjitur.01 - Skedat e Projekteve Strategjike*

PROGRAMI STRATEGJIK	VEPRIMI	PROJEKTI
4.A Permiresimi i menaxhimit ne sektorit bujqësor	4.A.1 Kualifikimi i krahut te punes	4.A.1.1 Promovimi i eksperiencave te mira agrare
		4.A.1.2 Permiresimi i zinxhireve BIO
	4.A.2 Bashkepunimi dhe koordinimi mes aktoreve te sektorit agrar	4.A.2.1. Promovimi i iniciativave private për zhvillimin e mëtejshëm të sektorit bujqësor
		4.A.2.2 Krijimi i pikave të reja për mbledhjen dhe ruajtjen e produkteve bujqësore dhe blegtorale
		4.A.2.3 Krijimi i markave/Certifikatat e cilesise
	4.A.3 Permiresimi i procesit prodhues	4.A.3.1 Zhvillimi i infrastrukturës bujqësore
		4.A.3.2 Masa agroteknike per permiresimin e terrenit bujqësor
		4.A.3.3 Rekuperimi dhe shtimi i rrjeteve ujitese
		4.A.3.4 Legalizimi i pronave bujqësore
		4.A.3.5 Identifikimi i zonave të zhvillimin e peshkimit

### 5.3 Strategjia insediative territoriale

Duke u nisur nga vizioni dhe nga objektivat strategjike është përcaktuar strategjia e vendndodhjeve qe përvëç së përshkruan strukturën territoriale, jep dhe udhezime opérative për hapin e ardhshem (faza3) të pregetitjes së planit Vendor Urban. Strategjia e vendndodhjeve vjen në renie si në nivel territorial ashtu dhe në nivel urban te qendrës kryesore të Dibrës.

Strategjia për sistemin insediativ Diber ofron strukturimin e vendbanimeve në mënyrë që ato të kontribuojnë për:

